Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (95). MARS 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

PROPOZIMI

Grup ekspertësh për mbrojtjen e lumit Radika

Nga **BARDHYL MARKU** - FAQE 4

AKTUALITET

Çidhna në rrezik nga ndërhyrjet në natyrë...

Nga **ISLAM CANI** - FAQE 7

STUDIM

Reka në shënjestër të asimilimit kombëtar

Nga **SEJDI M.GASHI** - FAQE 19

BOTIME

Monografi për Said Najdenin e Hafiz Langun

Nga **REXHEP TORTE** - FAQE 16

TOP CHANNEL UDHËTON NË GJURMËN E RRUGËS SË ARBËRIT: SI PO ECIN PUNIMET NË RRUGËN QË PËR "POLITIKËN" ËSHTË DUKE PËRFUNDUAR, POR NË REALITET PUNIMET NUK KANË FILLUAR!!!

Rruga e Arbërit e 'Shqipërisë tjetër'



Duke xhiruar pranë Urës së Vashës. Foto: © Bujar Karoshi

MBI 5000 QYTETARË FIRMOSIN ONLINE PETICIONIN PËR RRUGËN E ARBËRIT DHE MBI 1000 TË TJERË E NËNSHKRUAJNË ATË NË LETËR. MINISTRI HAXHINASTO KONFIRMON: PO PRESIM KINEZËT!

Shoqëria civile: Të rishihet projekti

Drejtuesit e dy shoqatave, "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" i shkruajnë Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe gjashtë deputetëve të Dibrës. Nga një vrojtim i përgjithshëm i punës së kryer deri tani gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbrit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbrit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangie nga aksi i Rrugës së Arbrit. Mbështetur në konstatimet e mësipërme për objektet më të rëndësishme të kësaj rruge si: Tuneli i Qaf Buallit, Ura e Vashës e Tuneli i Gurit të Bardhë dhe Tuneli i Murrizës, për të cilat nuk ka filluar ndërtimi i tyre, propozojmë që të rishikohet e përmirësohet projekti duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara.

SPECIALE NË FAQET 2-3

cyan magenta yellow black 1

Mbi 5000 qytetarë firmosin online peticionit për Rrugën e Arbërit dhe mbi 1000 të tjerë e nënshkruajnë atë në letër. Ministri Haxhinasto konfirmon: Po presim kinezët!

Të rishihet projekti

Drejtuesit e dy shoqatave, "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" i shkruajnë Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe gjashtë deputetëve të Dibrës



Ndërsa emisioni "Shqipëria Tjetër" në Top Channel realizoi një reportazh në gjurmët e Rrugës së Arbrit që lënë shumë për të dëshiruar, dy shoqatat "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" i kanë dërguar një letër Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, z. Edmond Haxhinasto, më kërkesën për ta rishikuar projektin e Rrugës së Arbrit në segmentin nga Ura e Vashës në Tiranë.

Në letrën që u është dërguar edhe Autoritetit Kombëtar të Rrugëve dhe gjashtë deputetëve të Dibrës, theksohet nevoja për rishikim të projektit, me qëllim për të pasur një rrugë me standarde bashkëkohore , si të cilësisë së ndërtimit, ashtu edhe të elementëve të sigurisë.

"Në tremujorin e tretë të vitit 2013 disa anëtarë të kryesisë së Shoqatave të Intelektualëve Dibranë dhe Nisma Dibrane në Tiranë kryen vrojtime në zonën ku do të kalojë Rruga e Arbrit, nga Qafa e Buallit, Plani i Bardhë, Ura e Vashës në Gurin e Bardhë të Matit, në Qaf Murrizë, Bastar Kaçu, Shpal, Zall Dajt e Ura e Brarit të Tiranës", thuhet në letrën e cila është e firmosur nga kryetari i shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë Prof. Dr. Nuri Abdiu dhe kryetari i shoqatës "Nisma Dibrane", Bujar Karoshi.

"Qëllimi i këtyre vrojtimeve ishte për tu njohur me ecurinë e punimeve të kryera për gjatë aksit ku kalon Rruga e Arbrit në këtë zonë, vonesat dhe mangësitë e vërejtura në kryerjen e punimeve për të krijuar një ide për punimet e kryera deri tani dhe për të dhënë ndonjë mendim e për të bërë ndonjë propozim për shpejtimin dhe përmirësimin e punës projektuese e zbatuese në vazhdim. Nga një vrojtim i përgjithshëm i punës së kryer deri tani gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbrit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbrit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangie nga aksi i Rrugës së Arbrit. Shmangja më e madhe është ajo ku duhet të hapet Tuneli i Qaf Buallit", thuhet në letrën e kryetarëve të dy shoqatave dibrane.

"Mbështetur në konstatimet e mësipërme për objektet më të rëndësishme të kësaj rruge si: Tuneli i Qaf Buallit, Ura e Vashës e Tuneli i Gurit të Bardhë dhe Tuneli i Murrizës, për të cilat nuk ka filluar ndërtimi i tyre, propozojmë që të rishikohet e përmirësohet projekti duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara. Mendojmë se marrja parasysh e këtij propozimi do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ndërtimit të rrugës, për t'ju afruar sa më shumë standardeve të kohës", mbyllet letra për Ministrin Edmond Haxhinasto.

Letra është e shoqëruar edhe me një relacion teknik, detajet e së cilës janë bërë publike në numrat e kaluar të gazetës Rruga e Arbrit.

> Nga një vrojtim i përgjithshëm i punës së kryer deri tani gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbrit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbrit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangie nga aksi i Rrugës së Arbrit.

> Mbështetur në konstatimet e mësipërme për objektet më të rëndësishme të kësaj rruge si: Tuneli i Qaf Buallit, Ura e Vashës e Tuneli i Gurit të Bardhë dhe Tuneli i Murrizës, për të cilat nuk ka filluar ndërtimi i tyre, propozojmë që të rishikohet e përmirësohet projekti duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara.

REAGIM I MINISTRIT

Disa ditë pas dërgimit të letrës, Ministrit i Transportit dhe Infrastrukturës, z. Edmond Haxhinasto, në një intervistë për gazetën "Integrimi" të datës 25 mars 2014, ka shfaqur paqartësitë e deritanishme në ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

"Rruga e Arbërit përbën një rast tipik, ku projekti nuk është filluar bazuar në një vlerësim të impaktit social-ekonomik, apo të planifikimit të plotë buxhetor, duke marrë për bazë qëndrueshmërinë e investimit", thotë ai, duke iu përgjigjur pyetjes se a ka një afat se kur do të përfundojë Rruga e Arbërit. "Nuk ka pasur buxhetim të planifikuar për pjesën më të rëndësishme të rrugës, segmentit prej 27 km, që ka një vlerë tepër të lartë prej rreth 200 milionë eurosh. Aq më pak është parë si një projekt që shkon përtej kufijve të vendit dhe si pasojë, koordinimi me Maqedoninë fqinjë duhet të kishte qenë i domosdoshëm". Në këtë intervistë, Haxhinasto ka konfirmuar interesin e kompanive kineze për ndërtimin e rrugës së Arbërit, sipas partneritetit Publik-Privat. "Së fundmi, ka pasur një interes të shprehur nga një kompani serioze kineze për realizimin e saj, gjë që uroj të realizohet, duke hapur edhe një praktikë të re të Partneritetit Publik Privat në realizimin e veprave publike", thotë ai.

PETICIONI, NJË VIT PAS NISJES

Ndërkohë që shoqëria civile në Shqipëri e ka bërë publike shqetësimin e saj për ndërtimin pa standarde të Rrugës së Arbrit deri më tani, Gëzim Alpion thotë për gazetën se peticioni vazhdon akoma të firmoset nga qytetarë nga të gjitha vendet ku jetojnë, brenda dhe jashtë vendit.

"Deri më tani ne kemi arritur mbi 5000 firma online dhe rreth 1000 në letër, konfirmon ai për gazetën dhe firmosja nuk do të përfundojë deri ditën kur të përfundojë edhe metri i fundit".

Profesori i Universitetit të Birmingamit thotë se do të jetë në Maj në Tiranë për ta dorëzuar zyrtarisht peticionin dhe gjatë kësaj kohë do te këtë kontakte edhe me grupe të tjera të shoqërisë civile në Tiranë, deputete dhe qeveritarë.

"Ne kemi një bindje se kjo qeveri, gjatë fushatës elektorale dhe pas mandatimit të saj, ka dhënë disa sinjale pozitive në lidhje me çështjen, thotë ai për gazetën, por ne kemi marrë përsipër para nënshkruesve, disa prej të cilëve janë sot edhe në parlament, se do ta dorëzojmë formalisht peticionin vetëm Kryeministrit. Gjithashtu, po ritheksoj se ne synojmë dorëzimin formal të peticionit, jo marrjen prej Kryeministrit të një date nisje punimesh apo përfundimi të rrugës".

Alpion thotë se është në kontakt edhe me deputetë dhe media të ndryshme në Tiranë për organizimin e një debati të gjerë në lidhje me këtë çështje. "Gjithashtu, në jemi në kontakt edhe me deputetët e Dibrës dhe jo vetëm, për organizimin e një tryeze debati në lidhje me problematikën që sjell ecuria e ndërtimit të Rrugës së Arbrit". Alpion tha se do të organizojnë edhe një takim me drejtues të pushtetit lokal në Bulqizë e Dibër si dhe do të bëjnë edhe një ekspeditë në terren për të parë gjendjen e rrugës.

Korresp. "Rruga e Arbërit"

Posta e Rrugës e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (95). 1 - 31 Mars 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: S.Mëziu, Z. Lleshi, D.Rama, R. Lata, H.Përnezha, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Arkivi i gazetës është pa pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Marin MEMA
Sejdi M.GASHI
Ruzhdi LATA
Rexhep TORTE
Abdurahim ASHIKU
Bardhyl MARKU
Hyqmet GONXHJA
Ibrahim MILUSHI
Fejzulla GJABRI
Zamira GJELESHI
Elona MAZARI
Islam CANI
Selman MËZIU
Qazim SHEHU
Sakip CAMI
Ali HOXHA
Metush SKEJA
Faik XHANI
Mehdi DEMA
Hysen LIKDISHA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

reportazh



Duke xhiruar pranë Urës së Vashës. Foto: © B.Karoshi

Rruga e Arbërit e ‘Shqipërisë tjetër’

- Shpejt entuziazmi ia le vendin zhgënjimit... Një tunel i parë që del në një kthesë jo pak të rrezikshme dredhon në rrugën që humbet vetëm pak kilometra me pas... Segmenti i parë me vlerë rreth 16,7 milionë euro duhet të kishte përfunduar kohë më parë, të paktën në letër, por punime janë kryer deri diku në Shupal, në Zall-Dajt, me tej asgjë.

- Zhvillimi që do t’i jepte të gjithë kësaj pjese ku do të kalonte, por edhe më tej do të ishte i jashtëzakonshëm, duke krijuar mundësi të pafundme ekonomike, punësim, zhvillim e gjithçka tjetër që meriton e gjithë kjo zonë.

- Nëse ecën mbi premtime të fryra e deklarata elektorale kjo rrugë duhet të ishte përfunduar me kohë, por nëse ecën mbi realitetin do të shohësh se janë bërë vetëm grimca pune e asgjë më shumë.

Nga **MARIN MEMA**

Është rruga që do t’i jepte frymëmarrje një krahine të tëre si Dibra, por edhe shumë më tej deri në Shkup e trevat e tjera në Maqedoni, që do të afroheshin ndjeshëm me kryeqytetin e Shqipërisë.

Rruga e Arbërit nisi me bujë e me deklarata të mëdha politike, që më pas ia lanë vendin paqartësisë e problemeve të tjera që e penguan në mënyrë të vazhdueshme përfundimin e saj.

Po sot, në ç’gjendje është ky aks, ku kanë mbetur punimet dhe çfarë po bëhet me të?!

Traseja që nis diku pranë fshatit Brar të Tiranës të jep ndjesinë pozitive se diçka po lëviz në realizimin e projektit që duhet të kushtojë më shumë se 300 milionë euro.

Por, shpejt entuziazmi ia le vendin zhgënjimit... Një tunel i parë që del në një kthesë jo pak të rrezikshme dredhon në rrugën që humbet vetëm pak kilometra me pas... Segmenti i parë me vlerë rreth 16,7 milionë euro duhet të kishte përfunduar kohë më parë, të paktën në letër, por punime janë kryer deri diku në Shupal, në Zall-Dajt, me tej asgjë.

Nga këtu, rrugëtimi duhet të vijojë përmes rrugës së vjetër. Ndryshe nga ç’ishte pompuar aq shumë mediatikisht se punimet kishin mbetur vetëm në tunelin e Murrizit, realiteti është krejt tjetër.

Drejt Kodër-Shupalit, rrugëtimi me makinë përngjan më shumë me një lundrim me varkë, duke ndjerë lëkundjet e forta e turbulluese si pasojë e gjendjes së keqe të saj.

Të gjithë presin, shpresojnë, kanë dëgjuar shumë, por kane parë kaq pak...

Aksi i vjetër nga ku nuk dallohet kurrëfarë punimi për Rrugën e Arbërit zbret në qendrën e komunës në Zall Bastar. Që aty ajo dredhon përmes një shtegu të stisur mes lumit, për të kaluar në krahun tjetër.

Fshati i radhës është Bastari me rreth 1 400 banorët e tij. Edhe këtu asgjë, aq sa hera-herës të duket e vështirë të jetë folur aq shumë për këtë rrugë që po përshkojmë e që në fakt në terren ka pak ose aspak gjurmë.

Rruga përkeqësohet. Në vendin ku duhej të hapej tuneli në Qafën e Murrizit, pranë fshatit Kaçu e që u shty e u debatua aq shumë për shkak, siç u tha zyrtarisht, të prezencës së madhe të ujit, ka vetëm bimësi të hazdisur, aty e në të gjithë pjesën e gjerë përreth, por edhe nëse do të kishte qenë kështu, a thua vërtet punimet kanë mbetur vetëm tek ky tunel? Apo shumë herë më larg?!

Fillimisht, ky tunel ishte projektuar të ishte 3,5 kilometra, pastaj kilometrat shkuan në 2,7 dhe u rrit kuota e lartësisë ku ai do të kalonte. Projekt pas projekti, deklarata pas deklaratash, fushatë pas fushate që prodhoi veç këtë realitet.

Në krye të Qafës së Murrizit gjithçka duket edhe më qartë.

Në horizont mes maleve mund të dallohen lehtësisht pjesë të kryeqytetit ose me saktësisht zona e njohur si Shkallët e Tujanit, por po të kthehemi në krahun tjetër do të dallojmë edhe Qafën e Buallit, që i paraprin qytetit të Bulqizës.

Këto pamje janë të mjaftueshme për të dhënë një ide sa afër janë këto zona aq sa mund t’i bashkosh edhe me sy të lirë.

Edhe në të zbritur në zonën ku duhet të dilte tuneli, në afërsi të fshatit Xibër-Murrizë të Matit, me rreth 280 shtëpi asgjë nuk ndryshon.



Marin Mema dhe operatori Denian Sevi pas intervistës më një banor të Xibër në rrethin e Matit, i cili rrugën për Tiranë e bën hipur mbi kalë... Foto: © B. Karoshi

Punime s’ka, gjurme s’ka...veç pritje me shikim nga horizonti, gërxhe, lumenj, orientim i vështirë pa asnjë drejtim të qartë deri në brendësi të fshatit.

Nuk është e vështirë të kuptosh sesa e rëndësishme është kjo rrugë për të gjithë këtë zonë që do të mund të ndryshonte rrënjësisht realitetin e saj.

Duke kthyer këto pjesë sot të thella në fshatra periferike të kryeqytetit ose më mirë në zona turistike të tij....

Fshatrat pasojnë njëri-tjetrin, ndërsa nga rruga e famshme e Arbërit nuk duket ende gjë, veç një projekti imagjinar që këtu nuk ekziston.

Pas rreth 23 km, nga Zall Dajti, më në fund dallohen punime. Pikërisht në zonën e njohur si Ura e Vashës... Edhe këtu çuditë kanë pjesën e tyre. Punimet për urën që do të lidhë dy pjesët nuk duken, thuhet se edhe vetë ura nuk do të bëhet në të njëjtin vend siç e patën ndërtuar Arbërit, ku edhe kepet që duhet të lidhen janë më të afërta, por në një pjesë tjetër më të largët, kjo si pasojë e disa vështirësive të papritura që në këtë rrugë duket sikur s’kanë fund kurrë...

Nga sipër duket qyteti i Klosit, derisa shtegu bashkohet me rrugën nacionale, në luginën e Planit të Bardhë, ne pak kilometra punohet, por sërishmi gjërat ngecin vetëm pak më tej në të ashtuquajturin tuneli i Qafës së Buallit edhe ai, një herë ishte tunel rreth 850 metra i gjatë me vlerë mbi 13 milione euro, pastaj u punua për ta eliminuar, derisa gjerat mbetën në ajër.

Rruga vijon pas shpinës së Bulqizës e më pas bashkohet pak me tej me rrugën e dikurshme që s’ka asnjë lidhje me atë të Arbërit.

Pak minuta më pas gjërat përfundojnë, nga fshati Gjoricë e më tej ajo zhduket sërisht mes traseve të pakta ku punohet, zhdukjes e rishfaqjes, projekteve të ndryshuara shpeshmi Rruga e Arbërit duket si një lojë kuka-fshehti, e denjë për prestigjatore, në këtë rast politike.

Ajo duhet të vazhdonte që këtu në drejtim të Dibrës së Madhe, duke shkuar deri tejmi në Bullgari.

Nëse sot, rruga Tiranë - Dibër e Madhe është e gjatë mëse 160 kilometra me rrugën e Arbërit ajo do të bëhej vetëm 72,6.

Zhvillimi që do t’i jepte të gjithë kësaj pjese ku do të kalonte, por edhe më tej do të ishte i jashtëzakonshëm, duke krijuar mundësi të pafundme ekonomike, punësim, zhvillim e gjithçka tjetër që meriton e gjithë kjo zonë.

Nëse ecën mbi premtime të fryra e deklarata elektorale kjo rrugë duhet të ishte përfunduar me kohë, por nëse ecën mbi realitetin do të shohësh se janë bërë vetëm grimca pune e asgjë më shumë.

Top Channel / Shqipëria Tjetër

Rruga e Arbërit nr. 95

Në Dibër të Madhe u mbajt protesta
e rradhës kundër devijmit te lumit Radikë

aktualitet

Radikën do **ta mbrojmë** me jetën tonë

Nga **REXHEP TORTE**


© Foto: Rexhep Torte

Në organizim të shoqatave joqeveritare të Dy Dibrave, të Dibrës së Madhe në Maqedoni dhe Peshkopisë në Shqipëri, në Sheshin "Skenderbe" në Dibër të Madhe të mbushur përplot me protestues si asnjëherë më parë, mes tyre edhe përfaqësues nga shumë qytete të Maqedonisë dhe Shqipërisë, më 14 mars 2014, u mbajt protesta e radhës kundër devijimit të rrjedhjes së lumit Radikë.

Bashkim Mashkulli kryetar i Këshillit Komunal në Dibër të Madhe para të pranishëmve, theksoi se, "Jemi mbledhur për një hall të madh që ka Dibra, për t'i thënë jo politikës anti dibrane dhe anti shqiptare të Gruevskit . Të gjithë dibranët e dimë që kjo është një politikë serbe dhe greke, të gjithë e dimë se me këtë projekt i bëhet dëm popullit shqiptar që dëshiron ujin e bekuar të Radikës ta merr dhe ta dërgojë në Vardarin e qelbur. Nga ky tubim i bëjmë thirrje Qeverisë së Shqipërisë që e ka obligim t'i del në ndihmë popullit të Dibrës, që e ka edhe me Kushtetutë që të mbrojë interesin e Dibrës. Të gjithë jemi dëshmitarë se kuçedra ka dalë në Korab dhe tenton ta ndalë ujin e Radikës. Por mos harrojmë se Dibra ka djem që do ta vrasin këtë kuçedër dhe nuk do të lejojmë që uji i Radikës të shkojë në anën e Greqisë. Ato që mendojnë se dibranët do të ndalen gabojnë shumë rëndë. Dibranët nuk do të ndalojnë asnjëherë që të mbrojnë çdo pikë të ujit të Radikës. Nga ky tubim ftojmë Qeverinë e Kosovës, Qeverinë e Shqipërisë, SHBA-të dhe të gjitha qeveritë që janë pro Dibrës, të mbrojnë me çdo kusht jetën e Dibrës që Radika nuk merret poshtë, Radika merret te burimet lartë, te Korabi. Ata që synojnë devijimin e Radikës, prej burimit duan ta marrin ujin që ta lënë këtë pjesë pa pikë uji. Por ne nuk duam të vdesim. Ne do të jetojmë. Nëse është për të vdekur do të vdesim atje ku duhet e jo këtu", tha në fund Mashkulli.

Munir Hoxha, përfaqësues i Shoqatave joqeveritare në Peshkopi, shtoi se: "Sot jemi mbledhur këtu për burimet e Lumit, ose siç njihet tek ju Reka e deri në Kala të Dodës, për t'i thënë jo një projekti antishqiptar siç kërkon Gruevski, për t'i marrë ujërat e Lumit Radikë. Ju bëj thirrje këtu se partia numër një e dibranëve është Radika dhe asnjë parti tjetër nuk duhet të votohet nëse nuk e mbron këtë çështje. Shqetësimet dhe rënkimet e Radikës kanë shqetësuar edhe Nëntë malet e Dibrës , të cilët janë bashkuar me ju për t'i thënë jo këtij projekti. Ky projekt nuk do të realizohet sa të jemi gjallë ne këtu. Dëshiroj t'ju bëj edhe njëherë thirrje jo vetëm qeverive, përfaqësuesve të Bashkimit Europian, por edhe Qeverisë së Amerikës, se ky nuk është më një problem i thjeshtë vetëm brenda Maqedonisë, por ky është një problem ndërshtetëror ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë. Problem që mund të eskalojë dhe të shtrihet në gjithë Ballkanin, andaj nuk do të ketë më protesta të këtilla, por ta kenë parasysh se ne nuk do të heshtim, nuk do të rrimë duar lidhur përpara kësaj fatkeqësie që kërkojnë të bëjnë drejtuesit e Qeverisë së Maqedonisë", theksoi Munir Hoxha.

Lulzim Fejzullahu, Kryesuesi i OJQ-ve nga Gostivari, para protestuesve tha: "Ne në Gostivar rreth 48 shoqata kemi nënshkruar një peticion për mbrojtjen e Lumit Radika .Unë si sektor i bujqësisë apeloj që Lumi Radikë të mbrohet për disa shkaqe, sepse shkencëtarët botërorë thonë se 10 vitet e fundit do të kemi krizë për ujë të pijshëm, andaj ndokush punon që ne të mbesim edhe pa ujë të pijshëm, çdo vitë e më shumë bie numri i prodhimeve të bujqësisë për shkak të ngrohjes globale. Me ndërprejen dhe me devijimin e Lumit Radika prishet atmosfera, ndryshon klima dhe gjithçka merr tatëpjetë. Ndaj apeloj që të gjithë dibranët dhe qytetarët e tjerë të mbrojnë lumin Radika. Nuk duhet të bëhemi injorantë, se sa më shumë të jemi injorantë në këtë çështje do të fundosemi ne vetë", tha Fejzullau.

Shpëtim Pollozhani, kryetar i ish të burgosurve politik në Maqedoni, deklaroi se: " I drejtohem gjeneratës së re se pas njëzet viteve uji në këto anë do të paguhet më shumë seç paguhet nafta dhe benzina në këtë kohë. Na takon të gjithëve të luftojmë për këtë ujë. E përcjell këtu mesazhin e një tetëdhjetë vjeçari nga Struga, i cili e mban mend shumë mirë që në vitin kur është ndertuar HC i Mavrovës në dy fshatrat e Strugës kanë shterë dy burime, një në Koroshishtë dhe një në Dollogozhdë, dhe sot ato dy fshatra vuajnë për ujë. Ky nuk është vetëm problem i Dibrës por i gjithë popullatës shqiptare që jeton në të dy anët e Sharit, Karaormanit dhe Korabit. Ky është problem strategjik e politik. Sipas analizave një shtet nga një metër kub ujë fiton katër milion dollarë. Këtë ujë ne do ta paguajmë me para, siç e paguajmë sot nëpër punëtori edhe nëpër shërbime. Ju ftoj që në të ardhmen protesta tjetër të bëhet në kantierin dhe jo në Dibër", deklaroi Pollozhani.

Aleksandra Bujanovska, përfaqësuese e dy koalicioneve "Natyra 2000" dhe "Ekologjia Prioritet", u shpreh se: "Falënderoj të rinjtë që i shoh këtu për të shpëtuar Radikën dhe për të shpëtuar Parkun Nacional të Mavrovës. Parku Nacional, Reka dhe Radika janë pasuri nacionale të mbrojtura dhe ashtu duhet të mbeten përgjithmonë. Këto projekte që ndikojnë negativisht në këto pjesë i quaj si të padrejtë, pasi pasuritë natyrore janë të të gjithëve, e sidomos e këtyre të rinjve për të cilët ne jemi më shumë përgjegjës sot këtu. Këto dy koalicione bashkohen me ju për mbrojtjen e Lumit Radika", tha Bujanovska.

Samet Abdullai, përfaqësues i Rekës deklaroi se: "Sot është data 14 mars dita e ujrave, dita e ruajtjes së pasurisë natyrore dhe kundër ndalesave. Shumë ndodhi na kanë bashkuar këtu. Unë asnjëherë nuk kam parë kaq dibranë në një vend. Të mos ju gënjejnë se banorët e Rekës nuk janë këtu, edhe ato janë sëbashku me ju. Radika edhe historikisht është shprazur në Liqenin e Dibrës në Drin dhe në detërat e Europës, dhe ashtu do të mbetet. Kemi shumë argumente në anën tonë, kemi mijëra nënshkrime të mbledhura kundër projekteve dëmtuese Lukovo Pole dhe Ura e Boshkut. Kemi mendimet e 119 specialistëve për mbrojtjen e Parkut Nacional të Mavrovës dhe kundër këtij projekti, por dikush mundohet t'i manipulojë. Dua që nga këtu bindshëm dhe me zë të lartë të them se Dibra dhe Reka do ta mbrojnë pasurinë natyrore dhe kulturore. Ne nuk kemi ujë për shitje, siç nuk kemi edhe njerëz që t'i shesim në shtete e huaja. Duhet ta ndërtojmë dhe ngjallim këtë rajon. Nuk duam që kjo pjesë që është më e mira në rajon si edhe në Ballkan të na mbetet "Zorrë qorre". Kemi njerëz që do të mundohen për zhvillimin e këtij rajoni. Ju bëj thirrje Komunës së Rostushës, sëbashku me këshilltarët që të zgjohen nga ëndrrat me porosi të huaj dhe kërkesa të huaja për llogari të huaj, ne do të vazhdojmë me protesta , do të bëjmë edhe referendum , populli do ta thotë fjalën e vet, nuk mundë të lejojmë që disa individë ta manipulojnë këtë popull. Çdo herë i kam vlerësuar njerëzit për mesazhet që ata japin, por jo në bazë të gjuhës apo kulturës që kanë. Duhet ti themi Stop këtij projekti, nuk na duhen më largime nga vendlindja, por na duhet ngjallja e këtij rajoni, na duhet Radika që do të jetë motori i zhvillimit të këtij rajoni. Thirrja ime është te investitorët dhe qeveria që ta ndalojnë këtë projekt. Qeveria e ardhshme duhet ta dijë se Radikën nuk e japim. Radikën ta lëmë që të jetë zhvillues i këtij rajoni dhe magnet për vizitorët e jashtëm" , deklaroi Samet Abdullai.

Ilirian Fetahu, kryetar i Shoqatës "One dollar për Dibrën", në fjalën e tij para tha: "U bënë shumë ditë e muaj që ky qytet së bashku me Rekën po jeton me ankthin e projektit "Llukovo pole". Janë po aq ditë dhe muaj që dibranët kudo që janë, në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Europë, SHBA, po protestojnë kundër këtij projekti, i cili si qëllim final ka ta devijojë rrjedhën e lumit Radikë, projekt përmes të cilit duan te na e thajnë jeten, të na e thajnë tokën, të mos këndojë as zog, as të ndëgjohet ulurimë kafshës, të na e heqin bukurinë e vendlindjes, të na e heqin historinë. Duan të na e marrin të ardhmen e fëmijëve tanë, të marrin atë që na e lënë trashëgim të parët tanë. Ndaj sot jemi mbledhur këtu, se vetëm unik do të jemi me të fortë, më të vendosur, më të guximshëm për te mbrojtur te drejtën e asaj që na takon. Përmes këtij tubimi u themi përfaqësuesve te ELEMIT: "Larg duart nga uji i Radikës,l arg nga Reka, se ne s'na trembin kërcënimet tuaja, e kurrë s'do lëmë të realizohet ky projekt famoz, ky projekt bombë atomike!" Mjaft më me mashtrime të tipit se ky projekt do ta ris numrin e vizitorëve në parkun nacional. A thua se turistet vrapojnë pas gypave nëntokësor dhe hidrocentraleve dhe jo pas kanjoneve dhe bukurive te tjera natyrore. Janë mashtrime fjalët se ky projekt do të ketë impakt në ekonominë e zonës, pasi projekti planifikon ndërtimin e hidrocentralit qe do funksionojë për 50 vite, e vjedhja e ujit të Radikës të bëhet përgjithmonë. Thoni që projekti eshte është përgaditur nga ekspert më të mirë, e nuk përfillni mendimin e 119 shkencëtarëve botërore, të cilët thonë se ky projekt do të shkaktojë pasoja me karakter ekonomik, social, demografik, mjedisor dhe ekologjik. Harroni me dashje të mos citoni edhe shkrimet në gazetat e huaja për të cilat nga qindra hidrocentrale që priten të ndërtohen, më tragjiku është ndërtimi i hidrocentralit ne Urën e Boshkut dhe në Fushën e Llukovës. I referoheni një marrëveshje të bërë vite më parë, e harroni se sot të gjitha vendimet dhe marrëveshjet në lidhje me lumin Radike duhet te jenë në përputhje me interesin e dibranëve, se çdo marrëveshje kundër këtij interesi do rrëzojë qeveri dhe do prish shtete. Ne sot jemi këtu që me zërin e të gjithë dibranëve të protestojmë me vendosmëri: Stop devijimit të rrjedhës së lumit Radikë. Stop projekteve me synim shkatërimi të Dibrës dhe Rekës. Stop grabitjeve së pasurisë së Dibrës që ka bekimin e Zotit. Nga ky tubim u lëshojmë thirrje të zgjedhurve, partive politike, liderëve, se askush s'ka mandate ta fal as ta shes të ardhmen e këtij vendi, të ardhmen e brezit të rinjsh që e duan këtë qytet, që e duan vatanin, e duan ta ndërtojnë të ardhmen e jetës së tyre. Kërkojmë nga liderët politik shqiptar në Maqedoni: "Kundërshtojeni projekin "Lukovo pole", se është kundër dibranëve, se është kundër shqiptarëve, se është gatuar në qarqet nacionaliste e shoveniste për t'i sjell këtij qyteti fatkeqësi, mjerim, varfëri, shpërngulje nga këto troje. Kërkojmë unanimisht dhe me vendosmëri Qeveria e Maqedonisë dhe Elem-i të heqin dorë nga projekti, se do të përballen me forcën e të drejtës, me të drejtën për të mbrojtur atë që na takon, me të drejtën e demokracisë, se aty ku nuk ka drejtësi e nuk përfillen kërkesat e popullatës, aty ka anarki, ka shtypje, padrejtësi, aty s'ka avenir e s'ka si te ketë as paqë. I drejtohemi edhe Shtetit Shqiptar të jetë në linjë të njëjtë me kërkesat e qytetarëve dibranë , të rrijë në mbrojtje të vëllezërve të vet, ashtu siç e parasheh edhe Kushtetuta e Shqipërisë, të mos lejojë kurrsesi të na marrin ujin e shpresës, ujin e të ardhmes. Lusim përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA, Bashkimit Evropian , këtu në Maqedoni, si shtete nga ku burojnë liritë dhe të drejtat e njeriut të nxisin Qeverinë e Maqedonisë që të ndalojë këtë projekt që i përket të kaluarës dhe jo të ardhmes."Padrejtësia diku është kërcënim për kudo!" thot një thënie e Martin Luther King. I drejtohemi edhe Bankës Botërore që të mos e financojë projektin, se projekti "Llukovo Pole" është projekt politik dhe diskriminues, dhe si i tillë nuk sjell paqe dhe zhvillim, por trazira dhe varfëri. Nuk mundet që në këtë protestë të mos e sjell edhe shqetësimin e nxënësve, të shprehur në vargje të shkruara nga vetë ata. "O moj Radikë, moj shpirti jonë. Ti rrjedh nëpër Dibër si gjaku i trupit tonë. Ne do të mbrojmë si shpirtin tonë. Ne do të jemi këtu gjersa s'do të merret asnjë pikë ujë. E zëri jonë i fuqishëm protestues s'do të shteret kurrë!" Nëse kërkesa e dibranëve nuk merret në konsideratë, atëherë do të jemi të detyruar të nxisim padëgjueshmëri qytetare mos funksionimin e institucioneve që nga organet më të larta Komunale, tha në fund Fetahu.

Qeveria e Maqedonisë dhe Elem-i të heqin dorë nga projekti, se do të përballen me forcën e të drejtës, me të drejtën për të mbrojtur atë që na takon, me të drejtën e demokracisë, se aty ku nuk ka drejtësi e nuk përfillen kërkesat e popullatës, aty ka anarki, ka shtypje, padrejtësi, aty s'ka avenir e s'ka si te ketë as paqë. I drejtohemi edhe Shtetit Shqiptar të jetë në linjë të njëjtë me kërkesat e qytetarëve dibranë , të rrijë në mbrojtje të vëllezërve të vet, ashtu siç e parasheh edhe Kushtetuta e Shqipërisë.

propozimi

Grup ekspertësh për të koordinuar veprimet për mbrojtjen e lumit Radika

Nga **BARDHYL MARKU***

LËNDA: Kërkesë për formim të grupit të ekspertëve i cili do të koordinojë aktivitetet lidhur me mbrojtje e lumit Radika si pasojë e planit të qeverisë për ndërtim të akumulimit në fushë të Llukovës.

I nderuar Z. Bashkim Mashkulli, Kryesues i Këshillit Komunal,

Në fillim të korrespondencës sime më lejoni t'ju përgëzoj për punën e përditshme që jeni duke bërë në drejtim të zgjidhjes së problemit dhe rrezikut serioz të devijimit të lumit Radika.

Mendoj se sensibilizimi i qytetarëve si në Dibër po ashtu edhe në Maqedoni, tanimë është rritë dukshëm. Fatmirësisht pas protestës së fundit në Peshkopi dhe aktivizimit të shoqatave joqeveritare dhe protestës së organizuar në Tiranë, sensibilizimi, edhe në Shqipëri është ritë në mënyrë të ndjeshme. Jemi dëshmitarë të artikujve të ndryshëm si në gazetat e përditshme (tanimë jo vetëm në shqip por edhe në gazetat në maqedonisht), po ashtu edhe në internet portalet e ndryshme (edhe në shqip po ashtu edhe në maqedonisht). Ky është një sihariq i mirë që na jep shpresë se problemi nuk është më vetëm i dibranëve por për të ngrenë zërin si në Maqedoni ashtu edhe Shqipëri, por çka është më me rëndësi këtë shqetësim e përcjellin dhe për të reagojnë edhe ekspertët për rruajtje të ambientit nga mbarë bota.

Duke ndjekur ngjarjet e fundit (protestën e ditës së diele të 19 janarit në Peshkopi dhe në Tiranë) por edhe deklaratën të cilën e dha zëdhënësi i Qeverisë por edhe vete Kryeministri së RM,gjatë ditëve të fundit, është shumë e qartë se Qeveria e RM nuk ka ndërmend të revokojë planet e saja për ndërtimin e akumulimit në fushë të Llukovës, respektivisht të devijimit të lumit Radika. Pra, për dibranët aktivitete nuk kanë përfunduar. Siç dëgjuan nga deklarata e para disa ditëve të dhen nga Ju, Z. Bashkim, është e qartë se Qeveria po punon fshehurazi dhe ne nuk kemi një pasqyrë të saktë se çfarë po bëhet.

Nga ana tjetër deklaratat e dhëna nga: zëdhënësi i Qeverisë, nga ELEM-i, nga Ministrat Saraqini dhe Ademi etj. janë kontradiktore. Ata herë dalin me kalkulim se do merën 2 m3 ujë në sekondë e një herë tjetër dalin me informatë se do merren 2 deri më 7,2 m3 ujë në sekondë. Këta deklarata kontradiktore janë të verifikuara dhe mund ti gjeni të gjitha në ueb faqen e ELEM-it, por gjithashtu edhe ne ueb faqen për mbrojtje të lumit Radika, në adresë: www.saveriverradika.com

Tani, mbi të gjitha ekziston edhe një problem, i fshehur do kisha thënë, i cili shumë pak po diskutohet nga kompetentët, respektivisht ekziston edhe një minimum prej 5 m3 ujë në sekondë, të cilat nuk i deklaron askush. Nga 30 m3 ujë në sekondë, 10 i janë marrë Radikës gjatë ndërtimi të hidrocentralit në Mavrovë, d.m.th. ngelin edhe 20 m3 ujë në sekondë; sot ELEM-i del me shifra se Radika disponon, jo më 20, por 15 m3 ujë në sekondë. Shtohet pyetja ku shkuan ata 5 m3 ujë në sekondë dhe si u reduktuan nga 20 në 15. Ka shumë të ngjarë që këta 5 m3 ujë të merren,nëse veç nuk janë marrë, para se të behët çfarë do lloj aktiviteti



Punime nga nxënësit e shkollës "Said Najdeni", Dibër

i mëtejmë lidhur me ndërtimin e pendës në fushë të Llukovës.

Qëllimi i letrës sime ka të bëjë me sugjerimin, që këtë çështje ta rrahim në mënyrë më të organizuar. Unë mendoj se është koha të bashkohemi të gjithë dhe nën udhëheqjen dhe përkrahjen institucionale, me kyçje të të gjithë atyre faktorëve/ individëve të cilët mund të japin çfarëdo qoftë kontributi, të avancojmë qasjen dhe aktivitetet tona lidhur me kauzën tonë të përbashkët Radikën.

Bazuar në të gjithë atë çfarë kemi dëgjuar kohëve të fundit, aktiviteteve të cilat janë ndërmarrë në mënyrë individuale, të organizuara, apo pjesërisht të organizuara, unë dëshiroj të sugjeroj që në një takim të radhës, pse jo edhe në ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme, të Këshillit Komunal në Dibër të diskutohet lidhur me disa pika të cilat unë i shoh si kanalizim dhe avancim të aktiviteteve për të ngritë qasjen tonë këtij problemi në një nivel tjetër duke u përgatitur për beteja edhe më të vështira, në mbrojtje të lumit Radika. Këta rekomandime jepen në bazë të një diskutimi të gjerë i cili u zhvillua gjatë muajit dhjetorit të vitit 2013, në rrjetin social Facebook dhe takimet e përditshme me shumë dibranë. Nga ata diskutime mund të konkludohet që:

Përfundimisht (të gjithë pajtohen) se duhet të formohet një grup pune respektivisht grup i ekspertëve i legjitimuar në seancë të Këshillit Komunal, në përbërje nga profesioniste të sferave të ndryshme, të cilët kanë informata, përgatitje adekuate dhe kanë dëshirë të kyçen në këtë aktivitet. (Nuk duhet të zgjidhen njerëz vetëm se për të qenë në atë grup pune, por përkundrazi të zgjidhen persona të cilët duan të punojnë).

Ky grup pune do jetë përgjegjës të realizojë si vijon:

1) Të merr mjaft seriozisht këtë çështje dhe të informohet në mënyrë të detajuar përmes të gjitha materialeve të cilat janë siguruar deri tani për këtë çështje në forma të ndryshme si dhe ata materiale të cilat janë të siguruara nga administrata komunale;

2) Të kërkojë nga ELEM-idhe nga Banka Botërore të gjitha materialet relevante që kanë të bëjnë me këtë çështje, posaçërisht dokumentet e ELEM-it, si p.sh.: projekti (në çfarëdo faze qoftë ai), kontratat të cilat kanë mundësuar nisjen e kësaj iniciative; raportin e plotësuar të firmës gjermane e cila është duke përgatit analizë të ndikimit social dhe ambientor të këtij projekti, por jo vetëm në brezin e kapjes se ujerave të Radikës, por edhe përgjatë rrjedhës së saj deri në liqenin e Dibrës;

3) Të kërkojë prej ELEM-t informata t ësakta për sasinë reale të ujit që planifikojnë të marrin dhe informata për një periudhë më të gjatë kohore për prurjet mestarë, maksimale dhe minimale të Radikës me qëllim që të bëhen analiza më të sakta. (Një ekspert i ujërave duhet të tregojë sa duhet të jetë kjo periudhë kohore). Këta informata do qartësonin gjendjen reale dhe do mënjanonin spekulimet eventuale që kanë të bëjnë me sasinë e ujit të Radikës;

4) Të bëhen përgatitjet dhe analiza juridike për të parë mundësitë e nisjes së procedurës gjyqësore kundër këtyre projekteve në gjyqet e vendit apo gjyqet ndërkombëtare.

5) Përbërja e këtij grupi duhet të jetë atillë që të mundësojë përgatitje të strategjisë për veprim. Kam ndërmend këtu kyçje të këtyre profileve: ekspert i ujërave (hidrologjisë), ekspert i tërmeteve, ekspert i ekologjisë, ekspert i energjetikës, jurist, ekonomist, biolog dhe ndoshta edhe ndonjë profil tjetër i cili mund të kontribuojë në këtë çështje.

Komuna duhet të vazhdojë aktivitete e saja ashtu si gjer më tani edhe atë:

1. Të vazhdojnë kontaktet, përpjekjet dhe presionet permanente ndaj Qeverisë së RM-së dhe kontaktet me udhëheqësit dhe ministrat e BDI-se me kompetence, duhet të iniciohet takim me Kryeministrin dhe ti përcillet kërkesa zyrtare e Komunës për ndalim të çfarëdo devijimi të Radikës.

2. Takime permanente me Qeverinë Shqiptare dhe Ministrat e resorëve përkatës në R. e Shqipërisë (edhe pse nga jam i vetëdijshëm se deri tani janë realizuar takime të ndryshme).

3. Të përpilohet elaborat nga një kompani private profesionale, për ndikimin social dhe ekologjik të projektit fusha e Llukovës në Dibër dhe në liqenin e Dibrës si rezultat i devijimit të ujërave të Radikës,nga baseni i Drinit të Zi në atë të Vardarit;

4. Të sigurohen mjete financiare të cilat mund të jenë të nevojshme për mbështetje të kauzës sonë të përbashkët , mbrojtje të lumit Radika

Besoj se sugjerimet, të cilat nuk janë vetëm të miat, do të hasin në mirëkuptim nga këshilltarët komunal më të cilët kemi brengën e përbashkët, mbrojtje të lumit Radika, dhe në takimin e radhës ky grup i ekspertëve të legjitimohet nga Këshilli Komunal.

Letër dërguar Këshillit Komunal të Dibrës së Madhe më 23 janar 2014,.

SHËNIM:

Në numrin e kaluar të gazetës kishim njoftuar botimin e letrës së zotit Bardhyl Marku, të cilën ai ia kishte dërguar Këshillit Komunal të Dibrës së Madhe. Gjatë këtij muaji, në rrjetin social Facebook, ka pasur një reagim të Kryetarit të Këshillit Komunal, zotit Bashkim Mashkulli, i cili, jo vetëm që e hedh poshtë letrën e zotit Marku, por e akuzon atë edhe për karrierizëm për çështjen në fjalë dhe përdorimin e çështjes për qëllime politike.

Ne e rilexuam edhe njëherë letrën e zotit B.Marku, dhe u përpoqëm të gjenim mes rreshtash qëllimet në "prapavijë të tijë", por në gjykimin tonë, edhe si rezultat i ndjekjes së çështjes së Radikës që në fillimet e saj, nuk shohim shenja karrierizmi dhe prapavije politike në dëm të çështjes, përveç qëllimit të mirë të mbrojtjes së ujërave të Radikës. Kështu që vendosëm, ashtu siç kemi premtuar, botimin e saj.

Për të mbrojtur Radikën kërkohet një vullnet mbarë kombëtar, e në veçanti mbarë dibran. Përdorimi i saj si çështje politike është plotësisht në të drejtën e gjithsecilit, por çdo person që do të përfitojë sadopak politikisht nga kjo çështje, do të mbajë më shumë përgjegjësi qoftë politike dhe qoftë sociale për pasojat që do vijnë në rast të tradhtisë ndaj çështjes. Në të kundërt, duhet të kemi edhe ndershmërinë t'u themi faleminderit!

B. Karoshi

Rruga e Arbërit nr. 95

vëzhgim



Demostrata mbi pyjet 1940.
Foto: Gjon Fierza (Arkiv)

I trishtuar dhe i trembur sa ska kufi mendoj: Mos vallë ka ardhur fundi i pyjeve dhe njerëzisë? Ndoshta! Dhe përsëri hedh vështrimin pyetës fotografisë bardhë e zi, veprimit të një kohe të shkuar 73 vjeçare. Njerëz të guximshëm, kurajoz ishin ata atëhere.

Simfonia e pyllit dhe e pylltarit!

Meditim mbi një fotografi

Nga **SELMAN MËZIU**

Vështroj këto malsorëe qytetarëme këtë trup shtatëgjatë, mbi supe. Qindra njerëz, kësulë bardhë si bjeshka me borë, me tirqe e xhamadanë ndjekin korteun e përmortshëm. Një parullë ndër të tjera e dalë nga mëndje e Musolinit, lexojmë'' Unë i dua pemët,mbrojini,unë ju ndihmoj ta bëni këtë,, në italisht.Policia italiane e shqiptare mbanë rregullin. Nën terrorin fashist protestohet në mënyrën më origjinale, për shkatërrimin barbar të pyjeve. Edhe kufoma pothuajse njëqind vjeçare proteston, duke dëshpëruar e revoltuar demostruesit edhe ashtu e shtrirë përdhe' e pa jetë.

Dhe nën dritën e llampës dhe me fotografinë përpara meditoj duke menduar mbi copëzat e pishës apo të rrëshirës që i jepnin dritë njeriut primitiv. Lëndet e dushkut që ato i hanin me shije, e mbanin gjallë veten e shikonin përpara duke sfiduar natyrën e përsosur vetëvehten. Perëndeshën e pyllit Artemisa, që bekonte gjallesat shtatëlarta të pishnajave, dushkajave, ahishteve etj. Ndërsa Romakët zgjodhën Silvestris perëndinë e pyllit. E çuditëshme se në Kadastren e tyre lexojmë për dushkun (Silvae glandiferae). Kjo ishte espekti dhe dashuria për këtë dru. Edhe pellazgët kishin prane kultit të tyre fetar Lisin gjigandë në kurorë e lartësi të Dodonës.

Dhe shfletoi me mëndjen time, ''fletët e kujtesës,, Taçito, Plinion, Plutarkun, Pomponoi Mela, Amiano Marçelinon, Strabone, Virgjilion, Sidonion, Tito Livion, Apionales, kesaj rradhe jo për deshmi historike, por për pyllin si bashkësi komplekse, e ato nuk e kanë harruar, sejcili prej tyre shkruan, si dentrolog, pedolog, silvikultor, natyralist etj. Dhe shprehem: Samire që këto pishtar të historisë njerëzore nuk e kanë harruar pyllindhe e barazojnë me njeriun, si DY qënie më të rëndësishme të NATYRËS!

Përsëri kërkoj te dokumentet Anxhoine të shekullit XII-XII ku gjejë eksportimin e drurit të shqopës në mbretërinë e tyre në Napoli, po kështu në shekujt e paskëtajmë, tregetarët, fiorentinas, raguzian, venecian tregëtojnë drurë me përmasa të mëdha të pyjeve nga dushkajat e Ishmit të Durrësit, për të ndërtuar anije, barka, e gryka topash. Dhe përsëri mendoj: Sa mirë paskemi patur drurëedhe për superfuqitë e atyre kohërave!

Shfletoj veprën e udhëtarit francez Pukevil, e gjejë emra shkurresh, drurësh, florës barishtore. Profesor Baldaçi shkruan për përdorimin e frutit te Gështenjës nga Ilirët, dhe i bie kryq e tërthor Shqipërisë, duke përshkruar lloje të ndryshme pyjore që në moshen 19 vjeçare duke i pasqyruar në librat shumë vëllimshe. E më shkreptinë truri ''rrufenë,, e vetë: Sa keq që në leksionet e dentrologjisë të shkollës së mesme e të lartë askush nuk foli as edhe një fjalë për këta studiues.



MalkolmHahn-i, albonologu i shquar gjerman kur shikon në ngjitjen për në Qafë Murrizë, lisat shtatëlartë të prerë degët. Dhe ai mendoi: Çfarë masakrash bënkërkan këta njerëz? Ndërsa u mrekullua në udhëtimin luginës së Drinit nga Vau i Dejës në Dibër, ai u shpreh: Pasuri e madhe dhe njëkohësisht bukuri e mrekullueshme! Të njëjtat përshtypje i lanë gjurmë në kujtesë edhe tek Austriaku Nopska (Nopça). Udhëtimet e të cilëve janë të fundshekullit të nantëmbëdhjetë. Sa e sa kronistë, udhëtar, politikan historian, misionarpërgjatë rrokullimës së shekujve kanë shkruar për pyllin dhe pylltarin. E përsëri detyrohem të shkruaj: Sa e mjerueshme teknikët, inxhinierët e pyjeve ndoshta dhe doktorët e profesorët pylltarë, i njohin shumë pak!

E vështroj fotografinë me drurin shtatë gjatë në krye të demostruesve dhe mendoj: Sa vite i janë dashur të rritet me këto përmasa? Vallë çfarë ligjesh e rregullash, statutesh, organizimesh shtetërore, krahinore, fisnore e kanë mbrojtur për tu bërë kaq madhështor? Dikush ka zbuluar në arkiva shtetesh e biologjike, Ligjet romake, anxhoine, Serbe, Turke të Kanunit të Lek Dukagjinit e deri në ligjin mbi pyjet të vitit 1922 të aprovuar nga parlamenti shqiptar. E përsëri hedh pyetjen: Përse vallë sot u sakrifikua kjo krijesë e bukur dhe shoqërohet nga malësorët e qytetarët shkodran?

Ashtu si gypat e drurit e te liberit kanë ushqyer këtë dru, kur ishte në jetë edhe shteti, mbretëria e viteve tridhjetë dhe qeveritë e më pastajme dërguan të rinjtë qytetar për tu shkolluar, veçse përkundruell Evropës. Loro Beltoja studioi për teknik pyjesh ne Itali, e më pas Llazar Treska, ILia Mitrushi e Nako, dhe fillon të funksionoj teknikumi pyjor në Kamëz, më pas në Shkodër e u hap inxhinieria pyjore. U hartuan leksione, tekste shkollore, u bënë projekje, dhe filluan të vijnë inxhinierët e parë nga Rumania, Sofia, Moska e Tirana. Pylli pronë shtetërore iu nënshtrua disiplinave të shkencave pyjore. Sa mirë mendoj tani që po duken zhvillime me rreze ylberike edhe në rritjen shtimin e shfrytëzimin e pyjeve.

S. Dishnica, B. Xheko, D. Habili,Dh. Koçi, I. Latifi, A. Radovicka, V. Koçi etj hartuan planet e para të mbarështimit. F. Zadrima, S. Çota, S. Buka etj filluan tëprojektoin e ndërtojnë pritat malore në përrenj me rrezikshmëri të madhe. J. Bulo, Z. Kaba V. Dermani G. Sokloli, B. Fishta etj fillojnë të mbjellin sipërfaqet e para me pyllëzime të reja, Selvi, Pishë e zezë, Akacie, Arra, Gështenja etj. Operacionet e shfrytëzimit ndiqeshin e udhëhiqeshin nga silvoteknika. Natyra e drejtuar nga njeriu po ecte me këmbët e veta duke i shërbyer me bujari atij. Ndërsa dushkajat e degraduara dhe kullotat alpine po shkatërroheshin për të mbjellë misër, grure dhe patate. Përdnryshe njerëzia do të hante barë si delet.

Nuk mund të hesht e të mos ve në lëvizje sistemin e të menduarit: Biocenozat, fitocenozat po bashkërendojnë veprimet me politikat ekonomike, mendimin e konceptet teknike me vijueshmeri në hapsire dhe kohë apo....?

Në fakt ndodhi fundosja me dhunë e një sistemi ekonomik e politik. Një organizim i ri gjithëplanësh duhej të fillonte por.... Ashtu si në kohën antike farat e Valanidhit (Quercus macrolepis, Kotschy) emigruan në Trikaze të Pulias në Italinë jugore, edhe pas viteve ''90 të shekullit te kaluar Efthim Naumi inxhinieri i parë shqiptari pyjeve, që shkoi me llotari në Amerikë i ndjekur nga dhjetra inxhinierë, droktorë e profesorë pyjesh. Ndërsa në pyjet shqiptarë vendin e ÇEKIÇIT TË DAMKËS e zëvendësoi sopata e motosharra e pakontrolluar e padisiplinuar e njerëzve. Në vend që filizëria , imshtajat e trungishtet e reja të rriteshin e drurët amë/mamë të prodhonin farat i përfshinë gjuhëzat e kuqe e përvëluese të flakëve. I trishtuar dhe i trembur sa ska kufi mendoj: Mos vallë ka ardhur fundi i pyjeve dhe njerëzisë? Ndoshta! Dhe përsëri hedh vështrimin pyetës fotografisë bardhë e zi, veprimit të një kohe të shkuar 73 vjeçare. Njerëz të guximshëm, kurajoz,.....ishin ata atëhere.

Drejtues të ndermarrjeve pyjore janë këpucar, veteriner, mësues fiskulture e më tej studimet e doktoratat tërijtëspecialistë i bëjnë në botën e qytetëruar, në universitet më me zë të mbarë botës. Por çe don, pishat nuk prodhojnë ma rrëshirë por kataklizma psikologjike e natyrore, nuk prodhojnë e shërojnë. Specialistë e drejtuaes janë prodhues mefshtësie e frike, plogështi e partizan idesh e kukuvajka partish e bindjesh politike ku njëri i bie goxhdës e tjetri patkoit. Edhe pse zjarret mund të fiken me avion special ato nuk gjenden në shqipëri, edhe pse mbarështimi e inventarizimi i ekonomive pyjore dikur kryhej me matje me litar, e përcaktimi i moshës bëhesh me Turjelën Presler, ndërsa lartësia e drurëve matej me Aparatin: Blume Lewis tani bëhen nga zyrat ndërsa teorikisht dihet metoda e fotografimeve ajrore të sipërfaqeve pyjore. Ndërsa praktikat mësimore për të parë skemat e pyllëzimeve mund të kryhen vetëm në lulishten në qendër tëTiranës. Aty është modeli, aty gjëndet etaloni, aty është objekti i pyllëzimeve edhe pse i afrohet asaj të arrës e gështenjës.Ësht e vetmja në katër anët e vendit. I vetmi në rruzullin e dheut.

Kur po shkruaj këto rradhë, vajza e vogël shtatë vjeçare më afrohet dhe më shprehet:

-A është e vërtetë babë se rrënjët e drurëve e të shkurreve shtërngojnëtokën dhe ushqehen aty dhe kështu ato mbrojnë sipërfaqen e tokës që të mos e shkatërroj uji i shiut.

- Po, - i thashë duke hapur sytë nga habia.

- Mësuesja na tha që farat mbijnë vetë në pyll dhe ripërtrijnë vetëvehten. Kështu ka vazhdimësi, ky ësht ligji i natyrës.

- Edhe kjo është e vërtetë,- unë u stepa nga këto mendime.

E përsëri mu kujtua shprehja e Kompozitorit e Profesorit Çesk Zadeja kur pa masivet e pyjeve të Arrnit: ''E ç'janë simfonitë e mia para kësajë bukurie të papërsëritëshme.,, Kështu ishin dikur. Ndërsa tani simfonitë e tij të ngjallin emocione e kënaqësi, kudo në çdo pëllambë të dheut.

Këto janë sfidat e kohërave.

Firence 26 janar 2013

aktualitet

Çidhna në rrezik nga ndërhyrjet në strukturën natyrore, kulturore e arkeologjike



Foto: Gazmend Kërkuti

Nga **ISLAM CANI**

Çidhna djepi i qytetërimit, strehë e Dibrës që në lashtësi, qyteti princave dhe mbretërve ilirë, vendlindja e Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit (Skënderbeut), vendi me pozicionin strategjik në mbrojtje, vendi i bukurisë, i perlave të natyrës e sot ndodhet në rrezik të humbasë identitetin saj historik. Qyteti me i vjetër i krahinës së Dibrës, të parët e këtij qyteti kanë qene dy fise Duka si princ dhe Karoshi si kryetar i qytetit. Edhe sot këto dy fise mbajnë territore pronash të veçanta pa ndërhyrje të asnjë fisi tjetër si psh; tokat, livadhet, pyjet, ujërat etj. Këto fise gëzojnë të drejtën e autoktonisë dhe respektohen dhe që nga kohët e vjetra. Kur ra ose humbi qyteti i Çidhnës, Dukallarët i shitën pronat Canit. Karoshi bashkë me Dukën kaluan në pronat e tyre në Mustafe, sot ata gëzojnë vendin më të zgjedhur më të mire më pjellorë dhe ndërtesat e tyre janë në pozicione të favorshme me themele të veçanta, me troje strategjike për mbrojtjen e bregut të Drinit dhe kullës së Kastriotëve, por asnjëherë ata nuk i harruan trojet e tyre.

Çidhna e Dibra me burimet natyrore e kulturore, historike e arkeologjike si kudo në Shqipëri janë nga më të rrallat në Europë. Malet dhe pyjet zënë pjesën më të madhe të territorit dhe janë ato me lartësinë dhe bukurinë e tyre perfekte për zhvillimin e turizmit, me ajrin e pastër, ujëra të shumta, lumenj e liqene, me gurra e kroje si dhe një biodiversitet tepër të zhvilluar. Çidhna e pasur me monumente te shumta natyrore, me vendbanimet dhe vendstrehimet shekullore (shpella e kala, fortifikime, e pika mbrojtëse), me objekte ose pjesë veprash ndërtimore (me mure, kalldrëme, punime zejtare, artistike) me gjurmë arkeologjike, të cilat vërtetojnë se i përkasin kohërave të ndryshme të historisë duke filluar nga prehistoria, antikiteti e deri në mesjetë.

Çidhna një qendër arkeologjike me hapësira e zona të shumta ku ruhen mbi e nën tokë monumente dhe objekte me vlera për historinë e saj mijëravjeçare. Nga kërkimet apo nga erozioni tokësor janë gjetur dhe kanë dalë në dritë objekte të rëndësishme madje dhe disa thesare arkeologjike që pasqyrojnë jetën e historinë e këtij qyteti të lashtësisë që sot është fshati Çidhën. Nga banorë të Çidhnës janë gjetur objekte të shumta që nga qeramika, bronzi e hekuri, madje dhe monedha e bronzit që i takon kohës së mbretërisë Ilire e gjetur në Trojase ose Kepi i Xhitetit (Gjitetit) siç i thonë banorët.

Ç'PO NDODH NË TERRITORIN TOKËSOR E LUMOR TË ÇIDHNËS?

Çidhnës i janë vërsulur kasapët e zhdukjes së identitetit të historisë dhe arkeologjisë, për ta mbytur në ujë me ndërtimin Hec-ve, duke mbuluar të vërtetat historike. Çdo ditë po grumbullohen dhe largohen ujërat, po rrënohen monumentet, po dëmtohen sipërfaqe të shumta toke të cilat janë miniera të arkeologjisë, po prishen vendet historike, po humbet emri, puna, lufta, qytetërimi, zhvillimi i Oenës qytet i lashtësisë, po humbet autonomia e Çidhnës edhe e Dibrës së Ilirisë, për një qëllim fitimin dhe interesin e momentit të një grupi personash duke shkatërruar jetën mijëravjeçare te qytetit, për të humbur përfundimisht identitetin e kësaj treve që e njeh historia, dhe Europa mbarë.

Jo vetëm kaq por dora e shkatërruesve po bën të humbasë qendra historike e Nëntë Maleve, vendi historik ku janë marrë vendime të rëndësishme, ku janë krijuar qeveri të përkohshme, qendra që bënte lidhjen e kalave, qyteteve e qytezave të gjithë Dibrës në periudha të ndryshme të zhvillimit historik, ekonomiko-kulturor të saj. Vendi ku është dhënë mendim për të qene qyteti, në zonën e Arrasit dhe të Fushë Çidhnës e Kastriotit. Në qofte se lejohen kasapët e pa ftuar që të presin, therin dhe të gatuajnë gjellën e preferuar me monumentet e Çidhnës, atëherë gjurmët arkeologjisë zhduken e bashkë me to humbet identiteti ynë historik.

Ajo që ka bërë historinë mijëravjeçare të Dibrës dhe të kombit, sepse lidhet ngushtë me vendlindjen e Heroit të Kombëtar Gj. Kastrioti Skënderbeu, sot po groposet e copëtohet. Ndonëse nuk janë çidhnakët fajtorë, por indiferentë ndaj atyre që po i pinë ujin, gjakun, po i thyejnë skeletin e historisë mijëravjecare të jetesës dhe të kulturës që në lashtësi. Këta zaptues me strategjinë e tyre përfituese po humbasin logjikën për vlerat e natyrore e kulturore, por mbi gjithçka vendosin interesin dhe fitimin e çastit. Këto persona duhen edukuar dhe mënjanuar nga kjo rrugë, çdo lloj lëshimi e pajtimi me to rrezikon Dibrën, Çidhnën dhe gjithë vendin.

A nuk do të ishte më mirë që këto investime të investitorëve private apo shtetërore për të ndërtuar Hec-et, që prishin dhe shkatërrojnë burimet ujore të Çidhnës të bëheshin për investimin e zhvillimit tërësor të identifikimit dhe të ruajtjes së monumenteve natyrore e kulturore, për identifikimin, regjistrimin e pasurive të trashëgueshme dhe investime në fushën e arkeologjisë në zhvillimin turistik të saj.

Këto kasapë që me rrënimin e tokës dhe të tharjes së ujërave me apo pa dashje po i heqin identitetin e saj e cila është e lidhur ngushtë me Çidhnën, Dibrën dhe historinë tonë kombëtare.

PSE HESHTIN INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE?

Çdo heshtje zyrtare të organeve përkatëse apo dhe gjendja letargjike e shoqërisë civile po i japin dorë dhe po i mprehin thikën këtyre zanatçinjve të hidrocentraleve, të cilët s'po bëjnë gjë tjetër, por Çidhnës së shqiponjave po i presin krahët, po i groposin identitetin e saj historik, gjeografik, kulturor e arkeologjik.

Organet dhe personat përgjegjës në bazë dhe në qendër kudo që janë duhet të zgjohen nga letargjia për të mënjanuar këtë rrezik që po i kanoset Çidhnës me dëmtime të rënda të sipërfaqes së tokës dhe të monumenteve të saj deri në humbjen e identitetit Dibran. Hesht dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë, e cila ka mbi 23 vjet demokraci që nuk investon për kërkime e mbrojtje të monumenteve natyrore e kulturore, por bën lojën e veshit shurdh e syrit qorr!

Mjedisi natyror i Çidhnës është i pasur monumente natyrore e kulturore me burime minerale, burime ujore, burime pyjore të cilat banorët i shfrytëzojnë për nevojat e tyre dhe të komunitetit, por kurrsesi nuk mund të dëmtojmë sipërfaqen dhe vendet historike e arkeologjike mijëravjeçare që presin të thonë fjalën e tyre, që mbajnë të gjallë historinë mijëravjeçare të Çidhnës, Dibrës e më shumë, pra duhet investuar në kërkim të së vërtetës e jo ta rrënojmë, ta fshimë atë të vërtetë të madhe dhe pasuri me vlera materiale dhe jomateriale, të cilat janë pjesë e pasurisë kombëtare.

PASURITË E ÇIDHNËS

Për çidhnakët, dibranët dhe për lexuesit mbarë do të doja të radhisja disa fakte të pamohueshme mbi Çidhnën qytet në lashtësi tani një fshat i vogël, por me histori me monumente natyrore, kulturore, arkeologjike dhe pse duhet mbrojtur ajo nga të gjithë:

1. Çidhna (Oena) qytet e ka nisur jetën e saj 2.500 para krishtit, të dhëna këto të bazuara sipas gjetjeve arkeologjike që i takojnë epokës së bronxit. Historianë të huaj dhe vendas shkruajnë për Çidhnën si qytet i penestisë sikurse e radhit K. Frashëri kur shkruan për Historinë e Dibrës citon; në tre vendbanimet e mëdha peneste ishin; Uskana, Draudaku dhe Oena (Çidhna), së bashku me lumin Seta (Artatus).

2. Çidhna ka 2 Kala. Njëra kalaja që mbronte qytetin dhe tjetra që mbronte Oenën që përfshinte si hapësirë vrojtimi Dibrën, Matin, Lumën e më gjerë deri ne Prizren. Çidhna lidhej si rrjeti I merimangës në çdo kohë me kalatë dhe qytetet e qytezat e si brenda dhe jashtë saj. ....

3. Çidhna me 56 rrugë të brendshme me Dibrën, përfshirë këtu rrugët për në Shkodër e Durrësit, por dhe 6 rrugë që komunikonin me territore te tjera shqiptare Prizrenin, Shkupin etj.

4. Çidhna me monumente të shumta natyrore relativisht me mbi 175 të tilla.

5. Çidhna me 41 monumente kulturore e fetare

6. Çidhna me 24 qendra e gjurmë arkeologjike duke përfshirë rrënojat e kalave, muret rrethuese, rrugët e kalldrëmet, varrezat monumentale, kishat e xhamijat, puset, etj.

7. Çidhna me toponime që ruajnë në kujtesën e tyre historinë që nga lashtësia por në kujtesën radhis mbi 145 toponime me vlera historike të trashëguara në shekuj.

Monumente ujore, historike po rënkojnë në mënyrë të veçantë Seta bujare e ngrohtë strehuese e qindra dibranëve në kohra të ndryshme, që sot po e thajnë po e bëjnë skelet e po i marrin shpirtin.! Një ndër monumentet më të vjetra të historisë së Çidhnës është Seta (artatusi), një vendburimor, por edhe një vendstrehim i sigurtë në kohra lufte të qindra luftëtarëve dhe banorëve të Çidhnës dhe Dibrës. Seta me burimet e Çidhnës janë dhe do të jene domosdoshmëri për të siguruar ujin e pijshëm. Historia shekullore tregon luftërat e përgjakshme dhe pushtuesit e shumtë si grekët, romakët, bizantët, turqit, serbët etj, ku spikat dukshëm jo vetëm rezistenca e banorëve për të mbrojtur vendin dhe tokën e tyre, por dyndjet, reprezaljet, dhe qëndresa dhe ruajtja e identitetit, e fiseve, emërtimeve, traditave, kulturave etj. Për këtë vendstrehim të Setës janë shkruar shumë botime, gazeta e libra sidomos në kohën e ilirëve dhe në mesjetë të epokës së Skënderbeut. Ndër të tjera gryka e Setës ka vlera ekonomike siç është guri I shkrepses (stërralli) që në gjuhën e vendasve quhet guri i urorit, guri i xhevahirit, shkencërisht vlerësohet si karboni më i fortë më i pastër dhe me vlera. Grykën e Artatusit populli I krahinës çdo 15 Mars në ditën e verës marrin ujë dhe bekojnë shtëpitë, bagëtitë, trojet lulen e pranverës (kukurekun) ose kungullin e egër që shërbente si enë për të mbajtur ujin e ftohte dhe të sigurtë. Në Festën e Verës çidhnakët ujin e Setës e urojnë si uji i bekuar.

Populli i Çidhnës të kërkojë me forcën e shpirtit dhe të ndjenjës kombëtare që një herë e përgjithmonë të marrë fund livadhisja e zaptueseve, kasapëve e hajduteve të varreve, të arkeologjisë, të historisë e kulturës që vijnë e shkojnë çdo ditë në me fadroma fantazmë duke bërë dëmtim të monumenteve të kulturës e s'kanë lënë vend pa përmbysur për të gjetur e rrëmbyer thesare që po bëjnë pazare në kurriz të Çidhnës.

Për këto shqetësime e dhimbje po i drejtohem disa institucioneve shtetërore e akademike që mbrojnë monumentet me ligj si më poshtë:

Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, organeve shtetërore përkatëse të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor që të reagojnë dhe t'i largojë duart dhe veprimin e këtyre kasapëve që po cënojnë e zhdukin vlerat, historinë e këtij vendi që është e lidhur me Çidhnën si rajon me Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Të studiojnë dhe të gjejnë momentit e përshtatshëm për të investuar e zbuluar identitetin mijëravjeçar të ruajtur me aq kujdes të vlerave materiale e kulturore. Kemi shprese se dhe rajoni i Çidhnës, Dibra dhe gjithë vendi të ruajë identitetin se pa identitet nuk ka shtet dhe pa shtet nuk ka komb shqiptar. Ky vend nuk duhet populluar e prishur me hece, por të kalojë në etapën e një vendi me histori të gjallë, me kulturë, arkeologji, me monumente kulturore e artistike dhe të bëhet investimi ku banorët dhe turistët, kanë ç'të shohin dhe të flasin për Çidhnën turistike.

sociale



Fushë-Bulqizë, familja Duriçi në pritje të emergjencat civile…

Fushë-Bulqizë, ankthi e tmerri i një familjeje që mbijeton në një shtëpi gjysmë të shembur.

Familje të varfëra, ku mungojnë të mirat materiale të domosdoshme për jetese, mund të gjesh kudo. Por kur kjo varfëri ekstreme mplekset edhe me ankthin e tmerrin e të jetuarit në një banesë gjysmë të shembur, ku vendin e murit të shembur e zë një mushama, kjo e kalon çdo mendje fantaziste për varfërinë ekstreme me të cilën mund të jetojë njeriu. Në raste të tilla nuk bëhet fjalë thjesht për familje që duhet të rropaten thjesht dhe vetëm për të mbushur barkun me bukë, por edhe për tu mbrojtur nga ankthi, stresi e tmerri që i mbërthen, nga rrezikimi i jetës që mund tu vijë nga shembja e shtëpisë.

Me një fat të tillë kaq të trishtë, përballet aktualisht familja e Muharrem Duriçit në lagjen Lepurakë të fshatit Dushaj, të komunës Fushë-Bulqizë. Kishim dëgjuar të flitet për kushtet tejet skandaloze në të cilat jeton kjo familje, por kur u përballëm realisht me të, u ndjemë vërtet keq. Vetëm një qen edhe ai dukej i lodhur nga paushqyerja, na bëri me dije se jemi përpara shtëpisë së Muharrem Duriçit. Pasi ajo që shfaqet para syve, jo vetëm që nuk mund t'i thuash banesë, por as kasolle, apo ahur bagëtish jo se jo. Vetëm llamarina e bardhë me të cilën ajo është mbuluar i jep kësaj kthine amorfe gjysmë të shembur, identifikimin e banesës.

Kryefamiljari Muharremi, rreth të 50-tave, na fton të hyjmë brenda, por ku të futemi! Ç'të shohim! Pamje vërtet tronditëse. Njëra faqe muri e shtëpisë tërësisht e shembur ishte zëvendësuar me një copë mushama dhe shtylla druri që mbanin në këmbë çatinë. Një e vetme dhomë, nëse mund të quhet kështu, me mure të plasaritura, kryente të gjitha funksionet e kësaj familjeje prej gjashtë anëtarësh. Kjo e vetme "dhomë" shërbente për të fjetur edhe pse në të s'kishte krevate dhe shtresa fjetjeje; për të ngrënë



edhe pse nuk kishte as rafte e tavolinë buke, madje as sofër, se për ushqime as që bëhej fjalë; ndenje edhe pse s'kishte as divane, karrige, apo stola për tu ulur. Syri nuk të kapte në këtë dhomë asgjë për të ngrënë, qoftë edhe një copë buke, përveçse një legeni kauçuku me pak miell brenda, në pritje siç dukej për tu kthyer në bukë për katër fëmijët, të cilët ishin në shkollë.

"Shiheni vetë, shpia ësht shemb, mbahet me druna", - nis e tregon kryefamiljari Muharremi. "Me një pension invalidi që marr unë prej 120 mijë lekë të vjetër, ku pjesa më e madhe shkon për të ble ilaçe dhe 30 mij lek ndihmë ekonomike që më ep komuna, çfarë mund të bëj unë për të rritur fëmijët? - Kërkova të vinit paradite pasi nuk doja që fëmijtë të ishin këtu pasi në raste të tilla ata vetëm se qajnë. Katër fëmijët, Mite, klasa e 9-të, Xhesika, klasa e 8-të, Mersim klasa e 5-të dhe Antiljo klasa e 4-rt, jetojnë jo vetëm me ankthin e mbushjes së barkut me një copë bukë thatë, por edhe atë të rrezikut të shembjes së shtëpisë, e cila mund t'i zëjë brënda. – Këtë dimën kemi qenë me fat, na ka pa Zoti, pasi nuk ka ra vdorë që të na shemte shpin. Në këto raste e kemi të vështirë me fëmijët, pasi edhe gjumi natën nuk i ze nga frika e shembjes së shtëpisë".

Hatiçja, bashkëshortja e Muharremit, një grua thatime krejt e heshtur, duket si e pamundur qoftë edhe për të folur.

"– Nuk di çfarë të them, pasi ju e shifni vetë. Në shtëpinë tonë, nuk ka ç'të kapë as ferra, thotë ajo. Më keq s'ka ku të shkojë, të katër fëmijët janë në shkollë, librat na i ka paguar shteti, por s'kemi për veshmbathje. Cuca e madhe, Mitja, tani është e rritur dhe kërkon të vishet si moshataret e saj, por ne s'kemi mundësi. As shtroje e mbuloje për gjumë s'kemi. Burri përveçse është i sëmurë me zemër, është edhe i plevitosur, ka qenë i shtruar në sanatorium në Tiranë, por kam frikë se edhe fëmijët do të kenë këtë fat. Shifeni në çfarë kushtesh jetojmë. Na ka mbuluar pisllëku, pasi edhe capoin (sapunin) e kemi me kursim".

Familja nuk ka asnjë burim tjetër të ardhurash veç pensionit të invaliditetit dhe ndihmës ekonomike shtuar këtyre edhe 900 metër katror toke bujqësore. Edhe zyrtarët e komunës Fushë-Bulqizë, që njohin mirëfilli gjendjen ekonomike në të cilën jeton kjo familje, konfirmojnë se ajo është ndër familjet më në nevojë ekonomike në këtë komunë. Në lidhje me këtë problem punonjësi social i komunës Fushë-Builqizë, zoti Agron Boja, thotë që shtëpia ku banon kjo familje është e pa banueshme, por nga ana e komunës është e pa mundur financimi për këtë familje. "E kemi reklamuar rastin e kësaj familje edhe në qarkun e Dibrës, thonë drejtuesit e komunës dhe presim që ajo të trajtohet nga ana e qarkut, në fondin e emergjencave civile, për t'i ardhur sadopak në ndihmë asaj, pasi mundësi tjetër financiare në si komunë nuk kemi".

HYSEN LIKDISHA

TRAJNIMI

Vetëpunësimi, krijimi dhe financimi i një biznesi të vogël

Në kuadrin e projektit mbi fuqizimin dhe punësimin e të rinjve (YEEP) u mbajtën në qytetin e Peshkopisë dhe të Bulqizës trajnimi i tretë e i fundit me maturantët dhe studentët e qytetit të Peshkopisë. Tematika e trajnimit ishte: "Vetë-punësimi, krijimi dhe financimi i një biznesi të vogël, i cili u zhvillua në mjediset e Hotel Piazza.

TRAJNIMI I STUDENTEVE

Trajnimi i studentëve u bë më datë 14 mars 2014. Edhe ky trajnim, si trajnimet e tjera më parë, u karakterizua nga një interesim i lartë dhe pjesëmarrje optimale. Trajnimi u fokusua në temat si: Përkufizimi i sipërmarrjes dhe sipërmarrësit, avantazhet dhe disvantazhet e një sipërmarrësi, sfidat dhe gabimet e një sipërmarrësi etj., si dhe njohuritë bazë që i duhen një sipërmarrësi për përgatitjen dhe startimin e biznesit të ri, informacionet bazë të nevojshme për financimin e biznesit të vogël dhe kreditimin nga bankat lokale si dhe u shoqërua me një bashkëbisedim direkt me përfaqësues të bankave, të bizneseve të mesme dhe ekspertët e Fondacionit SPRINT. Trajnimi u drejtua e u moderua nga zonja Anduena Stephan, konsulente e jashtme e Fondacionit SPRINT, njëherësh dhe konsulle e nderit e Republikës së Shqipërisë në Landin më të madh të Gjermanisë, atë të Rinit Verior dhe Vestfalisë. Pavarësisht tematikës specifike, ajo me eksperiencën e saj të gjatë prej më shumë se njëzet vitesh në Ballkan dhe në Europën Perëndimore krijoi një klimë të ngrohtë e bashkëpunuese me studentet, duke i bërë ato pjesë shumë frytëdhënëse të diskutimit. Shpjegimi i qartë e tepër konkret i shoqëruar edhe me shembuj të jetës së përditshme krijonte një lehtësim për studentet në përthithjen dhe të kuptuarin e koncepteve të shpjeguara. Trajnimi u pasqyrua edhë në median lokale. Studentët sollën në vëmendje mënyrën se si operojnë bizneset familjare në Peshkopi, mungesën e theksuar të orientimit, mungesën e drejtimit të tyre nga një person me arsimin përkatës dhe mungesën e orientimit e mbështetjes nga institucionet shtetërore. Pas trajnimit, studentët u pajisen me certikatën e pjesëmarrjes, e cila është një detaj shumë interesante në CV e tyre.

TRAJNIMI I MATURANTEVE

Më datë 15 Mars 2014, në mjediset e Hotel Piazza në qytetin e Peshkopisë u zhvillua trajnimi i maturantëve. Pjesëmarrja ishte e mirë. Pjesa e parë e trajnimit u organizua nga znj. Irena Filipi, konsulente e jashtme e Fondacionit SPRINT e specializuar në menaxhimin e operacioneve ditore të bizneseve të vogla dhe të mesme dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Ajo solli në vëmendje sfidat e mëdha të një sipërmarrësi dhe rrisqet që atij i duhet të kalojë çdo ditë. Në vazhdim diskutim u bë nga drejtori i përgjithshëm i fondacionit Sprint, z. Ilir Gegprifti. Maturantët treguan mjaft interes duke bërë pyetje të herë pas hershme. znj. Efigjeni Pici, konsulente e jashtme e SPRINT Foundation, e specializuar në çështjet e financimeve të bizneseve të vogla dhe të mesme me një eksperiencë të gjatë pune pranë Bankes së Pireut në Greqi dhe Raiffeisen Bank në Tiranë, e vijoi diskutimin duke sjelle në vëmendje përgatitjen që duhet të bëjë një biznesmen, nëse do të kërkojë një kredi në bankat e ndryshme. Pesë konceptet baze të biznesit janë shumë të rëndësishme dhe përfshijnë: kapitalin, kolateralin, kapacitetet e sipërmarrësit, karakterin dhe përgatitjen e tij, si dhe kushtet ku do të zhvillojë biznesin. Trajnimi u mbyll nga znj. Stephan, e cila sillte herë pas here shembuj të biznese të vogla në Peshkopi, për të treguar mënyrën se si ato operojnë dhe se si duhet të operojnë.

Trajnimi në Bulqizë me të rinjtë e këtij qyteti u zhvillua më 17 mars. Fondacioni SPRINT pavarësisht numrit të kufizuar të vendeve për trajnim që kishte në program, vendosi të zgjeroje bazën e studentëve duke i zhvilluar trajnimet në vendin më të afërt të tyre. Kështu, i gjithë qarku i Dibrës përfitoi nga këto trajnime të detajuara dhe shumë të vlefshme për të ardhmen e rinisë në tregun e punës.

Këto trajnime përmbyllin edhe fazën e trajnimeve të maturantëve dhe studenteve në të gjithë qarkun. Në vijim pritet të zhvillohet panairi i punës me pjesëmarrjen e bizneseve e institucioneve vendase dhe atë të studentëve e maturantëve. Një numër prej me shumë se 60 biznesesh të qarkut do të kenë mundësinë të komunikojnë direkt me të rinjtë e trajnuar në këtë program, të vendosin profilet e biznesit të tyre dhe vendet e lira të punës në portalin e punës të përgatitur nga Fondacioni SPRINT si dhe të shfrytëzojnë më shumë se 300 CV të studentëve dhe të të rinjve të shkollave të mesme për të plotësuar këto vende të lira pune.

Ky organizim bëhet në kuadrin e projektit mbi fuqizimin dhe punësimin e të rinjve të qarkut Dibër nga Fondacioni Sprint Tiranë, bashkëfinancuar nga Bashkim Europian.

ELONA MAZARI

veprimtari

Java Globale e Parasë, Ora e Tokës dhe Rruga e Arbërit, tre veprimtari në gjimnazin e Maqellarës

Nga **ZAMIRA GJELESHI**

JAVA GLOBALE E PARASË

Tre vite më parë gjimnazi i maqellarës u bë pjesë e projektit të BSH "Financat personale në duart tuaja" si kordinim i dëshirës dhe i shqetësimit për të vazhduar arsimimin si të rinj të Maqellarës, të cilëve na bashkon rruga për vlerat hyjnore dhe angazhimi për t'i shërbyer komunitetit të Maqellarës dhe shoqërisë shqiptare, duke besuar se kjo rrugë është më e mira dhe me një ndikim të dukshëm në kushtet e integrimit evropian dhe globalizmit.

Pas 3 vitesh bindja jonë në rëndësinë e këtij misioni sa vjen e bëhet më e fortë. Sot puna dhe përkushtimi ynë janë shpërblyer . Ne jemi aktivë në përpjekjet tona për të paraqitur një model të qëndrueshëm dhe të qartë. Një model që bazohet në vlerat njerëzore dhe që shëmbëllehet në njerëz që kontribojnë në komunitetin, ku jetojmë..

3 vite më parë ishim modest, por dëshira për tu arsimuar ishte shumë më e madhe.

Natyrshëm, vitet në vazhdim bënë që bagazhi ynë shkencor të zgjerohet, dhe projekti ynë të jenë konkret dhe me ndikim në ëndrrën tonë të madhe për Universitet.

Sot numri i aktorëve shoqërorë, dashamirësve,dhe miqve të gjimnazit që kanë besuar dhe na janë bashkëngjitur në misionin tonë është rritur. Gjimnazistët e Maqellarës mbeten kapitali kryesor dhe shpirti që i japin jetë Gjimnazit.

Sot ne mbushim 3 vjet në Gjimnaz. Në jetën e një njeriu janë shumë, megjithatë e pranojmë 3 vite përpjekje për të projektuar një të ardhme më të sigurt dhe me më shumë dritë në shoqërinë shqiptare është me të vërtetë pak.

Bashkë me Gjimnazin dhe ne që identifikohemi me emrin e tij jemi 3 vjet më të rritur.

Idealet, objektivat dhe ambiciet tona janë më të prekshme, më efektive.

Sot ne ndihemi më të vetëdijshëm për sfidat dhe përgjegjësitë që na takojnë për të ardhmen.

Në 3 vite shumçka mund të ketë ndryshuar, por misioni ynë mbetet aktual.

Ne besojmë se ky mision nuk vjetrohet dhe nuk e humbet rëndësinë e tij, sepse i përgjigjet një nevoje thelbësore, nevojës për t'u arsimuar, si themel i vlerës njerëzore, që vazhdimisht duhet ujitur për të qenë e gjallë dhe e freskët.

Në kurorëzojmë e nismës me karakter ndërkombëtar Java Globale e Parasë, në gjimnazin e Maqellarës ishin të papërsëritshëm, guvernatori i BSH z.Ardian Fullani, drejtori i përgjithshëm dhe anëtar i bordit drejtues të BKT Z. Seyhan Pencabligil, kabineti guvernatorit, Arlinda Kolenico, përfaqësuesi i DAR Defrim Kaleci, kryetari i komunës z. Bardhyl Agolli, profesorët Nazmi e Kadrie Gjeleshi.

Në faqen zyrtare të BSH Gjimnazi i Maqellarës është pjesë e aktiviteteve të Guvernatorit Ardian Fullani .Guvernatori Ardian Fullani tha në këtë veprimtari se "Sot u përforcua bindja për mikpritjen e dibranëve për të cilën më ka folur im atë gjatë periudhës së luftës më 1944. Sot Gjimnazi Maqellarë është pjesë e rrugëtimit të BSH mbi edukimin ekonomik dhe financiar.

Përse i kushtojmë rëndësi edukimit ekonomik dhe financiar?

Në një kohë kur komunikimi ka marrë një rëndësi të veçantë dhe metodat për realizimin e tij janë në ndryshim të vazhdueshëm, aktiviteti i Bankës së Shqipërisë përditë e më shumë po i përkushtohet edhe çështjeve të transparencës dhe edukimit financiar të publikut. Duke vënë në qendër të vëmendjes ndërtimin e urave të komunikimit me të gjitha grupet e interesit, Banka e Shqipërisë synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm, që t'i shërbejë institucionit për rritjen e efektivitetit të transmetimit në ekonomi të vendimeve të politikës monetare.

> Të rinjtë arrijnë madhështinë dhe demonstrojnë risi në përfshirjen financiare dhe edukim financiar, social dhe në mjetet e jetesës së të rinjve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Nisur nga e kaluara e vendit tonë, por edhe nga ritmet e vrullshme me të cilat zhvillohen ekonomia dhe financat botërore, Banka e Shqipërisë ka parë të arsyeshme të ndërmarrë një sërë nismash konkrete në fushën e edukimit ekonomiko-financiar, për krijimin e një kulture të mirëfilltë financiare në shoqërinë tonë. Një kulturë e tillë ndihmon konsumatorët, prodhuesit dhe investuesit të marrin vendime të goditura financiare dhe njëkohësisht bankën qendrore të arrijë më lehtë objektivin e saj për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Banka e Shqipërisë i kushton vëmendje të veçantë brezit të ri, veçanërisht edukimit të studentëve të cilët do të jenë protagonistët e jetës ekonomike të së nesërmes. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë e konsideron investimin e saj në formimin e tyre si tepër të rëndësishëm, për të siguruar jo vetëm të ardhmen e tyre, por edhe atë të vendit.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë e ka parë të arsyeshme të ndërmarrë disa nisma konkrete në fushën e edukimit ekonomiko-financiar të studentëve nëpërmjet aktiviteteve si takim me Guvernatorin, Vizitë në BKT, Raifeissen Bank, Credins Bank. Jam befasuar nga prezantimi i nxënëses Hygerta Ilnica dhe ekpozita nga Fatjona Neziri Paratë kurrë nuk e krijojnë një ide, por është ideja që krijon para…

Ndërsa drejtori i Përgjithshëm dhe anëtari i bordit drejtues të BKT, z. Seyhan Pencabligil tha se "Babai im është nga Dibra, besoj se së shpejti do të kemi degën tone të BKT në



Maqellarë dhe gjimnazistët e Maqellarës do të jenë pjesë e sistemit të kredive për studentë."

"ORËN E TOKËS"

Më 29 Mars, në orën 20:30 deri ne 21:30 i gjithë planeti "dritat u fikën " për 1 orë, duke filluar nga Australia e deri ne Kaliforni. Ky është cilësuar si "aksioni më i madh dhe më masiv mjedisor që historia ka njohur ndonjëherë". Çdo 1 ndër 3 banorë të Tokës fikën dritat dhe gjithë aparaturat e tepërta elektronike nëpër shtëpitë apo bizneset e tyre. Kjo është "Ora e Tokes - Earth Hour", ora të cilën ne njerëzit ia kushtojmë shtëpisë sonë të përbashkët, Tokës, në një veprim sa simbolik, sensibilizues, aq edhe efikas e të fortë kundër ndryshimeve klimatike, që po ia marrin frymën asaj. Logjika qëndron në lidhjen e drejtpërdrejtë që ekziston midis energjisë që ne përdorim dhe ndryshimeve klimatike që po ndodhin: konsumi i energjisë është përgjegjës për mbi 60 % të shkarkimeve të CO_2 në atmosferë, e rrjedhimisht kursimi i energjisë është veprim, që kontribuon drejtpërdrejt në reduktimin e shkarkimeve të gazrave serrë. Secili prej nesh, si çdo qytetar i botës, ka rolin e vet aktiv në përpjekjen globale kundër ndryshimeve klimatike, edhe me veprime të thjeshta si ky i nxitur nga "Ora e Tokës".

"Ora e Tokës" ka lindur si një iniciativë e "ËËF Sidney" në vitin 2007 në Sidnej dhe çdo vit e ka zgjeruar përkrahjen e saj në botë. Shqipëria e ka mbështet që në vitin 2008. Në "Earth Hour 2014" morrën pjese 7001 qytete nga e gjithë bota, në mbi 152 vende dhe me mbi 2 miliardë përkrahës apo pjesëmarrës vullnetarë.

Këtë vit "Earth Hour" është shndërruar në "Earth Hour +", pra në "Ora e Tokës + " duke sugjeruar që ky veprim simbolik i 29 Marsit të shndërrohet për gjithsecilin në fillimin e një veprimi kundër ndryshimeve klimatike, me veprime të vogla apo të mëdha sipas mundësive të gjithsecilit.

"Ora e Tokës 2014" është viti i parë i pjesëmarrjes për Gjimnazin Maqellarë..

Ne u bëmë pjesë "Ora e Tokës 2014", duke siguruar që Dibra të marrë pjesë në këtë aktivitet masiv, duke fikur dritat dhe Gjimnazi Maqellarë merr statusin e ambasadorit global.

"Ora e tokës 2014" u shoqërua me shumë veprimtari si fushata e firmosjes publike "Edhe unë për Orën e Tokës", që ishtë shprehja personale e mbështetjes nga ana e çdo personi për pjesëmarrje në Orën e Tokës, lëvizja nëpër fshatra me biçikleta për të promovuar pjesëmarrjen, vizitë në Universitetin "Aleksandër Moisiu", filiali i Peshkopisë dhe shkollën e mesme Profesionale "Nazmi Rushiti", ndeshje futbolli, një instalacion me qirinj për të krijuar atmosferën e reflektimit për atë se çfarë mund të bëjmë personalisht të gjithë. Ora e Tokës nuk është një orë në terr . Është një akt simbolik për të menduar rreth planetit tonë dhe ndikimin tonë mbi të. Të japim ndihmën tonë për planetin, të votojmë për Tokën, kundër ndryshimeve klimatike!

FIRMOSJA E PETICIONIT PËR RRUGËN E ARBËRIT…

Gjatë veprimtarive në gjimnazin e Maqellarës, u organizua edhe një fushatë për mbledhjen e firmave për peticionin për Rrugën e Arbërit. Bashkë me ne, natyrshëm janë rritur sfidat dhe përgjegjësitë. Gjimnazi do të mbetet një derë e hapur bashkëpunimi për të gjithë ata që besojnë se e ardhmja u përket atyre që punojnë për të. Pas 3 vitesh studimi gjimnazistët janë të formuar intelektualisht dhe për t'u integruar në tregun e punës. Duke qenë të qartë dje, që nuk lamë vendlindjen, që të diplomohen në gjimnazin tonë, të tillë ne synojmë të jemi nesër në projektin tonë të rritjes. Universiteti është sfida jonë e rradhës. Pas 3 vitesh studimi do të ktheheni për të përfunduar projektin tonë për përparimin e Maqellarës.

Sot, po, po sot të rinjtë e Maqellarës kanë qenë qytetar të denjë global dhe ekonomik.

Java Globale e Parasë, Ora e Tokës dhe peticioni i Rrugës së Arbërit janë dëshmuese e idealit, vizionit dhe vlerave për një një Shqipëri me karakterin e saj në Evropë dhe në botë!



E drejta dokësore në Lumë



Nga Dr.FEJZULLA GJABRI

Shefqet Hoxha, studiuesi më i njohur në visin e Lumës e më gjërë, ka pak kohë që na ka dhënë një nga veprat më të çmuara të etnologjisë e kulturës së Lumës, Kanunin. Kjo vepër na detyron të hedhim një vështrim shkurtazi të punës së tij disavjeçare. Sigurisht që është pak vështirë të shkruash për veprimtarinë shumëvjeçare të këtij studiuesi, por më e vështirë është të hysh në veprën e tij madhore "E Drejta Dokësore në Lumë" (Kanuni). Megjithatë, e kam për nder dhe jam i priveligjuar që po shënoj diçka në lidhje me këtë vepër madhore.

STUDIUESI I PËRKUSHTUAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Diku shkruan: Në gusht të vitit 2013 u mbushën plot 63 vjet nga përjetimi im i parë letrar, një vjershë rinore kushtuar Kosovës, atbotë martire, e shkëputur nga atdheu...". Atëhere ishte nxënës në shkollën pedagogjike të Peshkopisë, ndërsa vjershën e shkroi, siç thotë vetë "kur ndodhesha me pushime në vendlindjen time, në Bicaj". Shefqeti nisi me një vjershë e vazhdoi si studiues i kulturës popullore, i historisë e etnologjisë shqiptare, për të ardhë deri në veprën më të madhe të tij, "E drejta dokësore në Lumë (Kanuni). Para saj, përgjatë 60 viteve e më shumë, ka arritur si pakkush të mbledhë edhe të dhëna të rëndësishme dialektologjike, toponimi, shpalime historike e portrete atdhetarësh, etnologji, mitologji, demografi, folklor, leksikologji, si dhe studime të fushave të tjera. Pjesa më e madhe e tyre janë botuar, por, siç thotë vetë se, "edhe shume tjera janë në doreshkrim". Punimet e tij, të botuara në vëllime të veçanta përkojnë me vitet e vjershës së parë, (para 63 vjetësh), gjithsej 63 vëllime. Rrallëkush ka një bibliotekë të tillë. E thashë këtë shifër, pasi të shkruash për Shefqetin, duhet të mendohesh mirë. Megjithatë, besoj se sadopak mund të vlejë edhe ky shkrim, për të vënë në dukje punën intelektuale të tij.

E nisi punën mësues në Kukës më 1 shtator 1952, ishte drejtues në disa shkolla, vazhdoi në organizmat kualifikuese të mësuesve (Kabinet pedagogjik), pedagog i jashtëm i Institutit pedagogjik të Shkodrës, deri në deputet I Kuvendit të Shqipërisë. Tashmë mban titullim "Mësues i Popullit", Doktor i shkencave dhe së fundi, me vendim të Komisionit Kualifikimit Shkencor, ka titullin "Profesor i as.Doktor". Sigurisht që titujt kanë rëndësinë e tyre, por më e rëndësishme është veprimtaria e tij intelektuale në disa lëmije të kulturës, papërtueshmëria në hulumtimin e vlerave trashëgimore të visit të Lumës e më tej. Gatishmëria e tij është edhe si kumtues në promovime, në përkujtime, në festivale kombëtare si në Gjirokastër e në viset e Kosovës, në bashkëpunime me institucione shkencore si me Institutin e Kulturës Popullore, me Institutin e Gjuhës e Letërsisë, Historisë etj. Profesor Shefqet Hoxha këto ditë ka 80-vjetorin e lindjes dhe i urojmë jetë të gjatë.

PAK MBI KANUNET

Studiuesit e e përcaktojnë Kanunin si tërësi të normave juridike, rregullave të sjelljes, të pashkruara, të vendosura në kohë të ndryshme e të përcjella në traditën gojore nga njëri brez tek tjetri dhe që shërbejnë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në mes njerëzve, në fusha të ndryshme të jetës, zbatimi i të cilave sigurohet sipas traditës nga vetë bashkësia e njësisë së vetëqeverisjes vendore, pa forcën e shtetit. Pra rregulla të jetëës shoqërore, kur mungon forca e shtetit. Vlera e tij përdoruese në stadet e tashme nuk ka kuptim. Por, çdo gjë, qoftë edhe object, ka dy role: rolin përdorues dhe rolin ekspozues. Tamam si një vegël, që ka qënë përdorur, por që i ka ikur koha, ngaqë ka dalë një mjet tjetër, më i përparuar se ai. Gjithsesi njerëzit e mençur nuk e hedhin atë vegël, por e mbajnë si tregues të një kohe të mëparshme. Besoj se edhe Kanunit i ka mbetë vlera eksopzuese, vlerë që duhet të ruhet.

Një studiues i njohur evropian, Halbëachs, thotë: "Historia fillon vetëm atëhere kur tradita nuk është me aktive dhe kujtesa sociale është shuar". E mora këtë thënie, pasi Kanuni e ka kryer misionin e vet. Tashmë shihet si një botë juridikisht e mbyllur dhe artistikisht e pasur. Për ta ruajtur, ka pasë dhe ka njërëz të mençur, që me talentin dhe përkushtrimin e tyre na e dhanë edhe të shkruar edhe të analizuar.

Së pari, merita kryesore u takon brezave që rregullat kanunore i përcollën nga brezi në brez me të njëjtin mekanizëm si gjuha apo folklori, pra, si një traditë orale në qarkullim të shumëfishtë gojor. Së dyti, duhej një Shtjefën Gjeçov ta shënonte, për t'u njohur jo vetëm brenda viseve shqiptare, por edhe nga bota, si KLD. Për këtë Kanun (KLD), Edit Durham, shprehet se ky kanun ishte në fuqi në të gjitha Malet e Shqipërisë së Veriut, si për muslimanët, ashtu edhe për të krishterët.

Studimet tregojnë se në viset tona kanë vepruar disa kanune. Kështu, në Kanunin e Dibrës janë grupuar norma që rregullojnë probleme familjare, detyrime, qeverisje, ndëshkime e falje, që aq profesionalisht i ka trajtuar Xhafer Martini në veprën "Kanuni". Meqë jemi te Xhafer Martini, ky autor ka shkruar edhe një libër "Kur Vdiste Kanuni", në të cilën dallon dy vdekje të Kanunit: e para kur mblidhet dhe kodifikohet dhe e dyta kur humb funksionin. Në fakt, kjo gjetje shtrin krahët në të gjitha kanunet, pasi edhe janë mbledhur e botuar libra dhe sigurisht edhe nuk kanë funksione në ditët e sotme.

Kanune ka në shumë popuj. Në viset shqiptare ka jo vetëm në Veri, po edhe në Jug, si psh, "Kanuni i Labërisë". Themelet këto kanune i kanë të njëjta, me ndonjë ndryshim të vogël. Kështu, ky fundit ka një tendencë lokale më të fortë, gjë që e bën disi më të dukshëm ndryshimin, por pa ndryshuar thelbin si rregullator.

I përmenda këto kanune të viseve të ndryshme shqiptare, pasi njerëzit japin e marrin, kanuni lëviz, duke plotësuar njëri-tjetrin. Fundja, kjo trashëgimi, si të gjitha trashëgimitë tjera kulturore janë pasuri e popullit.

DISA PUNIME KANUNORE

Studiuesit e kanë parë kanunin si trashëgimi juridike të popullit, si edukatë, psikologji, pedagogji, pse jo edhe si filozofi. Nga pamje e shumanshme, disa prej tyre, krahas mbledhjes, kanë bërë dhe interpretime të zanafillës e të shtresimeve të ndryshme, siç qenë Franc Nopça, Edit Durham, E. Koci, M Hazllëk etj. Disa nga këta studiues, vendas a të huaj bënë edhe disa studime, që i botuan në organe të ndryshme a si libra më vete, me të cilat mbrojtën disertacione e doktoratura. Ndër më të njohurit përmendim monografinë e S. Vilarit e të Zef Valentinit e ndonjë tjetër. Radha e studiuesve është e gjatë.

Nga Lufta e Dytë Botërore e këtej janë disa eksplorues të tjerë që do të mbledhin e do të botojnë punimet për kanunet popullore. Gjykohet se studimi më serioz është ai i Rrok Zojzi dhe Ismet Elezit, të cilët mblodhën norma të kanunit në Veri e në Labëri e që një pjesë mbetëm materiale arkivore. Kadri Halimi (Kosovë) mblodhi me eksplorime terreni materiale nga kanuni e botoi disa shkrime. Kështu u mblodh e u botua Kanuni i Kurbinit ("Kanuni i Skanderbegut") nga Frano Ilia; po kështu u mblodh nga Xhemal Meçi me disa vëllime: Kanuni i Pukës, Kanuni i Mirditës, i Malësisë të Gjakovës; Punime me vlerë për kanunin ka shkruar edhe Pal Doçi, Mark Tirta etj. Së fundi kanë dalë në dritë dy kanune: Kanuni i Dibrës dhe i Lumës. Pikërisht ky i fundit, u mblodh e u sistemua nga Shefqet Hoxha.

E DREJTA DOKESORE E LUMËS

Kanuni i Lumës, siç ka edhe emërtimin, ka vepruar në Lumë, (rrethi i Kukësit) dhe është ruajtur i plotë, me veçantitë e veta dhe origjinal. Kjo nuk do të thotë se është s'ka bashkëveprim me kanune të viseve të tjera. Po ta shohësh me kujdes, vëren se ne ndryshim nga KLD, i cili përfshin norma juridike shumë të lashta dhe të ashpra, Kanuni i Lumës është më i moderuar, me elastik dhe me tolerant. Në thelb edhe ky kanun është i njëjtë me KLD, por ky i Lumës ka evoluar më tepër, duke u përshtatur më mirë ndryshimeve ekonomike dhe shoqërore. Në disa aspekte, edhe Kanuni i Dibrës afrohet shumë më atë të Lumës. Besoj se kjo vjen, se këtu kemi përfshirjen e disa normave të sheriatit (pa u thënë të tilla), të cilat kanë hyrë në jetën e përditshme pas përqafimit të fesë islame nga kjo pjesë e popullsisë. Dihet se te KLD kemi përzierjen e normave të së drejtës zakonore me ato kanonike. Me këtë vepër ndihmon në studime të mëtejshme e më të thelluara në etnokulturën shqiptare, në traditën juridike dokesore të këtij populli. Me Kanuni i Lumës, autori e bën Lumën ashtu siç ka qenë dhe është, krahinë – minierë vlerash, ku kanë ç'të marrin etnologët, sociologët, historianët, juristët etj, për të hyrë më thellë në të fshehtat e traditës popullore. Luma e meritonte sistemimin e kësaj tradite dhe autori ia ka dhënë meritën. Shefqet Hoxha i ka njohur mirë fshatrat, krahinat e mikrokrahinat e Lumës, të bëra objekt kërkimesh e si rrjedhojë dhe materiali i mbledhur është përzgjedhur dhe sistemuar me profesionalizëm. Këtu ka vënë në jetë parimin e njohjes në kompleks të etnokulturës për vendin që e ka bërë objekt kërkimesh në ligjet dokesore.

NDËRTIMI I VEPRËS

Studiuesi Shefqet Hoxha ka vite që merret, veç të tjerave, me mbledhjen e traditës juridike në Lumë. Disa herë edhe ka debatuar në shtyp për Kanunin në përgjithësi e KLD në veçanti. Disa tituj janë: Kanuni nuk është i Lekë Dukagjinit; ose: Princi i përfolur Lekë Dukagjini, a është e vërtetë se Kanuni është i Lekë Dukagjinit?; Kanuni i Lumës (artikull shkrimor më 1989) e të tjera reflektime në simpoziume e promovime të këtij zhanri. Veç këtyre ka dhe studim paraprak për Kanunin e Lumës, dorëzuar në Arkivin e ish-Institutit të Kulturës popullore (sot IAKSA). Pra, një parapërgatitje, për të dhënë veprën e plotë të Kanunit të Lumës.

Pas një 'Hymje' nis me Rendin shoqnor – shtëpinë (familjen), që në kreun e parë është "Gjindja e lidhjet e saj'; janë 15 kreje që kanë në qendër shtëpinë(familjen), me të zotin e shtëpisë, të zojën, fejesë e martesë, deri të ardhurat. Pas 'Shtëpisë' (familjes) shtjellohet pjesa e Lidhjeve rituale, me ritet kryesore. Aty është darsma, deka, miku e deri te itifaket me pleqtë e fjaltorin. Më poshtë trajtohen bashkësitë fisnore, mëhalla e katundi, bajraku e dheu, të dhëna këto qartë e saktë. Pjesa e Dhënies së të drejtës, veç kodifikimit, ka edhe shembuj ilustrues, që e bëjnë punimin të jo vetëm të kuptueshëm, por edhe të larmishëm e tërheqës.

Vepra është e ndarë ngë tri grupime kryesore dhe një pjesë të veçantë. Kryesoret janë: Rendi shoqnor, Rendi ekonomik dhe Pjesa ndëshkimore. Si pjesë e veçantë, janë mbrapshtinat kryesore simbas kanunit të Lumës. Pas këtyre pjesëve është materiali praktik dhe dokumente e fotografi, si dhe një bibliografi e pasur.

Në pjesën "Rendi shoqnor", veç Lidhjeve e riteve rituale, është Sajdisja e mikut, Nderi i shtëpisë e ai shoqnor, por edhe Besa e të tjera, deri te qendrimi ndaj Gjakut, si parime themelore të Kanunit. Autori i ka pa këto edhe si 'nene' e kazuse edhe ndërvejti në Lumë, por edhe nga KLD, apo rrethinat e Lumës. Organet dhe institucionet kryesore të së Drejtës, jepen në tetë kreje. Të bien në sy Itifaket e kararet e kuvendeve, roli i Dyerve të mëdha, Pleqtë e pleqësitë, tema të cilat autori i ka trajtuar teorikisht dhe me shembuj edhe në studime të tjera, ndërsa tani i jep me nene juridike dhe kazuse.

Objektet fetare dhe dhe shërbimin fetar, e trajton në pesë kreje, si Xhamia, Imami, Vakufi, Teqja dhe Vorrest. Paraqitja e kësaj kulture shpitërore saktë, ka ndikuar dhe besoj se edhe ndikon në marrëdhënie shoqërore, në zbutjen e kontaditave, por, që është më e rëndësishmja, nuk mohohet tjetri.

Ekonomia, veçanërisht ekonomia bujqësore e blegtorale zënë pjesë e dytë të vëllimit, të ndarë në njëzet e gjashtë kreje. Që nga prona e kufini, bujku, çobani e hyzmeqari, saktësohen me logjikën e ftohtë të kanunarëve. Ajo përvojë qindravjeçare e kësaj popullsie, tashmë është dokumentuar në këtë vepër në krejet që flasin për objektet publike, si udhët, ujin, mullinin, gjuetinë etj, me gjuhën e shkruar. "E damja nuk është bidat", thuhet diku. Aty janë detyrimet marrëveshjet, shitjet e blerjet, e falmja e shumë çështje të jetës në vllazni apo në komunitet.

Pjesa e tretë ka të bëjë me ndëshkimin., e dhënë kjo në 'Caktimi dhe zbatimi i ndëshkimeve, përgjegjësia ndëshkimore, dhunimet, vrasja në besë, mjetet e provës në vrasje etj. Të cilësuara si 'Mbrapshtina kundër pasurisë', në kreun e parë shënohen vjedhjet, thyemja e shtëpisë, raste të veçanta në kësi rastesh etj. Me interes janë disa norma me 'nene' e kazuse për 'Çlirime e përjashtime nga kanuni", të cilat jepen krahasimisht me KLD.

Materialet praktike kanunore zënë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit, të cilat paraqiten me gjuhë të pasur dhe stil të përshtatshëm , që jo vetëm tregojnë origjinën e burimit, por të japin bukurinë e prozës së shkurtër.

Së fundi, janë dokumentet e fotot, ku një vend të rëndësishëm zënë edhe portrete e profile personash të ndryshëm, që kanë bërë emër në një drejtim të caktuar. Disa prej tyre janë njerëz, në dukje, të zakonshëm, të thjeshtë, që të lënë një dëshmi, një një mesazh për brezat e ardhshëm. Me këtë punë, autori ka treguar se, krahas personaliteteve të shquara deri me përmasa kombëtare, janë edhe të tjerë më pak të njohur, por të rëndësishëm për shoqërinë, për komunitetin ku kanë jetuar apo jetojnë.

Me botimin "E drejta dokësore në Lumë" (Kanuni), Shefqet Hoxha, krahas dokumentimit të vlerave juridike trashëgimore të Lumës, ka krijuar hapësira të gjëra për studiuesit shqiptarë e të huaj, që të bëjnë hulumtime e studime shkencore krahasuese me kanunet e tjerë. Në fakt autori ka përdorur edhe meodën krahasimore, veçanërisht me KLD, për të lënë shteg krahasimisht edhe për të tjerë kanune, si atë të Dibrës, të Skënderbeut, të Labërisë etj. Gjithashtu, lë shteg për diskutime, për shtesa, vërejte etj, gjë që do të thotë se nuk ka shterrim, veçanërisht kur flitet për traditën në përgjithësi e atë juridike në veçanti.

recensë

Kuptimi i zgjeruar dhe i thelluar për Kanunin, vështrimi i Kanuneve Shqiptare si një Kanun, përkimet dhe ndryshimet e tyre të parë përmes krahasimit direkt të shumë zgjidhjeve dhe dukurive, janë tri risi të librit "Kanun" të Xhafer Martinit.



Risitë te libri "Kanun" i Xhafer Martinit

Nga **IBRAHIM MILUSHI** *

Merita më e madhe e librit të Xhafer Martinit "KANUN" është se ai sjell mjaft risi që nuk janë në asnjë studim tjetër të derisotëm për Kanunin. Risa e parë dhe mjaft e rëndësishme qëndron në faktin që ky autor ka bërë përcaktimin se çfarë është Kanuni. Edhe të tjerët që janë marrë me këtë gjë, por këto përcaktime, duke i vënë të gjitha në një emërues të përbashkët, e kanë cilësuar Kanunin si e drejta juridike ose trashëgimia juridike e popullit shqiptar. Ky përkufizim për Kanunin nuk është i gabuar, por, sipas autorit Xhafer Martini, është i paplotë, mbasi Kanuni është shumë më tepër se sa kaq.

Kanuni, sipas Xhafer Martinit, është enciklopedia e jetës shqiptare, është jeta e shqiptarit që para se ai të lindë dhe shumë kohë mbasi të ketë vdekur. Kanuni, sipas autorit Martini, ishte pedagogjia e parë shqiptare, psikologjia e parë, fakulteti i shkencave shoqërore, universiteti, gjithçka që duhej për ta mbajtur popullin të bashkuar, me gjuhë dhe kulturë të vetën, me identitet kombëtar të pacënuar. Kanuni ishte një vepër që do ta zëvendësonte alfabetin, abetaren, shkollën, librin dhe shumë gjera të tjera që mungonin. Ky ishte një libër i madh, i gjallë, i pashkruar, i pambledhur dhe i pafutur në përmasat e një libri të zakonshëm, libër gjaku, që, në pamjen e parë, dukej sikur ishte vetë vdekja, asgjësimi. Por kur hyn në të, shtresë pas shtrese, për të shkuar në fund, në vend që të të mbysë errësira, shikon dritë, në vend që të të merret fryma, gjoksin ta hapë oksigjeni, ajeri i pastër i thellësive, dhe, kur të mbërrish në fund fare, do ta shikosh vatrën e pastruar dhe zjarrin e ndezur dhe atëherë (ah, atëherë!) do ta kuptosh mundimin e këtij populli i cili, për të mos u asgjësuar, nuk krijoi vdekjen, por jetën. Ky autor në studimn e tij bën të qartë dhe argumenton se normat juridike, ligjet, janë vetëm një pjesë e Kanunit, sepse ai ka edhe dije të fushave të tjera nga më të ndryshmet: filozofike, historike, morale, fetare, natyrore, gjeografike, estetike, arkitekturore, arkeologjike, linguistike, estetike, dije të pafundme të të gjitha fushave njerëzore. Prandaj është enciklopedi e jetës së shqiptarëve. Kanuni ishte një ansambël drejtësie ku përcaktoheshin dhe kategoritë e ndryshme morale, si nderi, dinjiteti, besa, mikpritja, mirësjellja qytetare e familjare, e drejta civile, e drejta e punës, e drejta familjare, ndarja e pasurisë etj. Aty përcaktohej edhe mënyra e uljes në sofër dhe ngritjes prej saj,mënyra si të haje dhe sa të haje, se mbahej parasysh sentenca: "Njih mexhelisin e fol, shih sofrën dhe ha". Kanuni ishte i mbushur edhe me ndalime dhe këshilla. Ai kishte ndalime të arsyeshme për ta hijeshuar dhe zbukuruar jetën dhe njeriun jo për ta nxjerrë nga binarët e njerëzores. Të studiosh Kanunin shqiptar do të thotë të merresh me njërin prej qytetërimeve më të lashta që u ka rezistuar shekujve dhe mijëvjeçarëve. Kam këtu para sysh thënien e Braudel cili në veprën madhore "Gramatika e qytetërimeve" ka shkruar se karaktersitikë për qytetërimet është përbërja e tyre nga struktura të vjetra që zgjasin shumë në kohë dhe që kanë tipare të dallueshme dhe origjnale, dhe u japin qytetërimeve fytyrën e tyre të veçantë, qenien e tyre. Qytetërimi ynë i lashtë është Kanuni - një strukturë e rëndë, tipike, e palëvizshme, shumë e qëndrueshme.

Një risi tjetër e këtij studimi qëndron në faktin se ai nuk dallon vetëm një kanun, fjala vjen vetëm Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ai e shikon Kanunin në tërësi si një vepër që nuk lidhet me asnjë krijues, as me Lekë Dukagjinin, as me Skënderbeun, as me Idriz Sulin dhe me asnjë njeri tjetër sado i shquar të ketë qenë ai.

Mbledhja e Kanunit dhe kodifikimi i tij, thotë autori, kanë rëndësi të madhe, por rëndësi më të madhe ka krijimtaria e popullit, prodhimi i tij. Prodhmi është kryesori dhe Kanunin e ka prodhuar populli shqiptar. Sot më e drejtë është të themi se kemi një Kanun-Kanunin Shqiptar me dallimet dhe përkime e shumta midis tyre, por edhe me kodet juridikë ballkanikë dhe më gjerë. Sot janë botuar shumë kanune dhe variante kanunore, sidomos varinate të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Derisa nuk ishin botuar kanunet që kemi sot, ishte e natyrshme që Kanuni i Lekë Dukagjinit të ishte qendra e të drejtës sonë juridike, vatra ku ishte drejtuar vemendja e të gjithë studiuesve e admiruesve të huaj, por edhe adhuruesve dhe anatemuesve të vendit. Por botimi i kanuneve të tjera e ndryshoi qendrën e gravitetit dhe krijoi një qendër të re të përbashkët për gjithë trashëgiminë tonë juridike. Autori nuk ka arritur në këtë përfundim vetëm nga studimi i brendshëm i kanuneve, por edhe nga përqasja e dijeve me fusha të tjera të ngjashme. Autori sjell në vëmendje faktin se botimet e viteve të fundit u kanë dhënë një pamje tjetër edhe raporteve "qendër periferi" përsa i përket trevës së ruajtjes së eposit, të cilin e shikonim të izoluar vetëm në zonën e Nikaj-Merturit, se edhe në krahinën e Rugovës lahutarët edhe sot e kësaj dite, këndojnë varinate të ndryshme të këtij eposi. "Për analogji, - shkruan Martini, - themi që vatra e Kanunit të Lekë Dukagjinit nuk është as e vetme e as më kryesorja në vendin tonë. Ka mjaft botime që flasin edhe për vvatra të tjera. Kanunet marrin e japin me njeri-tjetrin. Përngjasimi dhe ndryshimet janë pasuri.

Tek mendimi se kemi një Kanun Shqiptar këtë autor nuk e ka çuar vetëm paralelizmi me Eposin e Kreshnikëve, por edhe krahasimi që ka bërë vetë midis tre kanuneve: Kanunit të Lekë Dukagjiit, Kanunit të Skënderbeut dhe Kanunit të Dibrës. Në librin Kanun, ka plot kapituj që merren me vështrimin krahasues të kanuneve që përmendëm, dhe kjo është një risi tjetër e madhe e këtij libri. Autori nuk i krahason kanunet për të vënë nota, por për të parë ku qëndrojnë përbashkësitë dhe dallimet. Kemi disa kapituj ku ai bën këtë krahasim midis kanuneve. Nuk krahasohet çdo gjë, çdo nen i kanunit të Lekë Dukagjinit me Kanunet e tjerë. Merren problemet më të mprehta, ato ku ndryshimet janë më të shumta dhe ku kanë më shumë rëndësi. Nën titullin "Ndryshime dhe përkime", kemi krahasime për institucionet më të njohura të Kanunit: "Ndryshime e përkime. Femra", "Ndryshime dhe përkime.Miku", "Ndryshime e përkime: Gjaku dhe Pajtimi". Gjatë krahasimit shikohet se kanunet kanë anë dhe gjëra mjaft të përbashkëta, por kanë dhe ndryshime, disa herë esenciale. Kështu, si shembull, në Kanunin e Lekë Dukagjinit thuhet tesktualisht: Se "Shtëpia e shqiptarit është e mikut dhe e Zotit". Në këtë Kanun gjithashtu ka nxitje për marrjen e gjakut të mikut. Atij që nuk ka marrë gjakun e mikut në mexhelis i jepet kafja nën gju dhe gota e rakisë i mbushet për gjysmë. Nganjëherë e ëma i tregon të birit rrobat e përgjakura të të atit duke i thënë se filani të ka vrarë babain dhe ti duhet t'i marrësh gjakun. Në Kanunin e Dibrës, bie fjala, shtëpia nuk është e mikut por e zotit të shtëpisë. Mikun nderoje dhe respektoje, thuhet në Kanunin e Dibrës, por zot shtëpie mos e bëj. Gjathashtu nuk ka nxitje kurrë për marrjen e gjakut të mikut. Po kështu dallime kanë këto kanune edhe përsa i përket trajtimit të femrës, marrjes së gjakut, pajtimit etj. Kanuni i Dibrës, siç është thënë edhe nga shkrimtari A. Tufa, ka një përmbajtje më humane, është më elsatik.

Si përfundim, kuptimi i zgjeruar dhe i thelluar për Kanunin, vështrimi i Kanuneve Shqiptare si një Kanun, përkimet dhe ndryshimet e tyre të parë përmes krahasimit direkt të shumë zgjidhjeve dhe dukurive, janë tri risi të librit "Kanun" të Xhafer Martinit. Ka edhe risi të tjera, por besoj se do të thuhen nga diskutantë e tjerë.

Autori mban gradën Prof.dr. dhe është punonjës i Insitutit të Gjeoshkencave pranë Universitetit Politeknik të Tiranës

Ç'kemi ásaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Marsi mbajti ngrohtë. Festuam Festën e Mësuesit dhe Festën e Nënës. Me rastin e festës së Nënës, dikush bëri një pyetje në Facebook, se cila ishte gruaja dibrane më e suksesshme? Përgjigja ishte: Safet Zhulali!

Shumë ngrohtë mbajti Dita e Verës. Verë hesapi. Pasi dogjëm në mëngjes herët gjithë ferrat e poreneve a ndonjë gomë makine, sa për aromë, në mëngjes mbushëm trastat me voe të zime e të ngjyrosme, kulaq me sheqer, pak arra dhe gështenja në pe, dhe dolëm e morëm livadhet... Pasi zumë voet e ngjyemë lara-lara dhe ia thyem njëri-tjetrit, shpesh herë edhe me hile, ia futëm futbollit derisa djersët na mbuluan. Pastaj u shtrimë hijeve dhe i mbaruam ato që kishim marrë në torbë, dhe pas gjumit nën diell ikëm në shtëpi. Ato që haheshin i hëngrëm, të tjerat, mbeturinat, i lamë livadheve, për zbukurim.

Më 14 mars u organizua edhe protesta e fundit për Radikën. Filloi vera tani, dhe nuk është mirë të mblidhen njerëzia për miting, se u vjen era djerse dhe ruhemi nga epidemitë. Në protestën përmbyllëse "Për mbrojtjen e lumit Radika" u thanë të gjitha: edhe Gruevskin e shamë, edhe Agimin e përzumë. Ndërsa për lumin thamë se do ta mbrojmë me jetën tonë! Por, me këtë jetë apo në tjetrën?

Në Maqedoni kemi zgjedhje, por edhe këto zgjedhje, si gjithmonë, na gjejnë të përçarë. Maqedonasin nuk e duam si president, se është i Gruevskit. Ndërsa shqiptarin nuk e duam, se ka qenë edhe "komunist", edhe i "UDB-së".

Një aktivisti të Radikës i doli emri si kandidat për deputet. Gjysma e dibranëve u gëzuan se do të shkonte në parlament një përfaqësues i denjë i çështjes, ndërsa gjysma tjetër ia bëri biografinë dhe e nxorëm tradhtar, të shitur te Aliu dhe se donte ta përdorte Radikën për karrierë. Por kur doli lista dhe emri i tij nuk ishte, u ndërruan rolet: grupi i parë i bëri biografinë, grupi i dytë temenatë... Dmth, si Gjinua, personazhi i Çajupit te "14 vjeç dhëndërr": "Hip së të vrava, zbrit se të vrava"!

Mos më thuaj se ju atje jeni të bashkuar, se e ndjekim edhe ne facebookun: kur kishit kryetarin atje, grusht bashkuar rreth kryetarit, kur ai u kthye në atdhe, u shpërndatë si këmbët e pulës!

Në Maqellarë mbollëm pemë. Në Lurë, Selishtë, Balgjaj e maleve të Dibrës i kemi prerë të gjitha. Por e rëndësishme është se mbollëm 200 pemë dhe kemi në plan të mbjellim të tjera, dhe këtë e pamë në televizor.

Ç'mu kujtua televizori!... Këtë muaj shoqërova Marinin, Rrugës së Arbërit, për t'i treguar rrugën, maleve, si herën e parë që e kishte. Kur shkuam në Maqellarë, një fshatar na tha: Rruga ka përfunduar se e kam parë në televizor! Sa mirë, ndonjëherë je më i lumtur kur e shikon botën i shtrirë në divan, me një gotë raki përpara!

vlerësim



Si përherë, ky inxhinier modest, jo nga puna, po nga sjellja e një fisniku që gjithnjë ka punuar dhe kërkuar suksesin, pa u merakosur t`ia vënë në dukje të tjerët, po ai vetë ta gjurmojë punën si punë, larg çdo ngrefosje mediatike apo klisheje të fjalëve të zakonshme, ngurron të flasë, por duhet vetëm zelli dhe pyetjet e gazetarit që të shprehet. Dhe çmimi e mban cilësimin: ”Kupa e artë për inovacion dhe teknologji në prodhimin e makinave dhe linjave të fabrikave”.

Një çmim ndërkombëtar i teknologjisë për Abaz Markun

Nga **QAZIM SHEHU**

Me Abaz Markun u takuam rastësisht dhe biseda nisi po rastësisht. Nganjëherë ajo futet në atë rrjedhë, që, do apo nuk do, për të ndjerë forcën tërheqëse të saj, e cila vjen vetiu dhe natyrshëm, krijohet nga prania e njerëzve që kanë çfarë thonë. Janë njerëz me biografi të pasur jetësore dhe profesionale, njerëz të cilët e kanë kurdisur ritmin e jetës së tyre me zemrekun e punës. Dhe me Abaz Markun u gjenda, padashur, në zbërthimin vektorial të prezantimit të mësipërm,aq më tepër kur fjala e bisedës e solli si një rastësi ose diçka e cila duhej përmendur, se s`mund të ndodhte ndryshe, që ai sapo ishte nominuar me një çmim prestigjoz ndërkombëtar në Gjenevë për teknologji dhe inovacion. Ishte një çmim i votuar nga mbi njëqind përfaqësues të shteteve të botës .

Në rastin konkret kjo për mua përbënte një lajm shumë të rëndësishëm,po ne zakonisht, jemi mësuar me lajme standarde të politikës ose lajme që vijnë nga kronika e zezë, dhe nganjëherë,lajme që përbëjnë efektin sendërtues të një shprese më të mirë humbasin ose mbeten në heshtje duke pritur radhën apo angazhimin rastësor të ndonjë gazetari. Kështu mjegullohet vlera ose shtjellohet absurdi që në parakalimin e pamjeve të tij i shkërmoq kuptimet ekzistenciale.

Si përherë, ky inxhinier modest, jo nga puna, po nga sjellja e një fisniku që gjithnjë ka punuar dhe kërkuar suksesin, pa u merakosur t`ia vënë në dukje të tjerët, po ai vetë ta gjurmojë punën si punë, larg çdo ngrefosje mediatike apo klisheje të fjalëve të zakonshme, ngurron të flasë, por duhet vetëm zelli dhe pyetjet e gazetarit që të shprehet. Dhe çmimi e mban cilësimin: ”Kupa e artë për inovacion dhe teknologji në prodhimin e makinave dhe linjave të fabrikave”.

Çmimi është dhënë nga Century Internacional Quality Era Award, votuar në pjesëmarrjen e 114 shteteve. Është një vlerësim i merituar ndaj një inxhinieri të talentuar shqiptarë për inovacion në teknologji. Dhe padyshim është një rast që s`ka pse të mos e bëjë krenar Abaz Markun, një vlerësim që e jep një qendër prestigjioze, po njëkohësisht edhe një nxitje për më tej.

Historia e kërkimit të vazhdueshëm ndaj vetes është një histori suksesi, ashtu siç mbetet gjithnjë ngasja për të arritur kuota të reja në punën tënde, po edhe sadisfaksioni i vlerësimit nga të tjerët. Njeriu shqiptar në vitet e tij gjithnjë është përpjekur të kapë dimensionin e kohës së humbur duke shfrytëzuar hapësirat e lirisë që jep koha dhe premisat e mundësive individuale. Kjo, padyshim ,përbën atë kredo morale të njerëzve të spikatur në fusha të caktuara që rëndom ne i quajmë personalitete, larg stereotipisë së përditshme në këtë shoqëri të mbushur shpesh nga tirada e reklamimeve të një imazherie të modës. Ndaj më erdhi mirë që e takova Abaz Markun edhe për këtë fakt për të mësuar edhe diçka tjetër e për ta vërtitur dhe ndarë kënaqësinë e këtij çmimi në arsyetime dhe ndjesi të kuptueshme prej nga kuptohet edhe dimensioni i një jete njerëzore në prizmin e rrethanave kohore.

Historia nis që herët, që kur Abaz Marku mbaron studimet e fakultetit si një student i shkëlqyer e fillon punë në Rubik. Atëhere ishin kohë të vrulleve rinore, të ëndrrave dhe dëshirave të mëdha, pohon protagonisti ynë, ndërsa i duhej të përballej edhe me dëshirën e parealizuar, me kërkesën e fakultetit për të filluar punë si pedagog në të, por kudrot e partisë nuk mund të lejonin që një inxhinier kaq i zoti të ikte nga rrethi. Atëhere gjithçka duhej të ishte e lejueshme e kontrollueshme, duke u ndërvarura nga rrethana jashtësore e brendësore, nga teka dhe dëshira të dikujt tjetër.

Por ,i riu, Marku, nuk dekurajohet, ndërsa mendja dhe projektet e tij marrin gjithnjë formë dhe krahë drejt punëve dhe rinovimit të teknologjisë së uzinës së bakrit në Rubik. Ishte një kohë kur industria shqiptare e minerave nuk e ndiente më nevojën e përkrahjes nga jashtë, marrëdhëniet me kinezët ishin këputur, ishte viti 1981. Instituti i Projektimeve nuk e mori përsipër rikonstruksionin e uzinës.Atëhere Abaz Markut iu desh të rriskonte dhe pas një pune të lodhshme iu mundësua ta rikonstruktonte uzinën duke rritur dyfish kapacitetin e saj të shkrirjes.

Si gjithnjë,në raste të tilla ,shpërblimi ishte moral,me një shpërblim material të përfillshëm për kohën, në kufij të pabesueshëm sot,të cilin edhe mund të mos e pranoje për shkak të një inisiative vullnetarizmi që lindte diku,ose për shkak të ndonjë etiketimi në kufijtë ideologjikë të kohës. Puna në uzinë, rikonstruksioni që e solli atë në rritjen e kapaciteteve shkrirëse pati një impakt të madh dhe solli gjithnjë një rritje dhe nevojë të kërkesave për tu futur në botën e bukur të inovacionit teknik, e kjo pruri njëkohësisht edhe një rritje të reputacionit për inxhinier Markun duke u shpallur novator i dalluar në teknologji për disa vite.

Jeta e këtij njeriu duhet kuptuar vetëm përmes dimensioneve të kërkimit dhe si pikënisje e vlerësimit të kuptueshmërisë së saj. Ka qenë një kohë kur industria shqiptare, në krahasim me të sotmen i njihte disa suksese, pavarësisht se historia e zhvillimit të saj, sidomos e industrisë minerare, i përket fjalës së një specialisti të mirëfilltë. Po kjo histori nuk mund të kuptohet pa jetëshkrimin shkencor të inxhinerëve të talentuar shqiptarë ,e ndër ta, pa dyshim, zë një vend të spikatur edhe Abaz Marku.Duke e nisur këtë ide trampolinë për tu hedhur diku tjetër mund të themi,se do të vijë koha që minierat tona mos rrinë të fjetura ,po ato të rigjallërohen nga intelekti inovues i inxhinierëve të zotë shqiptarë, ato ta rigjejnë atë traditë që kanë pasur, për ta çuar më para në kushtet e përshtatjet e vlerësimit të teknologjisë moderne që është sot në botë.

Pas viteve 90-të, pas asaj përmbyseje të madhe, ku u dogj edhe bari i njomë për të thatin, kur industria shqiptare u quajt një kovaçhanë dhe në emër të këtij sllogani, u vodh e u shkatërrua për të justifikuar vjedhjen, kur u emërtua me terma të rinj gjithë rruga e saj përvijuar nga djersa e punëtorëve dhe intelekti i inxhinerëve, pikërisht, pra, pas viteve 90-të kur shumë intelektualë, inxhinierë, mekanikë, apo specialistë të të fushave të ndryshme u detyruan të braktisnin profesionin, të emigronin dhe të rimësonin në, cak kohor të papërshtatshëm, zanate të ndryshme, pikërisht atëherë Abaz Marku, kuptoi se çdo braktisje e profesionit nuk do ishte e denjë për të.

Ai u përket kategorisë së atyre intelektualëve që me gjithë rrisqet që mbartëte ky fenomen ,nuk e braktis në këto vite punën , përkundrazi tanimë hapësirat e lirisë ishin më të mëdha, po njëkohësisht edhe vështirësitë ishin sfidante dhe kërkonin mençuri për të hapur shtigjet e tyre. Ai themelon kompaninë “ ENI dhe ZA” duke iu futur projekteve në fushën e inovacionit teknologjik. Dhe këtë kompani e shtrin në impiante të inerteve të lumit,fabrika betoni dixhitale, impiant për prodhim koll –fino, duke e shtrirë aktivitetin në rikonstruksion kapanonesh, për të prodhuar pajisje për vagona minierash,prodhime dhe montim dizash, montim turbinash të hidrocentraleve, etj. Këtu, duhet përmendur fakti se ky inxhiner dhe inovator i hershëm zotëronte një përvojë të mirë, e në këtë përvojë do kishte pamjaftueshmëri, nëse nuk kuptohej kërkesa e kohës, e cila rregullohej përmes tregut.

Ishte një kohë kur Shqipëria kishte uri për ndërtim dhe për afrimin e teknologjisë moderne,një kohë e cila vazhdon dhe sot, ku mund të konkurrohet vetëm me cilësi,ndershmëri e përkushtim,sepse tregu ka operatorë të tjerë dhe midis tyre duhet të spikatësh për korrektesë dhe cilësi.

Të kuptuarit e kohës së pas viteve nëntëdhjetë u bë me intuitë po edhe me ndërgjegje të plotë nga njerëzit që bashkonin intuitën me dijen. Njerëzit që i bashkojnë këto dy tipare arrijnë sukses, po suksesi i tyre nuk është i mjaftueshëm nëse këtë sukses nuk e ngre në një gjedhe që modelen gjithë sjelljen e shoqërisë për të shkuar drejt standardeve më të arritshme të individit europian e për të konkurruar jo vetëm brenda gardhit,po për të dalë në një fushë më të gjerë.

Pasvitet 90-të sollën një spikatje të madhe të njeriut shqiptar në Europë, po edhe nëpër botë,po edhe të individit shqiptar në Shqipëri, i cili i siguroi kontaktet me botën, me të renë, shkencën, kulturën,artin sportin e në shumëçka.

Janë këto vite vitet e çlirimit të një energjie të madhe, të hapjes së tregut dhe të mësimeve të mëdha,duke futur në përdorimin e përditshëm sende, mjete, teknologi të përparuar, kërkesë dhe dëshirë për mundësi më të mëdha dhe kjo solli patjetër edhe një riplotësim nevojash të munguara në dekada të izolimit, po njëkohësisht edhe një rritje të kreativitetit të individit shqiptar, një vramendje më të madhe për të arritur e hapur rrugët e përvojës kombinuar me aftësitë personale në shfrytëzim rrethanash të favorshme, të cilat e sjellin herë-herë konturimin e profilit të njerëzve më të suksesshëm të shoqërisë sonë.

Në këtë arsyetim mund ta shihja më mire profilin e Abaz Markut, duke e plotësuar atë gradualisht, larg çdo zmadhimi të panevojshëm apo euforie fallso. Karakteri inovativ i kësaj veprimtarie të këtij njeriu nuk është thjesht fitimi se sa modelimi, që sjell shijen dhe reflektimin e një sjelljeje të re në shoqërinë tonë.

Në këtë pikëpamje edhe çmimi dhënë në Gjenevë me votimin e 114 shteteve, për herë të parë sjell edhe diçka tjetër të re. Nga ky vit edhe Shqipëria bëhet anëtare e barabartë për të pasë të drejtën të votojë të tjerët.

Këtu konotacioni është brilant. Merr vlerë polifunksionale dhe shtrihet në kuptimësi të shumëfishta. Ai del në raportet e ndërvartësisë qëllimplote të inividit me vendin e tij, që nis nga vendlindja (Abaz Marku është nga Reçi i Dibrës),vijon me rrethin, zonën e krejt atdheun. Individët e spikatur janë pasaporta më e mirë e emrit të shqiptarit në tërësi, në këtë kohë të globalizmit marramendës, të rrafshimit të kufijve dhe të qarkullimit të shpejtë të vlerave, ku çdo ditë është diçka që zbrapset e një më e fortë që përparon, pikërisht në këtë kohë, është e vështirë të shënohesh sidomos në një konkurs ndërkombëtar, po falë seriozitetit të botës,nganjëherë vlerat tona na i çmojnë më shumë ata, se sa ne vetë. Dhe në këtë vlerë të çmuar, Abaz Marku ia arriti të shënohet bindshëm. Vlerësimi për Abazin është një vlerësim për gjithë ata njerëz të suksesshëm kudo që gjenden,duke kuptuar mirëfilli rezultanten e një jete në kërkim të vazhdueshëm drejt fjalës së re të teknikës dhe shkencës...

cyan magenta yellow black

veprimtari

Kremtimi i Ditës së Verës në Tiranë nga shoqata "Çidhna dhe Kastriotët"

Shoqata Çidhna dhe Kastriotët: Lapidarin e betejës së Torviollit do ta ngremë me kontributet tona

Këtë festë të lashtë popullore krahina e Dibrës e ka kremtuar prej mijëra vjetësh, qysh në kohën e paganizmit, duke e konsideruar si ditën e parë të vitit të ri natyral, ditën e parë të muajit mars (allaturka) që sipas kalendarit gregorian, përkon me datën 14 mars, pasi atëherë fillon mbirja e luleve të para të Ditverës.

Pikërisht ditën e parë të muajit mars, sipas kalendarit gregorian, populli i Dibrës dhe i krahinave të tjera të Shqipërisë atë datë e kanë konsideruar si dita e parë e Vitit të Ri. Kjo festë ka vazhduar të kremtohet si e tillë në atë zonë qysh prej kohëve pagane e deri në ditët tona, bile edhe në kohën e monizmit, ku ndaloheshin me ligj kremtimi i festave popullore e fetare etj.

Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" në kuadrin e ruajtjes së traditave të zakoneve popullore të krahinës dhe për t'ua transmetuar ato edhe brezave pasardhës, festën e Ditëveres e ka caktuar si festën e shoqatës duke sanksionuar edhe me "ligj" duke e shëruar si të tilla në ashtu themelues të shoqatës.

Në këtë këndvështrim, 60-70 vjeçar, morën iniciativën që këtë vit, këtë festë ta kremtonin së bashku, në zyrën e shoqatës, duke u "ulur" disa orë e duke u rikthyer në kohë, në moshën e rinisë së hershme. Kështu, në atë atmosferë të gëzueshme pas ritit të thyerjes së vezëve dhe këmbimit të dhuratave ndërmjet njëri-tjetrit, ata të ishin më të rinj, duke shkuar në fushat sportive, për të luajtur lojërat popullore, sipas traditës, futboll, pelas, gjyshes (gjuajte me granetë) etj. Ndër më të moshuarit: Enver Kaloshi, Xhafer Martini, Muhamet Bitrit, Tafë Kola, Ali Hoxha, Shaban Bitri, Uzri Hoxha e Ruzhdi Bitri, u ulën në lokalin "Edisen" të M. Bitrit, për të pirë së bashku një kafe. Në një atmosferë të tillë të gëzuar, pas një farë kohe, në një moment të caktuar z. Enver Kaloshi ia ndërroi drejtimin bisedës me këto fjalë:

"Meqenëse të gjithë të pranishmit jemi anëtarë të Këshillit Drejtues të Shoqatës, propozoj që të improvizojmë një mbledhje "pa protokoll", d.m.th. ashtu si në kuvendet e hershme. Më saktë dua të shtroj një problem. Gjatë studimit të dokumentacionit të shoqatës të trashëguar nga Kryesia e mëparshme, Aliu e Hajredini, jam giciluar apo siç i thonë letrarët, jam frymëzuar, dhe mendoj se ngritja e lapidarit në përkujtim të Betejës së Torviollit, Betejës së parë të Skënderbeut më 29 qershor të vitit 1444 në Dibër të Poshtme, në fushën e Çidhnës, kryesisht tek ferra e Pashës, i miratuar në vitin 2012 nga Komuna e Arrasit, por që nuk u realizua për mungesë fondesh, mendoj që ajo vepër duhet ngritur e realizuar këtë vit, pasi koinçidon edhe me 570 vjetorin e asaj beteje edhe me 70 vjetorin e çlirimit të vendit nga pushtimi nazifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Meqenëse pushtetarët e tri komunave të Çidhnës nuk e bënë një vepër të tillë, unë mendojë dhe propozoj që atë vepër ta bëjë shoqata jonë e Çidhnës sepse i kushtohet Çidhnës. Unë, Enver Kaloshi, si sekretar i shoqatës nga kursimet e pensionit tim, jo nga tjetër kush, premtoj të kontribuoj me 500 mijë lekë (të vjetra) për këtë vepër, pasi siç më ka thënë Aliu shpenzimet për realizimin e saj nuk i kalojnë më shumë se dy milionë lekë të vjetra. Mendoj se në ngritje të dy monumenteve në kodër të Laçes është më afër Ferrës së Pashës dhe më i përshtatshëm se në Sukë të Arrësit.

Këtë propozim të Enver Kaloshit e mbështetën të gjithë të pranishmit dhe të gjithë të tjerët, të nxitur nga kontributi i Enverit, edhe ato premtuan se do të mbështetin këtë vepër duke kontribuar secili prej tyre pa përcaktuar shumën përkatëse.

Projektin e kësaj vepre e ka bërë falas biznesmeni dhe piktori Uzri Hoxha që në vitin 2012.

ALI HOXHA



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:

http://saveriverradika.com

Aty ka mjaft materiale për t'u informuar si dhe për të siguruar fakte për debatet tuaja. Të gjithë ata që kanë dokumente të tjera ose informacione të panjohura, të na i dërgojnë, që t'i arkivojmë bashkë me të tjerat.

LINKU I PETICIONIT KUNDER DEVIJIMIT TE LUMENJVE

https://secure.avaaz.org/en/petition/Qeveria_e_Shqiperise_Government_of_Albania_Te_mos_lejohet_te_ndalohet_devijimi_i_lumenjve_VJOSA_dhe_RADIKA/?cYIvdgb

Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

cyan magenta yellow black 13

Naim Plaku në këtë moshë që është sot të entuziazmon për nismën që ka marrë por edhe jep një mesazh të fuqishëm, për të gjithë sllatinasit që nga intelektualë të fushave të ndryshme e deri te njerëz të thjeshtë, bijë të kësaj treve të njohur në historinë shqiptare.

Naim Plaku, i kthen borxhin vendlindjes

Nga **SHAQIR SKARRA**

Edhe pse sapo i ka kaluar të shtatëdhjetat Naim Plaku përsëri është me mendje të kthjellët dhe shkruan pa pushim. Pas mijëra e mijëra vargjeve lirike, epike e elegji ku janë bërë të njohura si tekste këngësh edhe në skenat e botës, të kënduara jo vetëm nga këngëtarë dibranë, por më së shumti dhe kosovarë, këtë radhë shënjestrën e ka drejtuar pikërisht te vendlindja, por ka shkruar krejt ndryshe nga natyra e tij. Një monografi jo vetëm historike, por edhe artistike, të shkruar bukur e me mjaft kulturë, një monografi model që prej kaq kohësh ne nuk e kemi parë, një monografi me vlera të mëdha sapo na ka dhënë në duar e pikërisht librin"Sllatina, lashtësia, traditat, jeta shoqërore".

Naim Plaku në këtë moshë që është sot të entuziazmon për nismën që ka marrë por edhe jep një mesazh të fuqishëm, për të gjithë sllatinasit që nga intelektualë të fushave të ndryshme e deri te njerëz të thjeshtë, bijë të kësaj treve të njohur në historinë shqiptare. I jemi borxh të gjithë vendlindjes tonë, fshatit të dashur dhe mesazhi që vjen nëpërmjet këtij libri është fare i qartë: Të gjithë duhet të japim ndihmesën tonë intelektuale ose materiale për të nxjerrë në dukje vlerat historike, kulturore e të fushave të tjera, si dhe për të ndihmuar, sado pak për mirëqenien e begatinë e fshatit tonë. E Naimi e themi me plot bindje se ia ktheu sot borxhin vendlindjes, me botimin e këtij libri i dha pasaportën Sllatinës, vendlindjes së tij të dashur si mjet identifikimi. Dhe Naim Plaku qysh në fillim të librit, në mesazhin drejtuar e brezave që do të vijnë shprehet: "O Sllatina jonë, vendi i bekuar! Ti je djepi i kujtimeve më të bukura, i ëndrrave flutarake, i buzëqeshjeve gazmore!Je dhe do të mbetesh krenaria jonë. Ti je prehëri i dhimbjeve e lotëve, i këngëve dhe gëzimeve, i kujtimeve dhe ëndrrave, i shpresës dhe i besimit, ti je vatra e shenjtë e guximit dhe trimërisë, sofra e bujarisë, emblema e krenarisë sonë. Ti je nëna jonë më e shtrenjtë! Prandaj më lejo, nënë e dashur të sjell sot për ty zërin e gjithë atyre që patën fatin të lindin e të rriten në krahët e tu, të thithin ajrin e pastër të bjeshkëve dhe të pinë ujët e krojeve të tua, të gjithë atyre që janë nga gjeni yt fisnik, që janë mëkuar me qumështin e atyre nënave amazona e burrave të guximshëm, të mençur e të dëlirë, punëtorë e bujarë. Jemi krenarë për ty, Sllatinë, për ty nënë e dashur! Na afro të mbështetim ballin në gjoksin tënd të gjerë! Na këndo atë melodinë e ëmbël që vë në gjumë zanat e malit e harbon sokolat e mejdanit! Të lutemi, nënë, na jep fuqinë magjike që të mbetemi përjetësisht bijë e bijat tuaja!". E Naim Plaku me këtë monografi që sapo ka botuar për vendlindjen shprehim bindjen se ashtu siç thotë dhe vetë ka mbetur djalë besnik i Sllatinës. Naimi është tepër nostalgjik për vendlindjen. Bredh nëpër Sllatinë kudo ashtu si ato vite kur ka qenë djalë por jo me këmbë por me mendje e penë, ashtu siç di të shkruaj ai. Shfletojmë librin dhe ne ecim nëpër ato rrugë që na çon autori; në Deluza apo Shtodër, tek varri i Sejmenit apo livadhi i Duke, në Gramë apo Kumbull, guri i Dhelpnës apo guri i Kuq. E kudo që hasim këto toponime të bukura në libër i thonë Sllatinë. E kush më mirë se Naim Plaku do të na jepte sot një libër të tillë, një monografi por të letrarizuar?. Autori ka meritën se pas një pune të gjatë hulumtuese disa vjeçare, me vullnet e pasion për t'u admiruar sidomos pikërish sot kur thinjat i kanë "qëndisur" flokët e vitet i rëndojnë mbi supe, ai operon përsëri me guxim prej djaloshi të ri në dokumenta të botuara, në burime arkivore, në fakte, në kujtime e gojëdhëna për të hedhur dritë mbi Sllatinën, historinë dhe traditat e saj në një periudhë kohe që nga lashtësia. Historia e Sllatinës është e virgjër, e pa studiuar dhe e pa trajtuar nga historianët tanë. Ajo mbart në vetvete vlera të pa diskutueshme të qytetërimit të hershëm, por edhe të një kulture e tradite të veçantë, të zhvilluar e të kultivuar. E u desh pena e birit të Sllatinës Naim Plaku për të na i sjellë ne sot nëpërmjet këtij libri të sapo botuar.Sllatina, ky fshat i madh, ndoshta për nga shtrirja gjeografike më i madhi në Dibër, i bukur që qëndron si një ballkon i vargmaleve me nisje nga Korabi, karshi Drinit e maleve të Dibrës, ka veçori dalluese në gjuhë, zakone e tradita veç anëve të përbashkëta të tjera me trevën e Dibrës. Sllatina pa dyshim ka kontributin e saj të vyer në luftën kundër pushtuesve të huaj. Djemtë e burrat patriot të Sllatinës, kanë kundërshtuar e luftuar kundër superfuqisë së kohës siç ishte Turqia e vjetër. Ata kanë një histori të lavdishme e të spikatur të patriotizmit në luftë kundër armiqve shekullorë, pushtuesve serb. Ajo u ka rezistuar me armë e pa armë pushtuesve që vinin me taborre dhe artileri dhe ka fituar mbi to, duke dhënë ndihmesën e vet e lartësuar emrin e tyre e të gjithë Dibrës në tërësi. Në libër zënë një vend të veçantë dokumente e materiale të tjera që argumentojnë më së miri shtrirjen e Sllatinës ku siç thotë vetë autori "është një kufi që ngërthen qindra hektarë tokë, ara, livadhe, kullota, pyje dushku, pishe e ahu, mështekne e arrnini, masive të tëra me lajthi, kodrina e kullota alpine etj, të dokumentuara edhe në regjistrin kadastral të vitit 1929". Autori ndalon edhe rreth etimologjisë së emrit Sllatinë . Një vend me rëndësi në libër autori na jep rreth etnogjenezës së të gjitha fiseve të Sllatinës , duke mbrojtur tezën e një migrimi aktiv të popullsisë jo vetëm nga viset e ulta drejt maleve, por edhe nga malet drejt vendeve të ulta. Ngjarjet e ndryshme historike të atyre periudhave, kur nëpër Ballkan dhe në vendin tonë, kanë kaluar lindje, lulëzim e rënie të perandorive. Që nga romakët e vjetër e deri tek më të vonshmit si perandoria e Hazburgëve, e sllavëve, e turqve etj, flasin për ngjarje tronditëse që kanë ndodhur, që është në fakt e pa mundur të mos kenë e ndikuar në lëvizjen e popullsisë në këto vende, por edhe në Sllatinë dhe gjithë zonën e Ujë e m'Ujës. Autori si gjuhëtar dhe njohës i mirë i tononimeve dhe mikrotoponimeve na jep një pasqyrë të plotë për të gjitha këto që ndodhen në Sllatinë si Kallavozi, Britushe, Grama, Rrasagulë, Kalivoçe, Llofka,Përroi i Shëngjergjit, Përroi i Shëngjonit, Deluza, Zallneci, Guri i Poshterkës, Përroi i Pasqyrës, Gjeksinat, Kodra e Nizamëve e plot të tjera. Autori bën përpjekje të mëdha për të argumentuar betejat e para dhe të famshme në luftë për liri dhe pavarësi , flet për betejat që janë zhvilluar qysh në periudhën e pushtimit osman. Me mjaft kujdes të madh përshkruhen në monografi betejat e njohura me serbët në vitet 1913-1921. Autori thotë: "Konferenca e Ambasadorëve që u mbajt në Londër nga 17 dhjetori 1912-gusht 1913, u morën posaçërisht me çështjen shqiptare. Nuk kishte asnjë arsye njerëzore që ky kufi ta ndante përgjysmë Dibrën. Kjo siç e dimë i solli pasoja tragjike kombit tonë...Në verën e këtij viti shumë burra kanë bërë roje vullnetarisht edhe dimrit te Guri i Kuq e në bjeshkët e Gramës për ta bindur komisionin që po vendoste kufirin në këto troje se ishin tokë shqiptare dhe nuk mund të tjetërsoheshin. Mund të përmenden këtu Bafte Çima, Fetah Abazin (Hysën), Elez e Sadik Plakun, Ali Plakun, Demir Çollakun, Mylazim Çimën, Sali Hasanin (Çekiçin), Rrahim e Met Dushkun, Rrahman e Sufë Beqirin, Rexhën e parë,Barë Milën etj, të cilët në muajt e ftohtë të dimrit flinin në borë një mbi një që të mos e ndjenin të ftohtin... Autori na jep një pasqyrë të saktë,reale e të argumentuar për luftërat serbe të Sllatinës dhe gjithë Dibrës nën udhëheqjen e Elez Isufit. Lufta popullore kundra forcave serbe, është një nga epopetë më të lavdishme të historisë sonë. Ishte pikërisht kjo luftë popullore , ajo që shkatërroi planin strategjik të krajlëve serbë për të vendosur kufijt, në mos nga Mali i Nezhës e Runjës e deri në Qafën e Buallit, të paktën në Drinin e Zi, në rrjedhën e tij. Lufta që bëri Dibra, nën udhëheqjen e atdhetarit, patriotit, gjeneralit me shajak Elez Isufi i detyroi Fuqitë e Mëdha, që t'i thonë serbit, sprapsu se nuk të duron ky vend. Jo vetëm kaq por autori na jep një pasqyrë për të gjitha masakrat serbe që kanë ndodhur në Sllatinë. Autori, nëpërmjet këtij libri, ka përshkruar bukur dhe ka argumentuar qartë e bindshëm për këdo, se sllatinasit, kanë







qenë burra të zot e përkrahës gjithmonë të progresit. Që në vitet e hershme ata kanë drejtuar vetë jetën e tyre dhe nuk i janë nënshtruar pushtuesit ose sundimtarëve të pa shpirt duke qëndruar kështu gjithmonë krenar. Ata kanë dhënë prova trimërie e mençurie dhe nuk janë të rastit shembujt që jepen në libër, ku djem e burra të Sllatinës kanë arritur deri në shkallat më të larta të hierarkisë të asaj kohe por dhe sot. Këtë traditë të bukur, të luftës kundër pushtuesve dhe sundimtarëve të huaj si dhe të luftës nacional-çlirimtare dhe unitetin e dashurinë për njëri tjetrin sllatinasit e kanë trashëguar në breza dhe e kanë bërë vyrtutin më themelor të tyre. Kjo ndoshta është edhe ajo arsya që edhe lufta e klasave në Sllatinë, në vitet pas çlirimit nuk u bë shumë e egër dhe nuk pati shumë viktima si diku gjetkë në fshatra të Dibrës. Emri i Sllatinës dhe sllatinasve përmendet nga autori me respekt si bir i kësaj zone që është dhe vetë, për vlerat e traditat që janë kultivuar në këtë trevë, por edhe nga zgjuarsia dhe shkathtësia për të përballuar pa shumë dëme dallgët e jetës. Me humorin e hollë të tyre, me sjelljet dhe veprimet e mençura, ata kanë arritur që të rezistojnë edhe në përpjekjet e shtetarëve të ndryshëm, që nga dëshira për karrierë e mburrje kërkonin të bënin reforma radikale, kundër zakoneve, traditave që cënonin dinjitetin e krenarinë e tyre. Naim Plaku në këtë monografi flet edhe për folklorin, si një njohës dhe studiues i talentuar i folklorit dibranë në përgjithësi, flet për larminë e vlerat e tij. Ai u referohet dokeve e zakoneve, për ngjarje të hidhura e gëzuara si dhe veshja e nuses së Sllatinës. Autori me shumë kujdes ka trajtuar çdo detaj në Sllatinë që nga shëndetësia, arsimi, kultura jeta shoqërore, koha e kolektivizimit, besimi fetar, marrëdhëniet familjare, mbrojtja dhe shërbimi ushtarak, kurbeti kjo plagë e hershme e shoqërisë, shërbimi bujqësor e blegtoral në Sllatinë. Pra është treguar tepër i kujdesshëm që nëpërmjet kësaj monografie të na jap të gjitha ato që kanë ndodhur ndër vite në Sllatinë. Lexuesi sllatinas, duke shfletuar këtë libër nga faqja në faqe, do të gjej shumë nga gjërat që ka jetuar ai, ose ka dëgjuar nga vetë prindërit e tij. Me nostalgji do të ndjell kujtimet e veta e do të pasurojë botën e tij shpirtërore. Edhe ai që nuk është nga Sllatina, edhe ai që ka dëshirë të vizitojë Sllatinën, do të mësojë mjaft gjëra të reja e të nevojshme për kulturën e saj e që është pjesë e historisë së Dibrës e vendit në tërësi. Gjuha e autorit, dashamirësia e kujdesi që t'u referohet vetëm fakteve, pa komente e zbukurime subjektiviste, bën që libri të lexohet me ëndje nga të gjitha moshat pasi aty gjejmë mjaft informacion të duhur. Dhe autori e mbyll librin e tij me një mesazh për të gjithë sllatinasit: "Braktisja e madhe! Boshllëk i madh.... Humbje e madhe.... Dhe shpresë e madhe për të ardhmen...Në lagjen Dushke kanë mbetur vetëm pesë-gjashtë familje, në Plake shtatë familje, në Kole katër, në Hyse pesë, dhe në Mëhallas gjashtë familje. Tërë fshati është tkurrur në më pak se dyzet familje, si asnjëherë tjetër në historinë e tij. Vatra të shuara, oborre të shkreta,rrugë pa të ardhme... Pranvera, sido që të jetë, i çel lulet e saj. Kështu do të çelin gjithmonë. Do të vijë patjetër një kohë që këta rrugë do të gjallërojnë përsëri, kjo shkollë do të bëhet me dy kate, do të ndërtohen shtëpi të reja, do të përkunden djepe e odat do të mbushen me cicërima gazmore, lëndinat e bjeshkët do të mbushen me shqerra, do të gjëmojnë dasmat e do të zbarkojnë në oborret e sarajeve nuse të reja nga ana e anës e do të vlojë kënga e vallja më e fuqishme se dikur, më madhështore se asnjëherë. Do të vijë pranvera përsëri!"

portret

Mësuesi patriot dhe demokrat Sami Gonxhja

Autor i muzikës **“Marshi i Djelmënisë dibrane”**

Nga **HYQMET GONXHJA**

Sami Gonxhe lindi në vitin 1893 në qytetin e Dibrës së Madhe. Babai tij, Hafëz Raif Gonxhja, ka qenë një hoxhë erudit, ndërsa nëna e tij, Habibja, ishte bijë e latifondistit Ismail Kurt Aga Dovolani (Dagleri).

S. Gonxhja kreu në vitin 1910 shkollën e mesme të përgjithshme në qytetin e Manastirit. Ashtu si edhe babai i tij zotëronte plotësisht gjuhën turke, arabe dhe persiane.

1. Veprimtaria arsimore: Fil pas shkollës së mesme e deri sa doli në pension, në vitin 1951, për mbi 40 vjet u aktivizua krejtësisht në fushën e mësuesisë. Ai ishte në grupin e parë të mësuesve dibranë që ka kontribuar në hapjen e shkollave të ciklit të ulët: në Zerqan, në Homesh, në qytetin e Peshkopisë dhe në Prezë. S. Gonxhja është mësuesi i parë në shkollën fillore të Ibës (Tiranë) në Arbanë (Tiranë) dhe Mollagjesh (Elbasan).

Në periudhën 1940-1942 ai dha kontributin e tij si mësues në shkollat e para fillore përkatësisht në fshatin Muhur dhe Sohodoll të Peshkopisë.

Në periudhën 1942-1945 ai shkriu të gjitha energjitë e veta si mësues shembullor në shkollat fillore të porsakrijuara në qytetin e Dibrës së Madhe prej të cilës ishte larguar familjarisht si muhaxhir pas pushtimit Sllavo-Serb të vitit 1913. Sami Gonxhja ka dhënë ndihmesën e tij si mësues edhe në shkollat fillore të kryeqytetit: J. Vreto, Kristoforidhi, shkolla e Kuqe, Kongresi i Lushnjës, Shkolla tek Rr. e pishës (Tani Tefta Tashko) dhe në Yzberish.

2. Veprimtaria politiko-shoqërore: Mësuesi S. Gonxhja ka qenë i ndjeshëm edhe për sa i përket rrymave social-politike të kohës. I frymëzuar nga qëllimet iluministe të Lëvizjes “Bashkimi” të udhëhequr nga Avni Rustemi, ai bëhet një veprimtar i shquar duke arritur të kryejë edhe detyrën e kryetarit të Degës Bashkimi për qarkun e Dibrës deri kur u përmbys qeveria e Nolit në Dhjetor 1924.

I akuzuar fillimisht, për tentativë kundra jetës së presidentit A. Zogu (1926) dënimi kapital i propozuar nga prokurori për mungesë faktesh, u kthye në burgim 6 mujor dhe me heqjen e të drejtës për të dhënë mësim në shkollat laike për 3 vjet. Gjatë kësaj periudhe (deri në vitin 1928) ai dha mësim në shkollën e Medresesë së Lartë në Tiranë.

S. Gonxhja gjatë periudhës 1929-1939 arriti të reflektojë dhe të vlerësojë si mjaft pozitive regjimin e qeverisë Mbretërore për ndërtimin e shtetit të ri shqiptar, zhvillimin e arsimit dhe edukimin kombëtar.

Në kohën e pushtimit fashist ai mbajti qëndrim. Duke qenë nëpunës vetëm për një vit (1939-1940), në Institutin Femëror Pedagogjik, shfaqi haptas pikëpamjet e veta kundër pushtimit italian. Dhe ndëshkimi nuk vonoi: në shkurt të vitit 1940 S. Gonxhja transferohet familjarisht si mësues në fshatin Muhurr të Peshkopisë ndërsa në vitin 1941-1942 punoi si mësues në Sohodoll. Në periudhën qershor 1942 – gusht 1945, ai transferohet në qytetin e Dibrës së Madhe gjithnjë me detyrën e mësuesit për të dhënë kontributin në shkollat e para që u hapën në këtë qytet.

Duke pranuar propozimin e nipit të vet, dëshmorit Shaban Jegeni (i pushkatuar në Prishtinë) S. Gonxhja vuri në dispozicion shtëpinë e tij në Tiranë ku u themelua celula e parë e Grave Antifashiste të Shqipërisë (fundi i vitit 1941).

Në periudhën kur ishte mësues në qytetin e Dibrës së Madhe shtëpia e tij shërbeu si bazë e sigurt ku depozitoheshin dhe përcilleshin veshmbathje e municione në drejtim të çetave partizane të Dibrës edhe pse ishte i paralajmëruar që të hiqte dorë nga bindjet e tij antifashiste. Për këto qëndrime zgjidhet kryetar i frontit antifashist të qytetit të Dibrës së Madhe, detyrë që e kreu deri në mes të vitit 1945, kur dha dorëheqjen për t’u kthyer familjarisht në Tiranë.

Dorëheqja e Sami Gonxhes u paraqit kinse për arsye moshe dhe për t’u rikthyer në Tiranë ku kishte edhe shtëpinë e tij. Në të vërtetë, kjo dorëheqje ishte pasojë e pakënaqësisë dhe zhgënjimit të thellë që pati për masat shtypëse e ndërmarra nga pushteti maqedonas kundër shqiptarëve që banonin në trojet e veta në këtë republikë.

Këto masa represive të sllavo-maqedonasve, S. Gonxhja i pa me sytë e tij dhe i dëgjoi me dhimbje të madhe ankesat e të lebetiturat e burrave dhe grave shqiptare të Kërçovës, Gostivarit, Tetovës etj., kur po vazhdonte rrugën për të marrë pjesë në Kongresin e 2 Antifashist të Maqedonisë në Shkup (nëntor 1944) si anëtar dhe flamurmbajtës i delegacionit dibran që e kryesonte kryetari i qarkut të Dibrës së Madhe – patrioti dhe “gjenerali me tirqe” Aqif Lleshi. Më kujtohet kur në shtator 1944 në shtëpinë tonë na erdhi për vizitë “Mësuesi i Populllit” (atëherë n/kolonel partizan) Qamil Guranjaku, koleg i babait dhe ish mësuesi im i edukatës fizike, para vitit 1939, në “Shkollën e Kuqe” të Tiranës.

Të them të drejtën, unë si veprimtar i rinisë antifashiste, e ndjeva veten disi ngushtë, kur im atë me kurajo qytetare, nisi t’i tregojë ish mësuesit tim (që ishte dërguar enkas nga Tirana për t’u informuar mbi situatën në Dibër dhe në trojet etnike shqiptare të Maqedonisë) për ato çka kishte parë e dëgjuar si më sipër. Gjatë gjithë këtij rrëfimi Q. Guranjaku mbajti shënime dhe i premtoi tim eti se për këto do të njoftonte Qendrën në Tiranë. E shënova këtë kujtim se të vije në dyshim dhe të flisje kaq hapur kundra miqësisë “vëllazërore” të popullit shqiptar dh atij jugosllav sidomos në vitin 1944 deri në vitin 1948 të burgosnin si “armik e shovinist antijugosllav”.

Zhgënjimi i tij i dytë ishte kur pjesëtarë të familjes së tij u persekutuan egërsisht nga regjimi diktatorial i P.P.SH. Kështu, motra e tij, Ismete Llanai (Gonxhja) u burgos dhe u torturua tmerrësisht në qelitë e Degës së Brendshme të Burrelit derisa u çmend sepse nuk dha informacionin për vendndodhjen e bashkëshortit të saj të arratisur, oficerit akademist Xhemal Llanaj, i cili në vitin 1946 u vra nga forcat e Sigurimit të Shtetit. Po ashtu edhe vëllai i tij, Tahsim Gonxhja ish antifashist i orëve të para dhe i internuar për 2 vjet në ishullin Ustika (Siçeli) u burgos dy herë gjoja për agjitacion kundër pushtetit popullor i cili megjithëse kishte mbaruar shkollën tregtare të Vlorës dhe dinte dy gjuhë të huaja (italisht dhe Anglisht) u detyrua të punonte vetëm me punë krahu deri sa doli në pension.

Sqarojmë se S. Gonxhja ka kompozuar 10 këngë patriotike dhe rreshtore (pa nota) kryesisht për nxënësit e shkollave nga të cilat mbijetoj vetëm kënga: Marshi i djelmënisë dibrane me tekst të mësuesit të popullit Haki Sharofi dhe orkestrim të muzikantit tenderuar dibran profesor Isa Shehu. Ky marsh që i dedikohej fitores të luftëtarëve dibranë kundër pushtuesve serbë në Lan të Lurës së Dibrës u ndalua të këndohej në kohën e monizmit si këngë “shoviniste”, ndërsa tash këndohet lirisht në të gjitha veprimtaritë festive.

Lidhur në “Marshim e Djelmënisë Dibranë” më duhet të kujtoj një takim interesant të rastësishëm që kemi patur me një personalitet të shquar ushtarak të Luftës Partizane.

Ndërsa në një ditë qershor të vitit 1947, unë dhe babai im sapo kishim kaluar Shkollën e Kuqe në rrugën Qemal Stafa, papritmas fare pranë nesh, frenoi një “xhips” ushtarak. Me shpejtësi zbriti nga xhipi si një gjeneral topolak truplidhur por shumë simpatik, i cili me mirësjellje, me dialekt verior, iu drejtua tim eti:

- Me falni, në mos u gatofsha, a jeni ju ish-mësuesi im z. Sami Gonxhja, në shkollën fillore? (S’më kujtohet shkolla që përmendi gjenerali).

- Po, u gjegj im atë, disi me ndrojtje. Unë jam mësuesi Sami Gonxhja, por më vjen keq, që mua nuk po më kujtoheni, sepse nga duart e mia kanë kaluar shumë brezni nxënësish...

- Pa më thoni, “shoku”, gjeneral, po juve si quheni?

- Unë quhem Gjin Marku, safi djalë Mirdite – u gjegj gjenerali, dhe vazhdoi më tutje. – Z. Sami. S’ka rëndësi se a më mbani apo s’më mbani mend. Rëndësi ka fakti se unë ish nxënësi juaj në klasën e katërt dhe njëherësh trazovaç i bankës së fundit... për të cilën, gjithsesi ju kërkoj ndjesë (tha me të qeshur gjenerali) mbaj mend ato këngët rreshtore që na i keni mësuar ju ku ndër më e pëlqyera prej meje dhe bashkëmoshatarët e mi ka qenë “Marshi i djelmënisë Dibrane”. Z. Sami – vazhdoi fjalën e tij, gjeneral mirditor: A e ke bezdi që ta këndojmë së bashku këtë marsh luftarak që më ka frymëzuar edhe në luftën partizane?

- Po, me gjithë qejf – u gjej im atë. Dhe që të tre nisëm të këndonim me zë të ulët këtë marsh pa u bërë merak për kalimtarët e rastit të cilët po habiteshin duke parë një gjeneral dhe dy civilë që po këndonin këtë “marsh” luftarak në mes të rrugës?!

Duke kujtuar këtë episod, si unë ashtu edhe ima atë nuk na shkonte ndërmend që ky gjeneral trim e atdhetar mirditor do të binte pas dy vitesh viktimë e draprit gjakatar në dorën e Makbethit Shqiptar.

Do të më bënte vinte shumë mirë që marshi i Djelmënisë Dibrane të këndohet si qëmoti, veçanërisht në shkollat 9-vjeçare të qarkut të Dibrës.


Sami Gonxhja



“MARSHI I DJELMËNISË DIBRANE”,
Autor i tekstit “Mësuesi i Populllit” Haki Sharofi

Drin o Lum i Gjanë
Drin o lum i gjanë, plaku i malësisë!
A ke me j’a lënë Dibrën Serbisë?
Kurrë nuk durohet kjo rrobni,
Dibra e Mojsiut asht shqipëni
Refreni
Çohi; burrë, çohi
Gjithë me besa besë,
Për Dibrën luftoni
Me të madhe shpresë!
Lurë, o vend i nalt, vend i trimërisë!
Aty u bënë fjalët, besa e lirisë:
Dibra do shpëtue, vend i Kastriotit
Dibrani lirue, si ka qenë motit
Çohi, burra, çohi
.....
Bregut t’Drinit krisi topi, gjëmoi dheu
Dibranin luftë detyrën e kreu,
Syni s’iu tremb kurrë, armikun përzu
Dhe vet mbeti burrë, Dibrën e shpëton.
Çohi, burra, çohi
Gjihë me besë besë!
Dhe lirinë festoni
Me të madhen shpresë!...
Dibra historike, me lufta me valë,
Dera e Kastriotit gjinit t’and ka dalë,
Ke pasun kreshnikë, po ke dhe sot,
Që për Shqipërinë gjakun s’kursen dot.

Çohi, burra, çohi...

Në Dibër të Madhe u promovua libri
"Studime 6" i Dr.Prof. Mahmud Hysa

Botohet monografia për Said Najdenin dhe Hafiz Sherif Langun



"Në njëfarë kuptimi Said Najdeni dhe Hafiz Sherif Langu janë figura që përplotësojnë njëra-tjetrën: atë që nisi e përhapi mjeshtri, e plotësoi dhe e vuri në praktikë anëmbanë viseve kombëtare dishepulli i tij. Ka një meritë të padiskutueshme studiuesi Mahmud Hysa edhe në ndriçimin realist të epilogut elegjiak në jetën e secilit prej protagonistëve kombëtarë të monografive."

Nga **REXHEP TORTE**

Në prani të një numri të madh të adhuruesve të fjalës së shkruar në Qendrën për Kulturë në Dibër të Madhe më 21 mars 2014 u promovua libri "Studime 6" i Dr.Prof Mahmud Hysa, botuar nga Instituti për Trashëgimi Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup. Ky libër përbën monografi për atdhetarët dhe iluministët dibranë dhe mbarë shqiptarë Said Najdeni Alias Hoxhë Voka dhe Hafiz Sherif Langu.



Në fjalën e tij, Prof. Dr. Agron Tufa, lidhur me këtë libër tha se, "Shkenca jonë e Albanologjisë përjeton një datë të shënuar me botimin më të fundit të studiuesit Mahmud Hysa me dy studimet monografike, përkatësisht për dy nga figurat kyçe në historinë e Dibrës së Madhe dhe Shqipërisë, gjatë dhe pas Rilindjes, siç janë Said Najdenin (Hoxhë Voka) dhe Hafiz Sherif Langu - Devocioni për atdheun dhe fenë i përbashkon të dy këto korifej të Dibrës së Madhe. Të shkruara me këmbënguljen shkencore të kërkimit faktografik, genotipologjik, politologjik e kulturor, studiuesi i njohur e me përvojë, z. Mahmud Hysa, njëkohësisht edhe bashkëqytetas me korifentë, ka gërmuar me "thikë të imët arkeologjike" në arkiva, shtypin e kohës, bashkëkohanikët dhe trashëgimtarët e këtyre figurave në shekujt XIX-XX. Të dyja këto figura kyçe të historisë tonë përfitohen në trajtën e metaforave me specifikën e vet në ndezjen e atij zjarri të pashuar kombëtar e fetar, themelet e ngrehinës së kombit tonë. Studiuesi bashkëqytetas i Said Najdenit dhe Hafiz Sherif Langut paraqet, atë lloj të rrallë të shkencëtarit bashkëkohor, të çliruar nga çdo lloj verigash nostalgjike me ideologjinë socrealiste, që jo pak herë e ka helmuar objektivitetin e shkencës, sidomos në çështjet delikate të historisë, letërsisë e religjionit.

Autori i monografisë e kontenston dhe e vërteton pasaktësinë, duke e konfrontuar me dokumenta, shkresa, kontekste etj.

"Në të dyja monografitë e Prof. Mahmud Hysës mbi figurat meteorike të Said Najdenit dhe Hafiz Sherif Langut, vazhdo Tufa, tingëllon ky shqetësim në trajtën e zhbllokimit të studimeve tona islamologjike, të cilat vuajnë prej kompleksesh të thella, të vjetra e të mbishtresuara, duke na privuar prej një peisazhi sa të gjallë e identitar, aq dhe kulturor e kombëtar. Studimi i këtyre figurave, të ashtuquajtura dytësore në raport me ideologët e mëdhenj si vëllezërit Frashëri, na fut në logjikën e lëvizjes sonë kombëtare të Rilindjes dhe zgjimit të vetëdijes shqiptare dhe, çka është më e rëndësishme, na zbardhet një peisazh dinamik veprimtarie tipike misionare, çka u konkretizua dhe u mishërua në terren me punën e pikërisht këtyre figurave "dytësore".

Në njëfarë kuptimi Said Najdeni dhe Hafiz Sherif Langu janë figura që përplotësojnë njëra-tjetrën: atë që nisi e përhapi mjeshtri, e plotësoi dhe e vuri në praktikë anëmbanë viseve kombëtare dishepulli i tij. Ka një meritë të padiskutueshme studiuesi Mahmud Hysa edhe në ndriçimin realist të epilogut elegjiak në jetën e secilit prej protagonistëve kombëtarë të monografive. Në të parën, mjeshtri, Said Najdeni alias Hoxhë Voka - vdes i trishtuar, i pezmatuar dhe me dyshim nëse do të triumfojë ideja e tij, të cilës i kishte shërbyer duke sakrifikuar gjithçka, moskrijimin e familjes dhe më së mbrami, shëndetin e tij gjithmonë në zgrip. Fjalët e fundit para vdekjes së Said Najdenit, hoxhës 38-vjeçar, thonë se kanë qenë në trajtë testamenti dhe amaneti njëherësh: "Pa fituar Shqipëria lirinë, mos më vini gurë mbi varrin tim. Pasi të fitohet liria të m'i vini gurët duke i shkruar shqip. Mbi ta të vini një flamur."

Ndërsa epilogu i jetës së Hafiz Sherif Langut, të cilin botimi i KMSH nuk i kushton thuajse as gjysëm rreshti, është tragjik, shokues, absurd dhe indinjues. Autori i monografisë na ka përcjellë një ndër dramat e më tragjike e më të neveritshme të kohës me arrestimin dhe gjykimin e Hafiz Sherif Langut nga drejtësia komuniste si "kriminel lufte". Njeriu që kishte luftuar gjithë jetës për abetaren shqipe, për shkollën shqipe, që kishte marrë armët në dorë kundër turqve e serbëve, që kishte marrë udhën në këmbë nga Shkupi në Vlorë përmes shirash e rrebesheve të nëntorit për të nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë, pra ky njeri që kishte menaxhuar jetën fetare të shqiptarëve për dy dekada në ish-mbretërinë jugosllave, e mandej ishte kreu i KMSH të gjithë Shqipërisë dhe "tokave të lirueme", arrestohet dhe gjykohet si kriminel lufte nga komunistët me 1945. Z. Mahmund Hysa nuk ka lënë detaj pa shfrytëzuar duke rikrijuar gjithë farsën ngërdheshëse të gjyqit komunist mbi Hafiz Sherif Langun, i cili dënohet me 10 vjet burg në moshën 67 vjeçare. Këto kapituj realistë e të mbushura me fakte, ndonëse autori i parashtron sipas logjikës së tyre, përftohet në total përvijimi i menjëmendët i një drame absurdi me kompozicionin tipik dhe syzhetin deri në fund mezi të besueshëm, por ama tragjik e të vërtetë. Shëmtia me gjyqin dhe dënimin komunist të Hafiz Sherif Langut, njërit prej firmëtarëve të Pavarësisë, nuk është e rastit: ajo ka ngjarë me të gjithë ata figura të historisë sonë kombëtare që firmosën aktin e Pavarësisë, e që patën fatin e trishtë të ishin gjallë pas të ashtuquajturit "çlirim", sepse, siç tani dihet gjerësisht, të gjithë i pushkatoi apo burgosi rregjimi i Enver Hoxhës. Duke folur për këto dy figura të nacionalizmit shqiptar, duke rindërtuar spiralen e fatit të tyre, ndjekjet, vështirësitë, sakrificat, ngadhnimet dhe pesimizmin, autori i monografive na jep një pasqyrë psiko-historike dhe ambientale të qytetit të Dibrës, klimën politike dhe frymën e lartë patriotike të elitës intelektuale e fetare të qytetit, në të cilin u zhvilluan 5 kongrese. Dhe nëse Prizreni ishte vendi i Lidhja Mbarëshqiptare, koka e Lidhjes dhe kuvendet e vendimet më të rëndësishme u mbajtën në Dibër. Nëpërmjet risjelljes së këtyre dy figurave të rëndësishme nga elita e veprimtarëve kombëtarë e fetarë të Dibrës, Mahmud Hysa na kujton, se ky qytet, ka qenë një nga vatrat më përcaktuese në fatin e kombit shqipta, se galeria me figurat e këtyre dimensioneve kombëtare sapo është hapur dhe ajo meriton të zbulohet dhe me shkëlqimin dhe pastërtinë e pacënuar të na flasin me tërë rravgimin e jetës së tyre, që e shkrinë për "Fe dhe Atdhe", tha më në fund Agron Tufa.

Dr.Prof. Qerim Lita nga Shkupi në kumtesën e tij me këtë rast tha se, "Ky libër paraqet monografi shkencore me interes në fushën e historiografisë. Autori nëpërmjet materialeve arkivore, dorë shkrimeve, shtypit të kohës, zbardh në mënyrë të gjithanshme veprimtarinë e këtyre dy figurave të shquara. Autori përveç literaturës shkencore ka shfrytëzuar edhe një mori burimesh dokumentare të pa publikuara që ruhen në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë, Arkivin Qendror të Shqipërisë dhe Arkivin e Ministrisë të Punëve të Brendshme të Shqipërisë. Të shkruash një monografi voluminoze prej 600 faqesh me argumente shkencore kushtuar këtyre dy personaliteteve të shquara kombëtare nuk është punë e lehtë, aq më tepër kur historiografia shqiptare i ka lënë në haresë. Autori Mahmud Hysa ia del me sukses të zbardh veprimtarinë kombëtare e fetare të Said Najdenit dhe Sherif Langut përmes materialeve të shumta burimore, të cilat i vendos ti përdorë si argumente në poshtëshënime, pas një vështrimi kritik.

Prof.Dr. Mahmud Hysa duke u mbështetur në burimet arkivore gjërësisht zbardh aktivitetin kombëtar e fetar të udhëheqjes së re të Ulema Mexhlisit të Shkupit gjatë viteve 1938-1941, duke vënë në dukje guximin e madh të Sherif Langut dhe Bedri Hamidit, të cilët direkt fajësonin pushtetin e atëhershëm për shpërnguljen e elementit mysliman për në Turqi dhe reformën agrare me të cilën myslimanëve, përkatësisht ua morrën tokën duke i kërcënuar dhe detyruar të shpërngulen masovikisht. Pas shpartallimit të mbretërisë Jugosllave, Hafiz Sherif Langu kyçet në udhëheqjen e Komunitetit mysliman shqiptar, ku u zgjodh kryetari i Këshillit të Ulemave sepse sipas Hysës Sherif Langu ka qenë personalitet që unin e vet e ka shprehur në secilin tekst të nënshkruar nga ai. Autori hedh dritë mbi politikën represive e të dhunshme të pushtetit komunist shqiptar ndaj Hafiz Sherif Langut i cili përkundër kësaj ngeli i pamposhtur stojicizmi ishte vetia më e çmuar e karakterit të tij", u shpreh Qerim Lita.

Ibrahim Kadriu, shkrimtar nga Prishtina në studimin e tij lidhur me këtë libër thotë se, "këto dy figura janë embleme për një kohë të shkuar. Ky është libri i më i ri i Dr.Prof. Mahmud Hysa, ku flet për dy dibranët e devotshëm, të cilët autori nai sjell përmes penës së ndritur në mënyrë të plotë me gjithë atë veprimtari patriotike të cilën nuk e kishim njohur më parë . Këta dy figura të pasqyruara brenda dy monografive studimore me dëshmi konkrete të gjetura në arkiva, janë emblemë e kohës në të cilën jetuan dhe vepruan, në një kohë të vrarë nga urrejtja patologjike e pushtuesve të tokave shqiptare të cilët tradicionalisht shkelën mbi dinjitetin shqiptar për të na e fshirë të kaluarën, duke i injoruar të sotmen për të mos na lënë vend për në të ardhmen. Autori ka gjetur kohë të vë dritë mbi këto dy figura dhe ngjarje që u bënë pjesë e historisë tonë kombëtare këto dy figura paraqiten stoike, duke mos u përulur para rreziqeve nga të cilat do tu shkonte edhe koka këta dy figura kishin përkushtimin fetar por edhe atë të kërkesave kombëtare. Ky libër studimor për nga mënyra e shtjellimit të lëndës, për nga stili rrëfimor, paraqet shembull të jashtëzakonshëm dëshmues se edhe monografitë mund të tërheqin interesimin e lexuesit që të lexohen me ëndje duke mos iu ndarë librit deri në faqen e fundit. Ky libër për dy dibranët e devotshëm që ishin në kujtesën e dibranëve u bë pronë e të gjithë dibranëve kudo që janë. Kjo monografi shkencore është rezultat i përvojës së madhe të Prof.Dr. Mahmud Hysës i cili është dëshmuar në numrin e madh të veprave shkencore që nga viti 1972 kur e botoi veprën e parë shkencore "Letrari dhe vepra"e deri tek kjo e fundit e njëzetenjëta me rradhë, duke llogaritur edhe shumë libra tjerë shkollorë si autor ose koautor", tha Ibrahim Kadriu.

Mr. Ruzhdi Lata, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe në fjalën e tij u shpreh se, "Me anë të këtij studimi shkencor Said Najdeni dhe Hafiz Sherif Langu si dy veprimtarë të rëndësishëm janë nxjerrë nga anonimiteti provincial, nga pluhur i harresës dhe janë vendosur në konteksin e barabartë me veprimtarë të tjerë të Lëvizjes dhe të Rilindjes Kombëtare atje ku e kanë merituar. Studiuesi u qaset fenomeneve historike kulturore, kombëtare dhe politike duke mos abstraktuar fenomenet tradicionale të ngjarjeve, kronologjisë, emërtimeve, datave për të pasur një pasqyrë sa më komplete të kohës kur kanë jetuar dhe vepruar këta dy veprimtarë. Studiuesi i qaset teorikisht fenomenit të Rilindjes dhe Lëvizjes Kombëtare, të kësaj periudhe më të fuqishme që ka qenë relevante edhe për periudhat e mëtutjeshme, në të cilën ka jetuar dhe vepruar Said Najdeni, i cili është vendosur në konteksin e historisë së letërsisë tonë. Merita e këtij studiuesi është edhe se ka arritur të zbulojë dokumente edhe nga hetimet dhe procesi gjyqësor që i është bërë këtij tribuni të çështjes kombëtare nga gjyqet komuniste për mënyrën tejet antiligjore me të cilën e kanë gjykuar njeriun që është dashur ti vihen kurora prej dafine dhe kurora prej drizash. Është për çdo lëvdatë puna e madhe shkencore e këtij shkencëtari të qytetit tonë që deri më sot ka krijuar paksa në heshtje e pa imponime një vepër shkencore të lakmueshme për qytetin tonë dhe jo vetëm për qytetin tonë", tha më në fund Mr. Ruzhdi Lata.

Dr.Prof. Mahmud Hysa duke i përshëndetur pjesëmarrësit e këtij promovimi, deklaroi se, "unë përmes librave të mi jam indetifikuar si dibran. Gjithnjë kam patur si objektiv të shkruaj një libër për bashkëqytetarët e mi Said Najdeni dhe Sherif Langu. Rruga jetësore e këtyre dy personaliteteve ishte vetëdijesim fetar dhe kombëtar, iluministe dhe krijuese. Kjo dëshmon se dibranët gjithmonë kanë jetuar dinjitozë e të pamposhtur nga sulmuesit. Dinjiteti gjithnjë ka qenë në gjenin e dibranëve. Dibranët kanë ditur gjatë historisë ta ruajnë mentalitetin, gjuhën zakonet dhe kulturën e tyre", tha në fund Mahmud Hysa.

recensë

Studiuesi Mahmud Hysa ka bërë një punë shkencore të mirëfilltë që i ka ofruar lexuesit jo vetëm një studim mjaft shterues, mjaft argumentues, mjaft unikal e mjaft objektiv për jetën dhe veprimtarinë e këtyre dy kolosëve të qytetit tonë, veçmas duke na e pasqyruar edhe veprimtarinë fetare dhe kombëtare të të dyve, por i ofron edhe kënaqësinë e veçantë me botimin e dokumenteve arkivale ku e ka bazuar studimin për t'i dhënë lexuesit mundësinë t'i lexojë edhe vetë dokumentet

Studime integrale për dy veprimtarë të Dibrës

Nga **RUZHDI LATA**

Studimi integral për dy veprimtarë më të shquar të Dibrës, Said Najdenin alias Hoxhë Vokën dhe Hafiz Sherif Langun që hyjnë në kolazhin e këtij studiuesi dibran mjaft produktiv i cili merret ekskluzivisht me studimin e letërsisë shqiptare, është më se i qëlluar pse kemitëbëjmëme veprimtarë që nuk i takojnë vetëm këtij qyteti, por mbarë letërsisë dhe veprimtarisë kulturore dhe politike kombëtare. Natyrisht se është shkruar gjer më tani për të dy këta veprimtarë në formën e artikujve, por studimi monografik shkencor që u është përkushtuardy veprimtarëve është i rëndësishëm për dy arsye: janë nxjerrë nga anonimiteti provincial, nga prapaskena, nga pluhuri i harresës ku kanë qëndruar gjer më tani, veçmas veprimtari i dytë dhe janë vendosur në kontekstin e barabartë me veprimtarët tjerë të Lëvizjes dhe të Rilindjes Kombëtare atje ku e kanë merituar dhe e meritojnë realisht dhe objektivisht.

Metodologjia shkencore që ka amplikuar ky studiues në këto monografi ka pika të përbashkëtadhe dalluese pse edhe vetë veprimtarët dallojnë se Said Najdeni është veprimtar dhe krijues letrar, ndërsa Hafiz Sherif Langu është vetëm veprimtar. E përbashkëta është se studiuesi u qaset fenomeneve historike kulturore dhe vendosja e veprimtarëve në kontekstin e historisë së Lëvizjes Kombëtare, Politike dhe Kulturore duke mos i abstraktuar fenomenet e historisë tradicionale të ngjarjeve, kronologjisë, emërtimeve, datimeve për të pasur një pasqyrë sa më komplete të kohës kur kanë jetuar dhe vepruar këta dy veprimtarë. E veçanta është se Said Najdeni është edhe krijues i periudhës së fundit të Rilindjes Kombëtare dhe vendosa e tij në kontekstin e historisë së letërsisë kombëtare, në dimensionin që ai i përket me karakterin e veprës së tij është një përpjekje vetëm e këtij studiuesi që ka njohuri të shkencore në nivel të historisë së letërsisë shqiptare.

Në e parë studiuesi i qaset teorikisht fenomenit të Rilindjes dhe Lëvizjet Kombëtare, të tipareve që ajo ka pasur, të programit, të platformës dhe fenomeneve që ajo ka arritur për t'i ofruar dhe sqaruar në mënyrë implicite lexuesit të kësaj vepre tiparet kryesore të kësaj periudhe më të fuqishme në historinë e lëvizjeve tona politike dhe kulturore që ka qenë relevante edhe për periudhat e mëtutjeshme, në të cilën ka jetuar, ka vepruar dhe tërësisht i përket Said Najdeni. Në këtë mënyrë lexuesi do të mund t'i kuptojë më mirë veprimet, përpjekjet, idealet dhe sakrificat e Said Najdenit se ato në esencë janë premisa edhe të Lëvizjes dhe të Rilindjes Kombëtare. Një qasje mjaft origjinale dhe me një argumentim të veçantë dhe shkencor, duke shprehur edhe njohuri të thella dhe mjaft konsekuente për fenomenet e historisë së letërsisë sonë, autori ka arritur të bëjë përpjekje shumë të suksesshme për të vendosur Said Najdenin në kontekstin e historisë së letërsisë sonë që asaj tërësisht i përket aq më tepër që këtë nuk e kanë llogaritur asnjë studiues i gjertanishëm se i përket kësaj periudhe letrare, prandaj askush deri më tani nuk ka bërë sprovë për një qasje të tillë.

Natyrisht autorit paraprakisht i është dashur t'i bëjë një qasje analitike dhe fenomenologjike veprës së SaidN ajdenit Ferrëfenjëseja e myslimanëve duke i nxjerrë në sipërfaqe dy tipare shumë të rëndësishme që dalin nga përmbajtja e saj: ate kur'anologjike dhe ate kombëtare, iluministe, politike, morale, etike. Me të vërtetë autori i ka bërë një zbërthim shumë shkencor qoftë fenomenit të parë qoftë fenomenti të dytë. Për fenomenin e parë i është dashur t'i bëjë një qasje shumë serioze vetë njohurive kur'anologjike të Said Najdenit dhe të



Said Najdeni (Hoxhë Voka)



Hafiz Sherif Langu

gjitha këto t'i vendosi në konteskt të studimeve kur'anologjike bashkëkohore si të Dr.Jusuf Kardavit e tjerë. Në këtë mënyrë ka arritur të nxjerrë konkluzione për njohuritë kreative dhe autoktone kar'anologjike të Said Najdenit për pjesën më diskutabile për studimin e Kur'anit, ate të mënyrës së interpretimit të ajeteve që autori ynë ka treguar shumë njohuri, invencë dhe elokuencë. Me këtë pjesë studiuesi, si një njohës shumë çmuar i islamologjisë dhe i alamiadës shqiptare, e vendos Said Najdenin në radhën e islamistëve e islamologëve dhe alamiadistëve shqiptarë ku i takon një vend i merituar në fushën e kur'anologjisë shqiptare. Për shkak të diversitetin të madh në studimet tona shkencore të deridjeshme që i cilësonte karakteri aprioristik i ideologjisë komuniste që ka qenë kundërshtar i madh i fesë në përgjithësi e asaj islame në veçanti, studiuesi ynë Mahmud Hysa bën një digresion për studimet tona në fushë të alamiadës dhe veçmas të islamologjisë shqiptare ku sheh me plot të drejtë se ka ekzistuar një qasje mjaft selektive dhe diskriminuese ndaj kësaj fushe të krijimtarisë sonë në injorimin total të islamologjisë dhe në studimin mjaft parcial të alamiadës shqiptare.

Argumentet janë të shumta për injorimin total sepse jo që nuk janë integruar në planprogramet tona shkollore, por edhe në botimet shkencore dhe kritike që është dashur t'i bëjnë institucionet shkencore shqiptare. Për studiuesin është edhe më skandaloze se vepra të kësaj natyre, biblike dhe klerikaliste katolike dhe ortodokse, nuk janë ndaluar dhe janë botuar nga institucionet shkencore pse kanë qenë të futura në plan programet edhe në fakultete. Përpjekjet në kohë të fundit, të pluralizmit politik, të veprave të alamiados shqiptare dhe të islamologjisë janë më tepër individualese qëndrimet e studiuesve të letërsisë nuk kanë ndryshuar aspak. Në këtë temë studiues me shumë të drejtë depërton shumë thellë pse edhe Said Najdeni është dhe duhet të trajtohet si islamolog dhe alamiadist shqiptar.

Me temën e dytë të veprës Fe-rrëfenjëseja e myslimanëve që studiuesi e karakterizon si kombëtare, patriotike, iluministe, kulturore, morale dhe etike me plot të drejtë e integron edhe autorin, Said Najdenin, në radhët e shkrimtarëve të letërsisë së Rilindjes Kombëtare, në zhanrin e autorëve të traktateve politike, kombëtare, iluministe dhe gjuhësore ku gjenden edhe Pashko Vasa, Naim Frashëri, Sami Frashëri e tjerë. Tema e parë e veprës, ajo kur'anologjike dhe kjo e dyta, Kombëtare, kulturore, gjuhësore nuk janë të sistemuara veçanërisht njëra nga tjetra, por të gërshetuara dhe të ndërthurura, po si tipologji nuk është unikale në letërsinë tonë pse Mahmud Hysa si studiues shumëvjeçar i letërsisë gjen tipologji të tilla që nga periudha e hershme e letërsisë, ajo e neoklerikalizmit diçka me Buzukun, po më shumë me Budin, Bardhin, Bogdanin dhe shumë të tjerë që i trajtojnë po të njëjtat tema në veprat e tyre dhe prandaj quhen edhe neoklerikaliste. Çka është me shumë rëndësi, studiuesi gjen se Said Najdeni i prek të gjitha temat për të cilat kanë folur edhe rilindësit, por autori ynë është krejtësisht origjinal, nuk përsërit asnjërin prej tyre, ka parimet e veta, konceptet, mendimet, idetë dhe vizionet autoktone. Aq më tepër që Said Najdenit të gjitha këto tema kombëtare, si një besimtar i idealizmit objektiv, i gërsheton edhe temat kur'anologjike që e bën veprën edhe më unikale dhe origjinale, të papërsëritshme gjer atëherë edhe sot.

Studiuesi Mahmud Hysa me të drejtë e konsideron autorin tonë si dishepull të Naimit dhe të Samiut, por jo si një tautolog, si një epigon dhe si një kopjues i veprave, i mendimeve, i ideve, i tipologjive letrare të tyre pse Said Najdeni e ka krijuar egon, stilin, versionin e vet krejtësisht origjinal e autokton. Nga gjithë këto, studiuesi në mes Naimit dhe Saidit gjen dy veçori dalluese: Said Najdeni ishte dhe mbeti gjer në fund një besimtar konsekuent, pa luhatje, pa teorizime si panteizmi, metempsikoza që i gjejmë te Naimi dhe Said Najdeni mbeti ndër të rrallët që u inkuadrua me Lëvizjen Kombëtare jo vetëm si ideolog, teoricien, programatist, por edhe si militant për të organizuar kryengritje kundër Perandorisë për të çliruat atdheun nga robëria.

Në studimin e tërësishëm të veprës së Said Najdenit, studiuesi duket se i ka bërë një qasje shumë shkencore veprave të Said Najdenit duke bërë sa analiza fenomenologjike, sociologjike, psikoanalitike veprave të tij, aq edhe studime komparative. Nëse për analizat dallohen studimi për veprën e parë, tipologjia e studimit komparativ dallohet për veprën dytë, Abetare e gjuhës shqip(e) ku vjen në rezultate vërtetë shkencore, do të thotë objektive që asnjë studiues e gjertanishëm nuk e ka bërë dhe e ka analizuar në mënyrë shumë tautologjike, duke përsëritur mendimet dhe vlerësimet e njërit nga tjetri. Ky studiues ka bërë një analizë komparative në mes Abetares së Said Najdenit dhe Abetares së Sami Frashërit dhe ka konstatuar se vepra e Said Najdenit është një variant i shkurtuar nga 59 faqe të Samiut në 16 faqe të Saidit. Mënyra e paraqitjes së alfabetit, e zhvillimit të shkronjave, e mënyrës së bashkimit të shkronjave me dy, tri tinguj, me një rrokje, dy rrokje e tri rrokje është fjalë për fjalë, faqe për faqe si e Samiut. Studiuesi konstaton me keqardhje se SaidNajdeni nuk mund të quhet autor i Abetares në gjuhën shqipe, pa emër autori, dhe se ajo është një variant i reduktuar i asajtë Samiut.

Studimi monografik për Hafiz Sherif Langut është edhe më i mirëseardhur pse studiuesi në bazë të kërkimeve të jashtëzakonshme arkivale ka arritur të na e zbulojë në tërësi rrethanat politike, kulturore, patriotike, divergjente dhe disonante të dy periudha historike që kanë pasur një premisë historike, periudhën e robërisësë popullit shqiptar nga Perandoria Osmane në etapën e fundit dhe të robërisë së popullit shqiptar nën Mbretërinë e Serbisë e më vonë të Jugosllavisë që është në fillimet e saja. Edhe në këtë pjesë përsëriten disa tema se flet për Dibrën e fundit të shek XIX dhe fillimit të shekullit XX, studiuesi ka teguar një afinitet të mos na përsërit qasjen dhe përmbajtjet e temave, në çdo pjesë trajton brendi të tjera që janë adekuate me veprimtarinë e secilit personazh që ka marrë në trajtim. Qasja e temës biografike dallon në pjesën për Hafiz Sherifin pse më tepër i pëlqen të trajtojë fenomenet për temën dhe jo historinë e temës. Në biografinë ka risi se i qaset fenomenit të gjenetikës familjare nga nxjerr premisa shumë interesante për Hafiz Sherif Langun. Kontrubuti më i madh është pjesa ku studiuesi i qaset veprimtarisë së Hafiz Sherif Langut si kryetar i Ulema Mexhlisit në Shkup me ingerenca për tërë Jugosllavinë Mbretërore. Kjo pjesë është një studim i veçantë si ai për veprimtarinë e Hafiz Sherifit në krye të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë se studiuesi bazohet në dokumentat arkivale të cilat janë më të sigurta dhe më burimore.

Nga gjithë ky material shumë i bollshëm dhe i larmishëm që autori i studion sipas tipologjive të shkrimeve, na del një punë e madhe, shumë intensive dhe shumëdimensionale e Hafiz Sherif Langut të cilën opinioni e merr vesht për herë të parë. Me këtë rast e kupton se Hafiz Sherif Langu ishte një personalitet i rrallë që ka dhënë qyteti ynë për kah fuqia e veprimit, për kah fuqia intelektuale, për kah energjia dhe potenciali kulturor. Një meritë e papërsëritshme i takon këtij studiuesi që ka arritur të zbulojë dokumentet nga hetimet dhe nga gjykimiqë i është bërë këtij tribuni të çështjes kombëtare nga gjyqet komuniste. Studiuesi jo vetëm që na informon, por jep edhe mendimet e veta për çdo akt, çdo vendim, çdo veprim të punës së Hafiz Sherif Langut, por edhe hetimet, gjykimin dhe karakterin e gjyqeve komuniste, për mënyrën shumë antiligjore me të cilën e kanë gjykuar njeriun që është dashur t'i vehen kurora prej dafine dhe kurora prej drizash. Si duket studiuesi ka bërë një punë shkencore me shumë përkushtim, me shumë dashuri, me shumë objektivitet që të zbardhi të vërtetat për këta dy personalitete markante të të kaluarës jo shumë të largët të qytetit tonë.

Stidiuesi Mahmud Hysa ka bërë një punë shkencore të mirëfilltë që i ka ofruar lexuesit jo vetëm një studim mjaft shterues, mjaft argumentues, mjaft unikal e mjaft objektiv për jetën dhe veprimtarinë e këtyre dy kolosëve të qytetit tonë, veçmas duke na e pasqyruar edhe veprimtarinë fetare dhe kombëtare të të dyve, por i ofron edhe kënaqësinë e veçantë me botimin e dokumenteve arkivale ku e ka bazuar studimin për t'i dhënë lexuesit mundësinë t'i lexojë edhe vetë dokumentet dhe për t'i treguar se u ka bërë një qasje shumë studimore me përkushtim të veçantë, me qasje shumë racionale për të na dhënë një vepër ndër më të fuqishmet që u janë bërë këtyre dy Davidëve të qytetit tonë. Është për çdo lëvdatë puna e madhe shkencore e këtij shkencëtari të qytetit tonë që deri më sot ka krijuar paksa në heshtje e pa imponime një vepër shkencore të lakmueshme për qytetin tonë dhe jo vetëm për qytetin tonë.

Fasli Fetah Cami, mësuesi i parë dëshmor

Fasli Cami lindi në nëntor të vitit 1912 në fshatin Viçisht të Dibrës.

Fasliu së bashku me Ahmetin dhe Kurtin janë tre djemtë e Feta Camit. Fetai ka marrë pjesë në luftërat kundër turqve, serbëve e bullgarëve, ku u vra nga bullgarët në vitin 1916 dy vjet para vrasjes së të jatit Shabanit gjatë një përleshje me pushtuesit bullgarë në fshatin Golovisht. Së bashku me Dan Shemë Camin organizuan pritën ndaj bullgarëve ku në këtë përleshje u vranë shumë ushtarë bullgarë.

Bullgarët nga ana e tyre organizuan më pas rrethimin e shtëpisë së Fetës dhe e vranë në pragun e derës së pasme. Feta Cami është dëshmor i Atdheut i luftës për liri dhe pavarësi.

Fasliu shkollën fillore 6 vjeçare e kreu në Internatin e Kastriotit të Dibrës nga viti 1920 deri në vitin 1926. Më 1927 u pranua në shkollën mbrëtërore dhe more seminaturën në vitin 1931. Po në këtë vit u transferua në gjimnazin e shtetit në Tiranë dhe vazhdoi studimet në këtë gjimnaz deri në fundin e vitit 1932, kohë kur e përjashtuan se kërkonte drejtësi dhe shfaqte shenja rebelizmi ndaj padrejtësive. Me shumë përpjekje u ripranua për të vazhduar studimet në shkollën normale të Elbasanit, ku mori maturën më 1935. Me 1936 u martua me Fitnete Sakiqin, të bijën e Qazim Sakiqit nga Dibra e Madhe. Porsa mori maturën në vitin 1935 u emrua mësues në katundin Luzni të Dibrës. Në vitin 1936 u transferua në Besmisht të Pogradecit. Në verën e vitit 1937 u transferua në Ostren të Madh. Në kallnuer të vitit 1939 u transferua në Gjoricë, ku shërbeu me nder, përgjegjësi dhe ndërgjegje deri më 6 prill 1941, deri në momentin kur fashistët italianë e vranë në kodrat e Gjoricës mbi shtëpijat e fisit Mera, kur po kthehej nga Gjorica për në shtëpi, pas organizimit që kishte bërë për kryengritjen e 7 prillit të vitit 1941 kundër fashistëve italianë.

PROFESOR ALEKSANDËR XHUVANI, MËSUESI I FASLI CAMIT TREGON SI REVOLJA PARTIZANE QËLLON NË KLASË NDAJ MËSUESIT ITALIAN

Fasliun e përjashtuan për pak kohë nga Shkolla Normale e Elbasanit ku ndiqte mësimet. Dhe shkaku ishte i kuptueshëm. Fasliu nuk mund të duronte tekat dhe urdhërat e mësuesve italianë. Në orën e edukatës fashiste, Fasliu shtie me revole ndaj mësuesit italian.Por miku i shtëpisë dhe i Ahmetit, Profesor Aleksandër Xhuvani, drejtori i kësaj shkolle erdhi vetë në shtëpi, zhvilloi provimin dhe më pas pruri në shtëpi dëftesën e shkollës së përfunduar. Fasliu e ka kryer detyrën ndaj shkollës dhe ndaj Shqipërisë, tha Xhuvani.

MËSUESI QË MBANTE PUSHKËN VARUR NË MURIN E KLASËS

Lirie Ahmet Cami (Rakipi), nxënësja e Fasliut tregon:

Kur Fasli Cami ka qenë mësues në Gjoricë në vitet 1940-1941 e mbante pushkën gjithmonë në klasë varur në mur. Kjo konsiderohej anti pedagogjike, ndaj kryemësuesi e pyet:"Përse e mban pushkën të varur pas dere në klasë?

Liu u përgjigj:"E përse mos ta mbaj more zotëri? A nuk e shikon se po kalojmë kohëra të vështira, se jemi në luftë?

Kryemësuesi e kundërshton:"Ne nuk kemi punë me luftën sepse nuk po na kërcënon njeri. Liu ju përgjigj përsëri:"Ashtu thua zotrote por këto të shkreta (dhe tregoi pushkët) duhen mbajtur për ti mbrojtur këta vocërrakë dhe për të mos shkuar gjakhumbur.

JA SI SHKRUAN NË DITARIN E TIJ VËLLAI I FASLIUT, KAPITEN AHMET CAMI

Porsa më kishte zanë gjumi, aty rreth orës 22.00 më thirri jashtë Sefer Cami dhe më dha lajmin se Fasliu është plagosur pak në krahun e majtë dhe se është shtrirë tek shtëpia e Halil Gjurës në Çerenec. Menjëherë më shkoi mendja se mos kishte vdekë ose është randë sa nuk shpëtonte.



Fasli Fetah Cami

U tmerrova. Për ti nxjerrë të vërtetën Seferit i thashë të marrim kalin për ta sjellë në shtëpi, por ai më tha se nuk mund të qëndrojë në kalë.

E atëhere u kuptua se ai ose ka mbarue ose asht shumë randë.

Atëhere mora me vehte Seferin, Izetin, Destanin, Uken e Feritin e Dullës dhe Ibrahim Lecin. Kur shkuam në vend Fasliun e gjetëm të mbarue. Atëhere u mpiva dhe nuk munda as të qaj, as të derdh lot e as të flas.

Me dhimbje të madhe dhe me za të ulët i rendita këto fjalë më vaje:

A mendove ndopak se jeta ime pa ty s'vlen fare dhe asht e nxime fare? Si do të rri unë pa ty, o Fasli? Kurse unë s'mundesha me pritun javën me të pamun sa të vije ti nga Gjorica? ! Oh Përëndia ime ! A për këtë ditë e paske kaq të mirë e të sjellshëm këtë djalë? Po mua ku më le mor vëlla në këtë kohë të vështirë? A mendove ndopak se jeta ime pa ty do të nxihet për jetë. A mendove se vendi ka nevojë për trima !

Bravo, bravo, o vëllai im i vogël, o djali im i madh, o Fasli trimi ! Jam krenar për ty, se ty dhe jetën për lirinë e vatanit, se ti je dëshmori i parë i lirisë në këto anë. Shembullin dhe amanetin tënd do ta ndjekim të gjithë ne , të afërmit dhe bashkëluftërarët e tu.

Bravo, o Fasli vëllai ! Ti ndoqe shembullin e babës tonë Fetës, të gjyshit tonë Shabanit, si dhe të paraardhësve të tjerë, që kanë dhënë jetën për lirinë e atdheut kundër zaptuesit.

A zani i tyre të ndolli që dole i pari dhe të mori plumbi si ata? Po ne na presin shumë punë dhe na kërkohet shumë luftë kundër zaptuesit.

Po si do të bëjmë pa ty, o Fasli? Si do të bëjmë pa ty në rradhët tona, pa të patur ty në krah?

Këto qenë pyetjet dhe lutjet që i drejtova Fasliut tim. Por ai nuk mu përgjigj se kishte mbarue prej kësaj jete. Por unë nuk dua ta besoj se para meje qëndron i shtrirë si një div i fuqishëm vëllai im, që e rrita dhe shkollova vetë se baba im, Feta, u vra shumë shpejt dhe e la të vogël. Por edhe nana jonë Bejaze (e bija e Rustem Dukës nga Spasi i Dibrës së Madhe) e la të parritur vetëm 11 vjeç.

Tek shtëpia e Halil Gjurës ishte Halili me të shoqen, Rushit Izvira dhe Suf Koçi që më ngushëlluan dhe më thanë se Fasliu ka vdekur si burrat pa ba of.

E mbartëm Fasliun dhe u nisëm për në shtëpi. Me shumë mundime e prumë në shtëpi aty rreth orës 02.00 të datës 8 prill.E shtriva kufomën e tij në krevatin tim, ku u nis vaji familjar. Unë, pasi e përqafova edhe një herë Fasliun, që është ende i ngrohtë i thashë gruas time Bejaze Kamberit :"Tash na vdiq djali ynë i madh ! Tash mbaroi shpresa jonë. Tash përëndoi jeta dhe ylli i dritës tonë !"

Mbas këtyre fjalëve u shkreha në vaj. Janë lotët e parë që po qes në jetën time...

Fasliu po vajtohet nga burrat të ulur në gjunjë. Po e qajnë Fija, Razija, Lushja e Shemja që u bie të fikët herë pas here, sepse është e paimagjinueshme që të përcjellim për në varreza Fasliun që nuk i ka mbushun ende 29 vjeç.

Trupi i plagosur që dha jetë në shtëpinë e Kasem Halil Gjurës ishte prologu i kryengritjes që mori përmasa të mëdha dhe komandohej nga vëllai i Fasliut, kapiteni Ahmet Cami që kishte mbaruar akademinë ushtarake në Itali. Fashistët italianë u kundërpërgjigjën me arrestime, burgime e raprezalje.

SAKIP CAMI

NORMALISTI

Normalisti i "rrezikshëm"
Kurrë fshatin s'e harroi
Fshatin ku i jati i tij
Kundër serbëve luftoi

Tekstet italiane i hodhi tej
Abetaret i nxorri nga dheu
"Mësoni pushkën, o fëmijë,
Librin e pushkën e atdheut"

I kish ruajtur gjyshja
Në sepetin e gurtë
I kish ruajtur nëna
Bashkë me flamurë

Në gjoks mbante hartimet
E vocërrakëve të mësuar
O sa shumë ëndërrime
E kishin pushtuar.

Me dhjetra fashistë
Rrugën ja prenë
Por nuk pritet drita
Nuk ndalen rrufetë.

Hartimet u gjakosën
U gjakosën ëndërrat
Trupin e mësuesit
E mbështollën ëndërrat.

FSHATI I TËRË PRANGOSET DHE BURGOSET NË BURGUN FASHIST, NJËZETË BURRA BURGOSEN, KATËR PUSHKATOHEN

Kjo kryengritje mori përmasa të organizuara kur italianët erdhën nga Tirana me Divizionin e tyre "Firence" drejt Dibrës së Madhe dhe me fillimin e raprezaljeve të tyre.

Një pjesë e këtij Divizioni u fut edhe në fshatin Viçisht. Atëhere burrat e fshatit rrëmbyen armët me i ra italianit. Gratë, fëmijët dhe të moshuarit u shpërngulën në Lubalesh. Shtëpitë e Ali Kotilit e të Mustafa (Faje) Kotilit u bënë baza të zjarrta të luftës Nacional Çlirimtare.

Rreth 60 vetë të fisit Cami u strehuan në këto dy shtëpi, familja e Ahmet Camit prej 16 personash, familja e Jasharit prej 20 pesonash, e Sinanit prej 10 personash, e Adem Camit prej 10 personash, e Dullë Camit prej 10 personash etj.

Kryengritja e parë kundër italianëve shënon 7 prillin 1941 në kodrat e Vanastranës në orën katër të mëngjezit dhe vazhdoi deri më 9 prill ku mbetën të vrarë 50 ushtarë italianë. Më 9 prill 1941 në orën 6 të mëngjezit rrëzohet një aeroplan italian në fushë të Gjoricës, aeroplan i cili mbështeste mësymjen e Divizionit "Firence".

U arrestuan Ejup Cami, Uke Cami, Musa Cami, Hidër Cami, Adem Cami, Lam Cami, Aqif Cami dhe Mexhit Lezi të cilët më 13 prill u dënuan me pushkatim nga pushtuesit. Ata u egzekutuan në fushën e Mireshit. Mbetën të vdekur Ejupi dhe Mexhiti. Ukja dhe Hidri arritën të largoheshin. U largua edhe Musai por nga plagët vdiq në Pasinkë. Më vonë u vra edhe Sefer Cami dhe vrasja e tij qe tinzare.

Fashistët dhanë urdhër të prerë: të prangoset i tërë fshati. Tërë burrat e fshatit në burg. Një fshat i tërë në burgun fashist. Kuestori Abisino i specializuar për fushatat e tij kriminale bënte "detyrën" e tij me zell të veçantë. I merrte në pyetje një nga një ashtu siç dinte ai. Pas disa ditë qëndrimi në Post Komandën e Homezhit, 20 burrat e këtij fshati i dërguan në burgun politik të Tiranës dhe pas disa muaj qëndrimi në këtë burg i dërguan në burgun e famshëm të Burrelit.

Ishin 20 burra, të rinj e të vjetër, të martuar e beqarë, të sëmurë e të uritur. Dulla me të birin, Destani, djalë i vetëm, Lami me të vëllain dhe të birin, Ahmeti, të cilin nuk arritën ta pushkatojnë më 12 prill 1941, Dilaveri që nuk arriti të shikonte dritën e diellit pasi torturat i morën jetën, Selim Mjeshtri dhe Ibrahim Buziu të cilët ndonëse të sëmurë rezistonin më shumë se të tjerët.

Mësuesi i Popullit dhe studiuesi Musa Kraja në një studim të tij për arsimin në Shqipëri e konsideron rënien e mësuesit Fasli Cami, si dëshmorin e parë nga rradhët e mësusesve dëshmorë të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Ndaj edhe unë duke perifrazuar Prof M.Krajën e vura titull të këtij shkrimi. Le të jetë ky shkrim një homazh në ditën e 7 Marsit dhe të 6 prillit, 73 vjetorit të rënies të këtij mësuesi që për të ardhmen e fëmijëve dhe të brezave dha çkishte më të shtrenjtën, jetën e tij.

SAKIP CAMI

Letër në redaksi

Falënderim për Ilir Krosin dhe Veli Vraniçin

Të dashur vëllezër të gazetës së pavarur "RRUGA E ARBERIT",

Në fillim ju përshëndes sinqerisht, duke ju përgëzuar për punën tuaj të mrekullueshme që po bëni në dobi të çështjes dibrane, duke dëshiruar që ju dhe mbarë familjet tuaja të keni shendetin e mirfilltë mbarëfamiljar.

Arsyeja pse po ju shkruaj është intervista ime dhënë gazetarit të nderuar Beqir Sina, përndryshe mikut tim, me titull "Një jetë e tërë me këngën popullore shqiptare!".

Në këtë shkrim nuk është përmendur falënderimi im për kryetarin e Bashkisë së Peshkopisë z. Ilir Krosin, Këshillin Bashkiak dhe kryetarin e saj, si dhe në veçanti falënderimin për mikun tim të ngushtë, z. Veli Vraniçin, të cilit unë i detyrohem shumë.

Sinqerisht,
Haxhi Maqellara

Shënim i redaksisë:

Pas letrës së këngëtarit të talentuar Haxhi Maqellarë drejtuar në redaksi, në verifikuam gjithë korrespondencën dhe procedurën e redaktimit të shkrimit, dhe rezultoi se intervista me zotin Maqellarë është redaktuar vetëm në disa detaje të vogla, pa shkurtuar apo hequr asnjë rresht.
Gabimi për të cilin shkruan zoti Maqellarë ka ndodhur para se shkrimi të vijë për botim në redaksi.

Redaksia



Pamje nga shati "Vërbgjan" i Rekës së Epërme
(Foto marrë nga faqja në Facebook "Reka e eperme"

Reka e Epërme në shënjestër të asimilimit gjuhësor e kombëtar

Nga **SEJDI M.GASHI**

Historia e Rekës së Epërme është historia e të gjithë shqiptarëve, sepse përherë kjo është bashkëndierë, është bashkëjetuar, kudo që ka shqiptarë, pasi që përgjatë viteve nuk kanë munguar përpjekjet e shqiptarëve patriot që Çështjes së Rekës së Epërme t'i bëhet një trajtim dhe vlerësim i drejtë, pasi vetëm në këtë mënyrë do mund t'i gjendej një zgjidhje kauzës shqiptare në Maqedoni.

Çështja e Rekës së Epërme është komplekse dhe me vete ngërthen një histori të tërë, histori sa krenare aq edhe trishtuese, pasi që përpjekjet e faktorit sllavë në Ballkan për ta tjetërsuar qenien shqiptare, përherë kanë qenë dhe janë prezent. Një gjë të tillë e thekson edhe gjuhëtari Qemal Murati kur thotë se *"në galerinë e komuniteteve etnike në Ballkan, rrallë mund të gjesh një shembull tjetër të ngjashëm me atë të shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme të Gostivarit, të asimiluar etnikisht me metodat më jezuite sllave në elementin maqedonas, dhe pastaj për shkak se ata kanë ruajtur pjesërisht gjuhën e tyre amtare shqipe, të shpallur nga këta të fundit si sllavë të shqiptarizuar"*[1].

Ndaj edhe qëllimi i këtij punimi është që propagandës armiqësore serbo-maqedonase, t'i kundërvihemi me fakte gjuhësore, historike dhe të tjera, që dëshmojnë autoktoninë shekullore të Qenies Shqiptare në Trevën e Rekës së Epërme.

Disa nga çështjet që do t'i trajtoj në këtë punim janë: *Kush janë shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme? Si trajtohen ata nga shkenca sllave? Si e ndiejnë vetën rekalinjtë e sotëm? Si ndodhi që gjuha shqipe " të këmbehet" me atë maqedonase dhe në ç'rrethana ndodhi kjo?*

Dihet mirëfilli që lufta e ashpër sllave për bjerrjen e qenies shqiptare është zhvilluar në disa fusha si në atë gjuhësore, historike, antropologjike, gjeografike, etnografike e folklorike, e pa dyshim që gjuha shqipe ka qenë më e sulmuara, pasi që vite më parë, studiuesi Eqrem Çabej, ka konstatuar që *"gjuha është një prej shenjave të para dalluese të kombësisë"*, dhe këtë pohim profesor Çabej e bëri me të drejtë. Më këtë mendim fuqishëm pajtohet edhe studiuesi Rexhep Qosja, - kur thotë se *"gjuha është biografi e popujve, sepse në gjuhë dhe me gjuhën, më mirë se në çdo dokument-material, ruhet historia e tyre intelektuale, sociale, morale"*[2].

Në Rekën e Epërme, krahinë kjo dikur me tipare të veçanta etnolinguistike, etnografike, por edhe racore, vite më parë gjëllinte një populsi shqiptare ortodokse, që në kapërcyell të kohëve, qysh në vitet e dhunës sllave, duke filluar herët e më intensitet të shtuar ndërmjet viteve 1913, 1955 e më pas në vitet 1976, 1978, 1982, 1988 e deri në 1997, detyroi popullatën shqiptare të kësaj krahine të shpërngulet, kurse një pjesë tjetër iu nënshtrua asimilimit të egër, nga elementi shqiptar ortodoks, në elementin ortodoks sllavo-maqedonas.

Në rrugën e këtij asimilimi të egër, instrument kryesor i përdorur nga aparati i dhunës shtetërore serbo-maqedonase, ishte feja ortodokse.

ETIMOLOGJIA E TOPONIMIT REKA

Në aspektin toponimik, Reka e Epërme (maq. Gorna Reka), emrin e sotëm e ka marrë nga fjala sllave *"reka"* (shq. *"lumë"*), pasi që siç dihet kjo krahinë e Malësisë së Mavrovës në masivin e Korabit, në afërsi ndërmjet kufirit shqiptaro-maqedonas, përshkohet nga rrjedha të shumta ujore që derdhen te Radika (emri i lashtë *Ardica*[3]).

Mbi historinë e Rekës dhe të rekalinjëve janë hartuar studime, që pos plejadës së të ashtuquajturve shkencëtarë sllavo maqedonas, rus e bullgar, nga ana e studiuesve perëndimorë, janë hartuar studime me vlerë shkencore e

> Shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme duhet ta kenë të drejtën e tyre historike që t'i rikthehen identitetit të të parëve të tyre shqiptarë. E jemi të bindur se një gjë e tillë do të arrihej vetëm atëherë kur faktori politik shqiptar do të ishte më i bashkuar, më i vetëdijshëm ndaj kësaj kauze kombëtare shqiptare dhe vetëm atëherë, do të ndikohej në përmirësimin e këtij fataliteti historik që më vite ka goditur këtë pjesë të trungut shqiptar.

historike. Vlen të përmendim këtu studimin monografik të mjeshtrit të albanologjisë , Franc Baron Nopça, të titulluar *"Jeta e fshatarëve shqiptarë në Rekën e Epërme të Dibrës"*, përgatitur si doreshkrim më 1914, por botuar në Vjenë në vitin 2007 nga studiuesi Robert Elsie. Ky studim monografik me mjaft vlerë, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe argumentuese, paraqet një tablo të një jete të zhdukur të shqiptarëve ortodoksë. Jo vetëm kaq , por ky studim i Nopçës, është i pasur edhe me materiale etnografike e gjuhësore, të përshkruara me mjeshtëri dhe akribi shkencore nga ky autor. Ky libër është përkthyer edhe në maqedonisht nga Bajazit Elmaz Doda.

Studime lidhur me Rekën janë bërë edhe nga N. Jokl dhe studiues tjerë me renome ndërkombëtare.

Në aspektin gjuhësor, nga analizat dhe hetimet e bëra nga Nopç-i dhe Jokl-i, nga pikëpamja etimologjike-gjuhësore, rezulton që 37% e fjalëve janë autoktone shqipe, 19% latine, 20 % sllave dhe 23% turke. Nga kjo shihet qartë se te njerëzit e Rekës së Epërme që gjuhë amtare kanë gjuhën shqipe, nuk ka asnjë mundësi tjetër, që ata të mos jenë shqiptarë, pasi që gjuhë amtare kanë shqipen, e nuk janë sllavë që flasin shqip , ashtu siç trumbeton propaganda sllave.

Në aspektin e strukturës toponimike, Reka e Epërme, sipas regjistrimeve të vitit 1972 kishte 22 fshatra, kurse sot ka vetëm 17 fshatra, me popullsi të përzier shqipfolëse e maqedonase:

Beliçica, 15 shtëpi, 90 banorë
Bibaj, 20 shtëpi, 110 banorë
Bogdi, 35 shtëpi, 260 banorë
Grekaj, 20 shtëpi, 99 banorë
Kiçinca, 10 shtëpi, 54 banorë
Krakornica, 40 shtëpi, 240 banorë
Niçpuri, 15 shtëpi,75 banorë
Nistrova,45 shtëpi,315 banorë
Nivishta, 15 shtëpi,75 banorë
Rimnica, 45 shtëpi, 280 banorë
Senca, 50 shtëpi, 300 banorë
Tanushaj, 50 shtëpi, 310 banorë
Vau, 80 shtëpi,380 banorë
Vallkavica, 30 shtëpi, 200 banorë
Vërbeni, 90 shtëpi, 480 banorë
Vërbjani (fshati më i madh i Rekës së Epërme, i banuar me popullsi shqiptare).
Zhuzhnja, 23 shtëpi, 102 banorë. [4]

Ndërkaq fshatrat e shpërngulur (shpopulluar janë: Reçi, Strezimiri, Tërnica dhe Shtirovica, kurse fshatra të pastra shqiptare, sipas dialektologut maqedonas, Bozho Vidoeski[5], janë: Nivishta, Zhuzhnja,Vërbjani,Tanusha dhe Grekaj. Ndërkaq studiuesi shqiptar, Sejfedin Haruni, në studimin e tij, *"E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit"*[6], thekson se fshatrat shqiptare kohëve të fundit po vijnë duke u pakësuar, kjo si pasojë e presioneve të ndryshme.

Ndodh një gjë e tillë, marrë parasysh rrethanat politike, por edhe ekonomike, që kanë mbretëruar me vite të tëra e që po mbretërojnë edhe sot, pasi shteti i Maqedonisë, ndonëse aspiron integrimet euroatlantike, nga rrënjët e sistemit të vet kushtetues e politik ende nuk ka arritur që të largojë diferencimet mbi baza etnike.

REKA E EPËRME ME FIGURA TË NDRITURA TË KOMBIT SHQIPTAR

Treva e Rekës së Epërme, shquhet edhe për faktin se ka dhënë personalitete të rëndësishme në shumë fusha të jetës shoqërore. Ndër ta po përmendim, Josif Bagerin, rilindësin e shquar shqiptar nga Nistrova, i cili me talentin e rrallë, me veprimtarinë e tij të begatë intelektuale e patriotike u bë model i njeriut të civilizuar, i cili diti të çmojë vlerat njerëzore, të dojë e të çmojë kombin e tij, por të respektojë edhe pjesëtarët e përkatësive tjera etnike. Të flasim më tepër për figurën e Josif Bagerit në këtë punim tonin kaq modest, nuk do të ishte e mjaftueshme, pasi që ky rilindës ka hyrë në historinë e Kombit Shqiptar, krahas figurave më të ndritura.

Në këtë kontekst, është për t'u vlerësuar meritueshëm edhe figura e Branko Manojlovskit , me origjinë nga Reka e Epërme, i cili tash e 40- vjet jeton dhe punon në SHBA, por një pjesë të mirë të kohës e kalon në vendlindjen e tij. Gjatë vizitës që ai i bëri Kosovës, në qershor të vitit 2013, në takime me përfaqësues të Institucioneve të Republikës së Kosovës, ky atdhetar shqiptar ka rrëfyer fakte pikëlluese për fatin e rreth 300 mijë shqiptarëve ortodoks në Maqedoni, ringjalljes kombëtarëve të të cilëve, ua ka kushtuar jetën e tij prej misionari. Atdhetari Manojlovski, është shprehur optimist për suksesin e misionit të tij të vështirë: *"Shqiptarët ortodoks në Maqedoni po u kthehen rrënjëve. Dua që fëmijët tanë dhe fëmijët e fëmijëve tanë ta dinë se vijnë nga etër e gjyshër shqiptarë, e ta kuptojnë se gjaku ujë nuk bëhet"*[7],- është shprehur veprimtari nga Reka e Epërme, duke përkujtuar rilindësin e madh shqiptar të asaj treve, Josif Bagerin.

Kur jemi te njerëzit e penës, e të dijës që rrjedhin nga toka shqiptare e Rekës së Epërme, nuk duhet harruar pa përmendur edhe intelektualin, poetin, përkthyesin e shquar, anëtarin e Akademisë së Shkencave të Maqedonisë, Mateja Matevski. I lindur në Stamboll, në një familje shqiptare të shpërngulur nga Reka, ndonëse deklarimin publik se është shqiptar e bëri relativisht vonë, një gjë e tillë nuk mund të mos mbetet pa vlerësuar.

Ky akt patriotik i Matevskit duhet të shërbejë si model për të gjithë ata që vetën e ndiejnë shqiptarë, që publikisht ta deklarojnë përkatësinë e tyre shqiptare, pasi që siç thotë një fjalë arbëreshe, *gjaku i arbrit ndonëse i shpërndarë, ai ende rron.*

Nga ana tjetër duhet të na mundojë fakti që *"shqiptarët ortodoksë nuk janë komunitet zyrtar në Maqedoni, madje shumë prej tyre deri pak kohë më parë kishin frikë të deklaroheshin si shqiptarë... pasi që pushteti sllav shkoi deri në atë nivel sa që shumë familjeve shqiptare ua imponoi mbiemrat e rinj"*[8]- sipas tipologjisë sllavo-maqedonase.

Për fund të kësaj paraqitjeje më lejoni të theksoj se shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme duhet ta kenë të drejtën e tyre historike që t'i rikthehen identitetit të të parëve të tyre shqiptarë. E jemi të bindur se një gjë e tillë do të arrihej vetëm atëherë kur faktori politik shqiptar do të ishte më i bashkuar, më i vetëdijshëm ndaj kësaj kauze kombëtare shqiptare dhe vetëm atëherë, do të ndikohej në përmirësimin e këtij fataliteti historik që më vite ka goditur këtë pjesë të trungut shqiptar. Këtë gjë nuk po e themi si dëshirë për vetën tonë dhe si urrejtje ndaj të tjerëve, por ky pohim yni i ka rrënjët mbi bazën e objektivave dhe parametrave etnik, historik, gjeografik, etnologjik, e gjuhësor.

Referenca:

1. *Qemal Murati, Reka e Epërme-një fenomen ekzemplar asimilimi, në: Hetime e vjelje për gjuhën shqipe, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012, fq. 70.*
2. *Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Tiranë, 1988, fq. 621.*
3. *Qemal Murati, Reka e Epërme-një fenomen ekzemplar asimilimi, në: Hetime e vjelje për gjuhën shqipe, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012, fq. 71.*
4. *Qemal Murati, Reka e Epërme-një fenomen ekzemplar asimilimi, në: Hetime e vjelje për gjuhën shqipe, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012.*
5. *Božo Vidoeski, Debarskite gojori, Makedonski jazik., Institut za makedonski jazik" Krste Misirkov", Skopje, 1968.*
6. *Sejfedin Haruni, E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit,Shkup, 1994.*
7. *Pjesë nga deklarata e Branko Manojlovskit, gjatë vizitës në Prishtinë, në takim me kryeparlamentarin e Kosovës, Jakup Krasniqi, më 14 qershor 2013.*
8. *Qemal Murati, Reka e Epërme-një fenomen ekzemplar asimilimi, në: Hetime e vjelje për gjuhën shqipe, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012, fq.160.*

Në përvjetorin e 120 të hapjes të shkollës së parë shqipe në Homesh. Pozita gjeografike dhe patriotike

Homeshi, katër gjenerata pedagogjikas



Pamje nga Homeshi. Foto: © Shpëtim Cami

Nga **MEHDI DEMA**

Fshati Homesh, ish-kryeqendër e grykës së vogël, të Dibrës, gjendet në koordinata gjeografike: 41gradë 33' 34,42'' N dhe 20gradë 26' 30,15'' E, në lartësinë 488m mbi nivelin e detit.

Ndoshta qe pozita gjeografike e këtij fshati, i ndodhur përballë një fushë beteje me pushtues të ndryshëm, që nga periudha e Skënderbeut në ndërluftimeve kundër Osmanëve, me përqëndrim në kalanë e Grazhdanit dhe të Homeshit, e deri në shtetformim kundër serbëve, që edukoi ndjenjën e thellë patriotike të banorëve të krahinës së Homeshit.

Shumë domethënës, për këtë histori, janë vargjet që burojnë nga gura popullore: *Hajredin Pasha po vjen Radikës, / -Vallë ku janë mallet e Dibrës?/ -Ke Kalaja në fushë t'Gjoricës ... / N'fushë t'Gjoricës ke Kalaja, / Hajredin Pashën ç'e ka gjet belaja. /Hazis Dema, ni saj zi, / Shemi Malet e i lshoi n'Dri./ Krisi pushka n'Mikoresh,/ I shkoi krisma në Homesh. / N'at Homesh ke Kurt Dema, / Atij Bimbashit i ngrini Zemra. / Apo: ...Rafti teli kah Serbia, / U shemb Dibra, u dynd malsia. / ....Mersim Dema me dy patllak, / Ke ura e Shehrit u ba shumë gjak. / Thërret Krajli, oj krajlicë! / Na erdh Dibra në Vllajnicë.*

Homeshi ka qenë jo vetëm kryeqendër e patriotizmit dibran, me prijësa me zë, që nga Met Dema, Kurt Krrusa, Qerim Turja, etj., në vitet 1840, dhe në vazhdim me Haziz Demën, Rahman Demën, Mersim Demën, etj., që dijtën të harmonizojnë majft mirë veprimtarinë patriotike të Grykës së Vogël, me veprimtarinë e prijësve tjerë të "Maleve të Dibrës", kundër pushtuesve të rradhës, në mbrojtje të kufijëve kombëtar; por edhe qendër me veprimtari këmbëngulëse dhe pa kompromis, për mësimin e gjuhës kombëtare, deri në hapjen e shkollave të para shqipe.

Përpjekjet patriotike për mësimin e gjuhës dhe hapjen e shkollave shqipe.

Mbas shumë përpjekjesh, falë ndjenjave patriotike, me këmbënguljen vetmohuese të Mersim Mustafa Demës, më 1894, me leje të ministrisë osmane të arësimit, u lejua mësimi i gjuhës shqipe, që shënoi dhe hapjen e të parës shkollë shqipe në Homesh, me rezatim në të gjithë krahinën. Do të duheshin përpjekje të vazhdueshme pasuese, që kjo rreze drite të mos shuhej, po, ky zjarr nuk u shua kurrë. Në kuadër të këtyre përpjekjeve janë edhe pjesmarrja e Jashar Demës në Kuvendin e qytetit të Dibrës, për hapjen e shkollave shqipe, më 22 mars 1902, si dhe ngritja në Homesh e Këshillit Shkollor Krahinor me kryetar Loke Demën dhe anëtar Uke Dema nga Homeshi, Selman Kurti nga Bçeva, Rahman Leka nga Kovashica, Hasan Çela nga Gjorica, në janar të vitit 1918 (AQSH, kutia 2, dosja 2. 1918, për krahinën e Homeshit. " Posta e Shqypnies", 9 fruer 1918, nr. 18, f. 4).

Si rrezultat i këtyre veprimtarive, më 1917, në shtëpinë e Sali Demës, u ulën në klasë të rregullt mësimi, nxënësit: Sefer Rama, Hidër Rama, Rifat Manjani, Osman Dema, Sulë Rama, Rakip Hoxha, Rrem Manjani, etj., me mësues Qemal Turkeshin (Drita).

Por hapja e shkollave shqipe, diktoi nevojën e mësuesve me përgatitje të mirfilltë pedagogjike.

Nuk vonoi dhe brezi i parë i mësuesëve me arsim të mirfilltë pedagogjik, nga Homeshi, qenë normalistët Hidër Rama dhe Hamit Manjani . Që nga viti 1934, prania e tyre në Homesh, dhe jo vetëm, bëri që mësimi i gjuhës shqipe, në veçanti, dhe i lëndëve tjera në përgjithësi, relativisht, të zhvilloheshin në baza shkencore pedagogjike.

Qe ndikimi i atij patriotizmi, që më 1948, sapo u hap e para shkollë pedagogjike në Dibër, vërshuan djemt e parë nga Homeshi, për t'u përgatitur si mësues profesionistë për shkollat e krahinës dhe më tej. Emrat e tyre do të shënonin brezin e dytë të mësuesëve nga Homeshi me arësim pedagogjik. Këta ishin: Skënder Sharku, Riza Manjani, Lutfi Manjani, Shemsi Manjani, Mendu Dema, Remzi Dema, Xhelal Manjani, Xhetan Manjani, Osman Turja (pedagogjike Tiranë),etj.

> Kjo trashëgimi e vyer patriotizmi, përkushtimi dhe dashurie për arsimim, nga këto djem e vajza, nga këto burra e gra të nderuara, duhet dhe do të jetë frymëzimim, për të mbajtur të ndezur dritën rezatuese për ngritjen sa më lart të nivelit arsimor nga vajzat dhe djemtë e Homeshit.

(Të shumtët prej tyre, ndërvite, u kualifikuan edhe me arësim të lartë peagogjik.)

Eshtë për t'u përmendur, kontributi nxitës dhe ndihmues i Rakip Hoxhës, për realizimin e ëndrave të këtyre djemëve të realizuar, shembullin e të cilëve do ta ndiqnin të tjerë të rinj.

Në vazhdimsi, qe edhe ndikimi i këtyre djemëve pedagogjikas që, një brez i tretë djemësh nga Homeshi, fatkeqësisht ende jo vajza, të dyndeshin në dyerët e pedagogjikes, si:

Latif Dema, Ahmet Tomja, Avni Dema, Mehdi Dema, Irfan Dema, Luan Dema, Fadil Manjani, Qemal Rusi, Naim Turja, Hamza Manjani, etj., shumica e të cilëve, në vazhdim, muarën kualifikim të lartë pedagogjik.

Nuk vonoi dhe shumë, që drejt shkollave pedagogjike, të niseshin edhe dallendyshet e para vajza si: Violeta Dema, Mirvete Jakimi, Flora Rusi, Sere Rusi, Servete Tomja, Resmie Tomja, Bukurie Turja, Idajete Manjani, Shqipe Manjani, Hajrie Turja, Aferdita Turja, Remzie Lleshi, etj.

Pedagogjikasit nga Homeshi, ndikuan në zgjimin e dëshirave tek shumë të rinj në zonë, për dëtyrën, sa të bukur dhe fisnike, aq dhe të vështirë, të mësuesisë.

Pati edhe nga ata, që nuk kishin kaluar nga dyerët e pedagogjikes, muarën kualifikim intensiv pedagogjik, si: Elez Jovani, Bajram Turja, Fisnik Manjani, etj.; apo mbas arsimit të mesëm të përgjithshëm, të kualifikoheshin në arësimin e lartë pedagogjik, si: Bajram Hoxha, Bardhul Manjani, Xhevat Jella, Vladimir Dema, etj.

Eshtë për t'u përmendur që, mësuesit nga Homeshi, në shumicë, dhanë kontribute me mjaft vlera në pjesmarrje për propogandimin e proceseve sociale dhe ndryshimet demokratike në vitet nëntëdhjetë, në përballje me fenomenet frenuese dogmatike.

Si brez i katërt i mësuesëve me arësim pedagogjik nga Homeshi, pas viteve nëntëdhjetë, do të renditja: Albina Dema, Adriatik Dema, Elida Beqiri, Ela Halili, Monika Veliu, Anila Dema, Alkida Dema, Irena Manjani, Monika Veliu, Klodiana Lurdhi, Silvana Manjani, Taulant Turja, Bekim Macuklli, Fatime Gjini, Arta Beqiri, Sarie Manjani, etj.(Në shumicë me kualifikim të lartë pedagogjik)

Numurin e mësuesëve me arësim pedagogjik, e shtojnë edhe mësueset pedagogjikase të ardhura të martuara në Homesh, si: Shyrete Sharku, Nevrez Manjani, Flutura Dema, Reme Hoxha, Dhilhixhe Jella, Lavdie Manjani, Hamdie Beqiri, Natasha Manjani, Dallëndyshe Dema, Zemrie Manjani, Bedrie Manjani, Donika Dema, etj.

Prirja e shumë djemve nga Homeshi, për të shërbyer në sistemin arsimor, ndikoi ndoshta në krijimin edhe të mjaft çifteve mesuesish si:

Shyret e Skënder Sharku, Nevrez e Shemsi Manjani, Reme e Bajram Hoxha, Flutura e Mehdi Dema, Lavdie e Bardhul Manjani, Dhilhixhe e Xhevat Jella, etj.

Tashma mësuesit pedagogjikas nga Homeshi, do të rezatonin në arsim, jo vetëm në Homesh dhe në fshatrat për rreth, jo vetëm edhe në shumë zona të Dibrës, por edhe jashtë saj, jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në drejtim, në pozicione të ndryshme të strukturave.

Harta e rezatimit të mësuesëve nga Homeshi ka përfshirë të katër anët e horizontit. Shtrirja e furnizimit me kuadro arsimorë, dhe jo vetëm, të dalë nga ky fshat, ngjan me atë valën e detit, rrathët bashkëqëndrorë të të cilës, ledhatojnë me freskinë e tyre, zonë pas zone, që nga fshatrat që e kufizojnë si: Shupenza, Boçeva, Okshatina e Kovashica, duke vazhduar më tej, Zogje, Gjuras, Luzni, Selishtë, Lurë, Maqellarë, Majtarë, Dovolan, Peshkopi, Dohoshisht, Gjoricë, Viçisht, Tuçep, Ostren, Klenjë, Borovë, Zabzun, Llangë, Okshtun, Fushë Bulqizë, Bulqizë, Tërnovë, Klos (Gur i Bardh), Tropojë, etj.

Mësuesit e Homeshit kontribuan mjaft mirë edhe në drejtim, jo vetëm në arësim, por edhe në të tjerë sektorë.

Si drejtues në arësim përmend: Hamit Manjani, Hidër Rama, Riza Manjani, Shemsi Manjani, Osman Turja, Mendu Dema, Xhelal Manjani, Bajram Hoxha, Avni Dema, Bardhul Manjani, Hamdie Beqiri, Vladimir Dema, Dhilhixhe Jella.

Drejtues në Këshillin Popullor të Zonës (sot Komuna), Xhevat Jella e Bardhul Manjani .

Drejtues në Zyrën e Punësimit për rrethin e Bulqizës dhe Kryetar i Këshillit Komunal, Latif Dema.

Drejtues në Sistemin Peridencial të Republikës dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Mehdi Dema.

Drejtuese Prefekte në Prefekturën e Dibrës, Hamdie Beqiri.

Drejtues në sektor tregëtie, Irfan Dema.

Drejtues Kryetar Komune, Vladimir Dema.

Por, duke folur për kontributin e madh që kanë dhënë djemtë dhe vajzat nga Homeshi, nuk largohet nga vëmendja edhe kontributi i shumë mësuesëve tjerë pa arsimim përkatës në plotësim të nevojave të kohës . Ndonse kisha për objek kontributin në arsim, tangent, s'dua të lë pa nënvizuar se kontributi i djemve dhe vajzave të Homeshit ka qenë me shumë vlera edhe në sektorët të tjerë të jetës.

Homeshi ka nxjerrë: 8 inxhinierë, 6 teknikë, 8 mjekë, 7 infermierë, 31 oficerë, 3 ekonomistë, 4 juristë, 8 agronomë e zooveterinerë, me kontribute të lavdërueshme për mbarë vendin.

Kjo trashëgimi e vyer patriotizmi, përkushtimi dhe dashurie për arsimim, në zonën tonë dhe më tej, nga këto djem e vajza, nga këto burra e gra të nderuara, duhet dhe do të jetë frymëzimim, për të mbajtur të ndezur dritën rezatuese për ngritjen sa më lart të nivelit arësimor nga vajzat dhe djemtë e Homeshit, dhe jo vetëm, në vazhdimsi me një frymë të re, reforma të reja, të mirëstudjuara, shkencore e demokratike.

arsim

Me rastin e 100 vjetorit të Shkollës së Parë shqipe në Peshkopi

Shkolla që hapi rrugët e mëdha të jetës

Nga **ABDURAHIM ASHIKU***

(Vijon numrin e kaluar)

Dimrit kur dëbora mbulonte gjithçka udhëtonim rrugës kryesore, tunelit të bardhë që formonin të rriturit mëngjeseve për në punë. Tepër i vështirë ka qenë dimri 1953-1954, dimër i cili mbahet mend si një ndër më të ashprit, me temperatura që zbritën deri në minus njëzet gradë, madje edhe me viktima.

Opingat e lopës nuk i mbanin çorapet e leshit të kullonin ujë kur hynim në klasë, ti shtrydhnim e ti venim poshtë sobës për të marrë pak avull për ti veshur përsëri në rrugën e kthimit. Shokët dhe shoqet e klasës, konviktorë, na lironin gjithnjë bankën afër sobës për tu ngrohur e për të tharë rrobat. Në çantën prej cope të zakonshme bezeje me një rry po bezeje që e varnim krah-qafë nëna më vente gjithnjë një palë çorape të thata leshi, çorape që i veshja gjatë orëve të mësimit.

Si nxënës na jepnin triska buke, ushqimi dhe veshmbathje, një ndihmë modeste për kapërcimin e vështirësive të kohës dhe lehtësimin e prindërve sidomos me triskat e veshmbathjes ku opingat e lopës do ti zëvendësonim me opinga llastiku. Këpucët ishin ende një mollë e papjekur.

Asokohe Peshkopia kish nis të merrte pamjen e një qyteti të kohës. Katër ndërtesave me themele që në kohën e pushtimit italian e të ngritura në dy kate në vitin 1946 do tu shtoheshin kinemaja me 400 vende (1946), shkolla pedagogjike (1946), shkolla unike (1949), spitali civil me 100 shtretër (1953), MAPO industriale (1954), hotel e rosticeri me 30 vende (1954), bulevardi kryesor (1955)... (Shemsi Hoxha: Vjetar Statistikor i rrethit të dibrës 1966)

Peshkopia në vitet që vazhdova shkollën shtatëvjeçare ishte kthyer në një kantier të vërtetë ndërtimi. Në ato vite mori formë të plotë bulevardi kryesor, një ndër bulevardet më të gjerë dhe të bukur në vend. E mbaj mend bulevardin në ndërtim, fillimisht gati i pakalueshëm nga balta e më pas i shtruar me kalldrëm. Në hyrje nga ana e perëndimit ka qenë një monument me një yll, monument i cili u prish për ti lënë hapësirë bulevardit. Nga e majta poshtë themeleve të godinës së bankës dhe hotel Korabit mbi dy shina të improvizuara rrëshqiste një vagon që lëvizte dherat. Një skarpat dheu po i jepte formë gjelbërimit dhe luleve që janë thuajse të paprekura edhe sot para këtyre dy ndërtesave.

Mes këtij mjedisi ndërtues ishte një çezmë, thjesht një tub i zgjatur që rridhte vazhdimisht. Peshkopia në atë kohë merrte nga një ujësjellës nga Staraveci, gjurmët e të cilit i gjen edhe sot. E kujtoj çezmën sepse dimrit të ashpër të kalim viteve 1953-1954 më ndodhi që duke pirë ujë të më lagej xhaketa . I ftohti ishte kaq i madh



sa currili i ujit u kthye në një hell akulli çka kur hyra në klasë u bëra objekt humori.

E doja shumë letërsinë ndaj orët më të bukura të jetës sime në shkollë ishin kur hynte në klasë mësuesi Ilir Ramizi. Një njeri serioz, i përkushtuar në punë, gojëmbël, zotërues i përkryer i lëndës, Ilir Ramizi mbeti në tërë jetën time shembull.

Në përfundim të klasës së pestë, si nxënës i shkëlqyer në mësime, mora dhuratën e parë në jetën shkollore, një libër. Nuk mund ta harroj emrin e librit: "Tregim për sendet që ke rreth teje". Libri më hapi horizonte, ishte një enciklopedi e bukur për të njohur botën.

Edhe në matematikë isha i shkëlqyer. Kujtoj me mall garën e heshtur me Islam Sefullain dhe Kadri Zhulalin se kush do ta mbarojë provimin më parë. Kadriu u bë një personalitet i lartë i matematikës, pedagog në Universitet. Islami nuk mundi ta vazhdojë shkollën e mesme i rregullt, e mbaroi vite më vonë në sistemin e shkollës së natës. Në SMT ku punonte ishte ndër mjeshtrit më të mirë. Njihte si askush tjetër makinat shirëse të grurit dhe autokombajnat.

Nga shokët e mi të klasës dua të veçoj Pëllumb dhe Fehmi Hoxhën. Ata udhëtonin më këmbë nga Muhurri në Peshkopi dhe ishin ndër nxënësit më të mirë të klasës. Dibra në atë kohë kishte vetëm dy shkolla shtatëvjeçare, një në Peshkopi dhe një në Shupenzë, të dyja me konvikt.

Shyqyri Zebi ishte nga shokët më të mirë të mi. Ai ishte nga Ushtelenca dhe të shumtën e kohës e bënim rrugën bashkë. Në mëngjes takoheshim atje ku ndan rruga e ku ndajnë ujërat e ujitjes të Ushtelencës dhe Kallçishtit pak poshtë Rashnapojës. Po aty ndaheshim kur ktheheshim nga shkolla. Veçanrisht vjeshtës së vonë, dimrit dhe pranverës së herëshme, kur jonxhishtet humbnin gjelbrimin, nuk ndaheshim pa luajt "top" në fillim me top lecke e më në fund me një top llastiku të marrë me shtyrje të forta në dyqanin e Haxhi Gjapit.

Basri Muskurti ishte një tjetër shok imi që vinte nga Dohoshishti, shok me të cilin e vazhduam miqësinë edhe në vitet e studimeve të larta, edhe në jetë. Ndodhi që u martuam në të njejtën ditë, më 11 gusht 1968, madje edhe "muajin e mjaltit" e bëmë së bashku në Pogradec më 16-30 gusht 1968.

Jonus Mediu vinte nga Greva. Do të mbaronim së bashku dy klasë të shtatvjeçares për të vazhduar nga gushti i vitit 1954 Shkollën Ushtarake Skënderbeg. Ai do të vazhdonte studimet në Bashkimin Sovjetik. Fati do ta sillte që të kalonim disa vite së bashku, unë student i bujqësisë kurse ai i inxhinierisë mekanike për tu ndarë gjeografikisht më pas unë në Peshkopi e ai në Oriukum të Vlorës, inxhinier në nëndetse. Miqësinë e pjekur në shkollën shtatvjeçare të Peshkopisë nuk e humba me të asnjëherë. Udhëtuam kur binte raste tek njeri tjetri dhe udhëtojmë edhe sot e kësaj dite.

Shefqet Kaba dhe Nazmi Çorja do të vijonin shoqërinë tonë të krijuar në shtatvjeçaren e Peshkopisë në fillim në Shkollën Ushtarake Skënderbeg e më tej në Teknikumin Bujqësor Fier.

Shefqeti do të më linte vetëm në Institutin e Lartë Shtetror të Bujqësisë kur një ditë shtatori 1961 do të mbetej bosh vendi në tavolinën e auditorit 41. E kam të fiksuar Shefqetin nga dritarja e auditorit mbi një makinë të vogël të hapur policie tek do ta çonin në Lushnjë së bashku me familjen e tij për shkak të vëllait që kishte kaluar kufirin...

Me Nazmiun do të mbaronim Institutin për të vijuar punën si specialistë bujqësie në Dibër...

Tash, në të shtatëdhjetë e treta të jetës sime më vijnë e më ulen në kujtesë me një respekt të veçantë vajzat e klasës sime, të të pestës e të gjashtës A dhe B. Tefta Cami, Sanije Berisha, Sanije Zeneli, Kumrie Lahi, Hide Beqiri, Farie Oshafi...

Pesë prej tyre i pashë të hidhnin vallen "Oj Sanie, oj motëro/Hidhe vallen rrotullo". Ato ishin pesë vajzat e para që i dhanë dritë rrugës së vajzës dibrane për të vazhduar shkollën, ishin pesë mësueset e para që dolën nga Shkolla Pedagogjike e Peshkopi. Të pesta ia kushtuan tërë jetën e tyre mësimit të fëmijëve duke u shndrruar në yje të arsimit në shkollën shtatvjeçare të Peshkopis ku kishin qenë nxënëse. Njera prej tyre, Tefta Cami, do të ngjitej deri në detyrën e kryemësueses së Shqipërisë,



Asokohe Peshkopia kish nis të merrte pamjen e një qyteti të kohës. Katër ndërtesave me themele që në kohën e pushtimit italian e të ngritura në dy kate në vitin 1946 do tu shtoheshin kinemaja me 400 vende (1946), shkolla pedagogjike (1946), shkolla unike (1949), spitali civil me 100 shtretër (1953), MAPO industriale (1954), hotel e rosticeri me 30 vende (1954), bulevardi kryesor (1955)...

Ministre e Arsimit dhe Kulturës...

Disa fotografi, njëra prej të cilave të gjitha bashkë, i gjeta një ditë në arkivin e ATSH, tashmë nxënëse në Shkollën Pedagogjike.

Në kujtesë më vijnë me ndjenjën e dashurisë dhe respektit mësuesit e mi: Ilir Ramizi, Selaudin Trepça, Diamanda Doda...

Nga bashkënxënësit e mi nuk mund të largoj nga kujtimet Luf Shehun. Lufi kishte një dhunti të lindur për makinat, të pakta në atë kohë por të shumëta në dashurinë e tij për këto mjete që do t'ia mbushnin tërë jetën.

Lufi u vidhej herë pas here mësimeve. Ikte dhe gjithnjë do ta gjeje tek ura e përroit të Peshkopisë të lzer e ngjzer kokë e këmbë me lubrifikantë,

Në krah të majtë të urës, pas sheshit të madh të pazarit rrethuar nga të gjitha anët me dyqane, ishte një shesh me një barakë (po e përcjell me një fotografi) e cila ishte do vite dyqan buke, dyqan që më vonë do ta zbrisnin në fund të pazarit, ngjitur me dyqanin fotografik. Në atë shesh thuajse gjithnjë do të gjeje ndonjë makinë "Zis" ku shoferët bënin shërbimet dhe riparimet. Lufin do ta gjeje gjithnjë ose poshtë makinës duke u marrë me zbarat e drejtimit, me frenat apo me zbrazjen e vajit a të valvolinës, ose në fryrjen e gomave dhe procese të tjera të riparimeve. Ai vend për Luf Shehun ishte klasa, ishte shkolla e jetës së tij, shkollë që do ta bënte atë jo shoferin por mekanikun më të mirë të të gjitha markave të kamjonave në Dibër.

Lufi në Parkun e Mallërave të Peshkopisë asnjëherë nuk pranoi të merrte "Skodë" të re. Pasioni i tij ishte të merrte një "skodë me rimorkio" thuajse të dalë jashtëpërdorimit dhe ta bënte të "re". Luf Shehu udhëtonte gjithnjë me "skodën" e tij me rimorkio kurdoherë me shpejtësi sipas normave. Shoferët kur udhëtonin rrugëve të vështira të kromit thoshin "Pas meje më vjen karrofiçina e Luf Shehut". Ai ishte shndërruar në një "karrofiçinë" për të gjithë shoferët që mbeteshin në rrugë për ndonjë defekt.

Luf Shehu nuk e kishte qejf mësimin në klasë, kishte qejf mësimin në natyrë, mësim që e bëri atë inxhinier pa diplomë në fushën e mekanikës...

Vite më vonë, shkolla tashmë 8-vjeçare e Peshkopisë me emrin e përveëm "Demir Gashi" do të më bëhej më e dashur. Atje do të fillonin e mbaronin shkollën fëmijët e mi; Altini, Erblina dhe Indriti. Atje, deri në vjeshtë 1996 do të jepte mësim në klasën-ushtrimore të Shkollës së Mesme Pedagogjike, bashkëshortja ime Natasha Ashiku.

Si gazetar i ATSH pata privilegjin që në qershor 1974 të bëja kronikën me rastin e 60 vjetorin të Ditës së Parë të Mësimit Shqip në një mjedis të ngushtë pranë teqesë së Peshkopisë. Kronikës i kisha vënë titullin "Mbresa brezash", kronikë të cilën jo vetëm për nostalgjinë e atij momenti të bukur por edhe si një fakt historik po e përprcjell në vijim të këtyre kujtimeve modeste...

Athinë, 17 shkurt 2014

** Gazetar, ish nxënës i Shkollës Shtatëvjeçare të Peshkopisë në vitet 1952-1954*

Rruga e Arbërit nr. 95

Ibrahim Gjorgji ka lindur në Radomirë, lagjia Stërdok, në vitin 1880 në një familje fisnike dhe atdhedashëse, rrëzë mali të Korabit. Ka mbaruar shkollën e mesme, medrese, në Shkup.

Ibrahim Gjorgji - gjeneral i fitores

Nga **METUSH SKEJA**

"Ibrahim Gjorgji fjutroi si zog,
Luftën nuk e lamë për nesër,
Do ta fillojnë sot. "

Ibrahim Gjorgji ka lindur në Radomirë, lagjia Stërdok, në vitin 1880 në një familje fisnike dhe atdhedashëse, rrëzë mali të Korabit. Ka mbaruar shkollën e mesme, medrese, në Shkup. Edukohet me ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizerenit. E donte atdheun e vet.

Ai ka pasur jetë të lumtur për aq sa jetoi dhe fund heroik. Akti i fundit i jetës tij është më i kujtueshëm se pjesa tjetër e jetës. Ky akt i jep kujtesë e nderim atij . Vendlindja ndikoi në formimin e karakterit të tij. Ka lindur e rritur në një vend me pyje të gjelbërta halorë e kullota të shumta alpine, të mbushura me lule të ndezura shumëngjyrëshe në verë, me liqene të kthjellta karstik, me burime të shumta ujë nga ku rrjedh vrullshëm Veleshica . Treva veçohet për këngët e shumta burimore. Dimri e mbulon me bardhësinë e dëborës.

Më 17 tetor 1912 Serbia nisen dy formacione ushtarake pushtuese në drejtim të tokave shqiptare, Shumadia-1në drejtimin Prizren, Lumë , Adriatik dhe Morava në drejtim të Vardarit e Dibrës. Perandoria osmane ishte në ikje, vendin e saj kërkonte ta zinte një pushtues i ri, Serbia. " Në fillim të nëntorit komanda e lartë e ushtrisë serbe u dha urdhër njësive të Armatës Tretë që të dilnin në Detin Adriatik. "(Ilir Ikonomi, Pavarësia, faqe102)Nga hoteli i tij në Vjenë Ismaili e ndiqte me kujdes zhurmën serbe për Adriatikun" (Ilir Ikonomi Pavarsia , f. 104) Motivi i saj ishte nacionalizmi ekspansionist. Shqipëria të ishte përsëri nën zgjedhë. Plani shovinist ishte hartuar kohë më parë, fill pas revolucionit nacional serb të vitit 1804. Koha e nxori nga sirtarët. Agresioni ushtarak ishte parapërgatitur nga ekspansione të tjera. Serbia kërkonte të dilte në Durrës, përpara se të vinte Ismail Qemali nga Viena. Ethet mesjetare të "Naçertanjes"kundër trojeve e popullit shqiptar ishin në veprim. Ilir Ikonomi thotë se ushtria serbe ka pasur pesëmbëdhjetë mijë ushtarë në drejtimin Prizeren -Durrës.

Fati i shqiptarëve e Lumës ishte në kufijtë e mbijetesës. Kosova bëri rezistencë të madhe. Ismail Qemali më 28 Nëntor 1912 do të ngrinte flamurin në Vlorë. Luma kontribuoi në këtë ngjarje historike duke e ndaluar e gjymtuar përkohësisht ushtrinë serbe të dilte në Durrës duke i dhënë mundësi gjeniut të pavarësisë, Ismail Beut, të zbriste në Durrës e të udhëtonte drejt Vlorës. Serbia kërkonte ta nënshtronte Lumënpër tu nisur drejt detit , por kjo e fundit, Luma, kishte marrë një vendim kategorik. "Forcat e ushtrisë rregullt serbe Shumadia-1 do të zbrapsen me çdo çmim"-kjo ishte ndërgjegjja e vendosur lumjane. Ky ishte momenti i ekzistencës ose jo të shqiptarëve në Luftën e Parë Ballkanike.

Gjithë veriu organizohet për luftë. Beteja më e madhe është ajo që quhet Beteja e Drinit ose e Qafë Kolesjanit. Beteja është frontale. E rrallë kjo në historinë e luftërave shqiptare. Lajmin se Serbia kishte sulmuar Kosovën e Lumën e dinte gjithkush. Dihej numri i ushtarëve dhe armët që kishte ushtria serbe. Lajmin në Kala të Dodës, për datën e sakët se kur me u gjet në Qafë të Kolejsjanit e ka sjellë Tafë Boletini e Halim Spahia.

Organizimin për luftë të Kalasë Dodës e Radomirës e ka bërë Ibrahim Gjorgji. Janë bërë disa tubime nëpër fshatra. Mobilizimi ka qenë burrë për shtëpi. Kush ishte djalë i vetëm nuk do të shkonte në luftë. Ditën e betejës, herët në mëngjes, Ibrahimi hipur mbi kalë të bardhë , të kujton kuajt e baladave, del në Kutellë. Qëllon me pushkë. Ky ka qenë sinjali i nisjes. Kanë qenë mbi 300 luftëtar nën komandën e Ibrahimit. Duke shkuar drejt luftës Ibrahimi shkonte drejt lavdisë përjetshme pa e kërkuar. Rrugën e kanë përshkruar për gjashtë orë hipur mbi kuaj. Kanë arritur në Qafë të Kolejsianit me katër orë ditë. Koha ka qenë e mirë. Natën ka filluar shi i rrëmbyeshëm.

Beteja është zhvilluar me 15-18 nëntor 1912. Organizatorët e betejës janë figura të mëdha, me përvojë si Ramadan Zaskoci, Islam Spahia, Ibrahim Gjorgji, Hoxhë Mehmeti etj. Në fund të betejës gjenerali famëkeq serb Bozhida Jankoviç ka lënë me mijëra të vrarë në fushë të betejës. Disa thonë 12 mijë ushtarë serb të vrarë. Ky numër është ndoshta i përafërt , por i padiskutueshëm është se janë me mijëra. Për këtë betejë kanë shkruar shumë historianë të nderuar. Unë do të ndalem vetëm, një personalitet të kësaj ngjarjeje historike.

Çdo betejë nxjerr heronjtë e vet. Në Qafë të Kolejsianit ngrihet një tribun i panjohur më parë. Ky është Ibrahim Gjorgji i Kalasë Dodës e i Lumës , me mendje gjenerali e zemër heroi, idealist i çështjes tonë kombëtare. Dhe si çdo idealist frymëzoi e mobilizoi Kalanë e Lumën rreth idealit të vet. Ai krahasohet me malin e Korabit ku ka lindur. Qëndron përkrah Ramadan Zaskocit e Islam Spahisë. Prijësit e luftës megjithë përvojën e pasur kanë momente dyzimi për çastin e nisjes betejës. Ibrahimi nuk e pati. Në fshatin tim të bukur Ceren, te burrat e nderuar të Teqesë së Murat Dedës, në vitet 50-të të shekullit kaluar, ka ardhur disa herë për mik, Dullë Brahimi nga Kolshi i Kukësit. Dullë Brahimi ka qenë shoku, bashkë luftëtari e mbrojtësi i Zaskocit. Ai ka pohuar se Ramadan Zaskoci kur ka parë Ibrahim Gjorgjin duke i pri Kalasë në drejtim të Qafës Kolejsianit u ka thënë shokëve të tij: "Ndalojeni po të doni luftën sot" . Armiku kishte ardhur te Përroi i Shejës poshtë Bicajt, në Kolësh... dhe do të nisej drejt Durrësit pas shuarjes së çdo rezistence. Koha ikte me shpejtësinë e dritës. Çdo vonesë a shtyrje kishte kosto të pallogaritshme. Serbët ecnin me politikën e faktit të kryer.

Ka një perceptim befasues të marrëdhënieve shumëplanshe të agresorit e të vendasve nga Ibrahimi. Ai përqendron gjithë elementët njohës për ta zgjidhur situatën në kohë sa më të shkurtuar , llogaritje të mirë forcash, analizë të hollësishme të fuqisë. I rezultoi se lufta duhet nisur në çast. Ky është moment i ndritur i jetë tij. Psikologët e quajnë këtë zgjidhje të shpejtë insajt. Fitorja ekzistonte, ishte në zemrat e shqiptarëve , vetëm se duhej të riralizohej. Për këtë themi se kemi fitore ekzistenciale.

Ibrahimi tubon shokët e tij . Me kurajo e zë të metaltë ka thënë:"Unë kam ardhë me luftue. Luftën do ta fillojmë sot (në këtë çast M. S.). Çka me u ba nesër të bahet sot. Të nesërmes nuk i dihet. Kush do të shpëtoj , është gazi, ngadhënjimtar. Kush do të vritet është shehit , dëshmor. "Nuk kishte alternativa të tjera. Ai niset vetë i pari , i ndjekur nga luftëtarët e tij. Zbret nga Qafa e Kolejsianit në drejtim të Bicajve në të djathtë të rrugës këmbësore. Jep sinjalin e kundërmësymjes lumjane. Qëllon me pushkë në drejtim të armikut. Ky ka qenë edhe sinjali i parë për tu ndezur beteja. Kaq është dashur për të shpërthyer uragani lumjan mbi ushtrinë serbe. Armiku e vrojtoi mirë se ku nisi pushka e parë dhe aty lëshoi predhat e të gjithë llojeve të armëve. "Ibrahimi është dëshmori i parë i betejës " (Shaban Braha , Beteja e Drinit f. 120). Plagoset shoku tij i afërm Mustafa Baloshi nga Radomira. Varrin e ka mbi Bicaj, tek vendi ku mori plagët fatale. Fati deshi që ai të ngeli dëshmor, shehit, i Atdheut Shokët e tij u kthyen ngadhnjimtarë në Radomirë . Ne sot kujtojmë Ibrahimin, dëshmorin, dhe jo ngadhnjimtarët emer për emri.

Ibrahim Gjorgji është gjeneral i fitores. Falë tij, lufta nisi në çastin e duhur, falë Lumës përfundoi me fitore. Historia na mëson se shumë beteja janë humbur nga njëra palë për shkak të hezitimit të gjeneralëve për të sulmuar. Kjo nuk ndodhi më Ibrahimin. Duke shkruar këto rreshta për momentin e nisjes luftës nga Ibrahimi , më vijnë në kujtesë fjalët e filozofit Ralf Ualdo Emerson sesi individi e pakicat ndikojnë mbi shumicat në rrjedhjen e ngjarjeve historike. " E gjithë historia- shkruan ai – është një arkiv i fuqisë së pakicave dhe i pakicave të përbëra nga një individ".

A ishte i ndërgjegjshëm Ibrahimi për ngjarjet që po zhvilloheshin në Shqipëri nëntor 1912? Unë them po. Ka qenë i ndërgjegjshëm. . Do të përmend vetëm një fakt . Gjatë udhëtimit nga Kosova për në Vlorë Isa Boletini ka kaluar e ka qëndruar mik një natë në Kala të Dodës me 200 kosovarë. Këtë na e thotë Tafë Boletini në kujtimet e tij. Isa Boletini dinte shumë gjëra. Ibrahim Gjorgji është takuar me Legjendën kosovare . Se çfarë kanë biseduar nuk kemi të dhëna. Dimë se Ibrahimi sulmoi i pari kolonat serbe , që kërkonin të dilnin në Adriatik.

Ibrahim Gjorgji ka qenë kapiten i vatit vet, jo viktimë e rrethanave. Ai ka besuar se e kishte në dorë fatin. Bëhet subjekt i ngjarjes madhe me përmasa kombëtare. Vepra e tij ka qenë një garanci më shumë për të vonuar daljen në Durrës të forcave serbe në mënyrë që Arkitekti i pavarësisë shqiptare, Ismail Beu, të udhëtonte drejt Vlorës. Kjo është më e rëndësishme se numri i ushtave serb të vrarë në betejën e Lumes. Kjo i jep Ibrahim Gjorgjit përmasa kombëtare. Falë kësaj beteje pavarësia kombëtare u shpall në 54 mijë kilometra katrorë. Falë kësaj beteje kufiri Shqipëri- Serbi u vendos ku u vendos;ndryshe do të ishte vendosur përgjatë lumit Drin apo lumit Mat. Një popull që nuk i del për zot vendit të tij është i destinuar të zhduket.

Ibrahimi ndoqi i qetë ndërgjegjen e vet. Pranonte veten e ngjarjet siç ishin. Nuk kishte shkuar në luftë për të plotësuar parashikimet e të tjerëve, por besonte se ishte në këtë botë për të plotësuar parashikimet e veta. . Rezultati që solli ka qenë pasojë e veprimit të tij individual dhe zgjidhjes vetjake patriotike. Këtu kemi një fillim absolut. Është çasti i papërsëritshëm i jetës tij. Vendimi tij i lirë, për të nisë atë ditë luftën, për të sulmuar i pari, e bën të pranishëm, duke i dhënë ekzistencë qenies tij në atë ngjarje historike të Lumës. Merr mbi vete pasojat e vendimit vet. Në këtë veprim ne gjejmë vlerat e individit e të subjektivitetit individual. Në vargjet e përmendura në fillim, tek togfjalëshi "fjuturoi si zog", veprimi i heroit ka të bëj me vertikalitetin, krahasohet me shpendin që shkëputet nga toka e ngjitet lart, në çast.

Me jetën e tij , Ibrahim Gjorgji është kujtesë e ardhmëri për brezat që erdhën e që do të vijnë më pas. Shumë veta do të më thonë mua sot, se akoma u merrka me heronj. Po do të shkruaj për heronjët tonë. "Nderimi më i shtrejtë që mund të ketë një popull për vetveten: nderimi për dëshmorët e rënë për lirinë dhe pavarësinë e tij"(Rexhep Qosja, Shqipëria e Kosova, f, 403)Është e vërtetë se ne sot jetojmë në epokën e globalizmit e të postmodernizmit. Po kaq e vertetë është se nuk kanë kaluar as pesëmbëdhjetë vjet nga Lufta e Kosovës. U desh ndërhyrja ushtarake –humanitare e NATO-s për të ndalë masakrën serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës në vitin 1999 vetëm se ishin të një etnie tjetër me serbët.

Në 100-vjetorin e shtetit shqiptar e 100-vjetorin e rënies së Ibrahim Gjorgjit , ne përulemi para veprës së tij. Është personaliteti më i madh atdhetar e historik që ka nxjerrë Kalaja e Dodës në kufijtë e saj gjeografik. Vetë beteja ku Ibrahimi ishte organizator, drejtues e dëshmor i parë, është e përmasave të legjendës. Figurë e padiskutueshme nga askush dhe e padyzuar. Shumë kohë ka kaluar e do të kalojë, por vepra atdhetare dhe personaliteti historik i Ibrahim Gjorgjit nuk do të shlyhen nga koha. Jetën e vuri në shërbim të Atdheut. Vepra e tij trimërore nderon kombin shqiptar brenda e jashtë vendit. Amaneti i tij jehon nëpër vite: "Duajeni këtë vend".

Ibrahim Gjorgji është personaliteti më i madh atdhetar e historik që ka nxjerrë Kalaja e Dodës në kufijtë e saj gjeografik. Vetë beteja ku Ibrahimi ishte organizator, drejtues e dëshmor i parë, është e përmasave të legjendës. Figurë e padiskutueshme nga askush dhe e padyzuar. Shumë kohë ka kaluar e do të kalojë, por vepra atdhetare dhe personaliteti historik i Ibrahim Gjorgjit nuk do të shlyhen nga koha. Jetën e vuri në shërbim të Atdheut. Vepra e tij trimërore nderon kombin shqiptar brenda e jashtë vendit. Amaneti i tij jehon nëpër vite: "Duajeni këtë vend".

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

portret

Për kontributin dhe ndihmesën që ka dhënë është nderuar me dëshmi "Mirënjohja e Kombit", dekoruar me medaljen e Punës dhe "Naim Frashëri". Gjithashtu Fushë-Bulqiza e ka shpallur "Qytetar Nderi".

Lutfi Hanku, pedagogu, shkrimtari dhe studiuesi

Nga **FAIK XHANI**

I mbajtur, i pastër, trupdrejt, ballgjerë, sygjelbër, flokë të krehura lart mbi ball si re pulbardhë që mbajnë peshën e viteve, i qetë, me memorie të saktë, me buzqeshje të ëmbël, shumë i vëmndshëm në bisedë, me arsyetim e llogjikë të fortë, i thjeshtë dhe shumë i këndshëm në biseda e trapeze.

Ka mbi dy dekada që ka dalë në pension, por është shumë i zënë me punë. Kush nuk e kërkon? Kush nuk ia lyp ndihmën e kualifkuar? Shumë kush i beson produktet e krijimtarisë për t'i redaktuar e për t'i bërë sa më të plotë, sa më tërheqës e me vlerat e duhura letraro-artistike. Dhe ai gjindet ngushtë. Askujtë s'don t'ia prish! Edhe vetë nuk mund të shkëputet nga profesioni i tij me të cilin thuajse u rrit dhe u mplak, si studiues e krijues.

Quhet Lutfi Hanku. Ka lindur në një familje të spikatur patriotike të fshatit Zerqan të Dibrës, më 4 prill 1933. Që kur ishte 2 vjeç i vdes i jati, Sbriu. Mbeti jetim me nënën, Nazifenë, bijën e Zenel Allushit, njeriut finik , i cili për disa kohë shërbeu edhe si kryeplak, mandej edhe në periudhën e fushatave pushtuese serbe. Për mirërritjen e tij veç nënës Nazife, u kujdesua xhaxhai, Riza Hanku, babai i Rrahman Hankut dhe kushëriri i tij nga nëna, Riza Novaku.

Dera e kullës Hanku mbahej hapur. Në odën e burrave mblidheshin miqtë nga të gjithë anët e vendit, mandej edhe nga trojet etnike. Si ushtarët në njësh kollonë vareshin armët e biseda ndizej me prushin e atdhetarizmëz, me trimëritë e bëmat e njerëzve të ndritur të kombit.

E ndërsa burrat e moçëm dhe personalitete të kohës bisedonin, veshi dhe syri i Lutfiut të vogël bëhej katër dhe thithte gjithçka me etje. Zemra e tij gëzonte e lumturohej nga ata që dëgjonte. Krenaria e tij bëhej mal kur dëgjonte për patriotët e vërtetë, rilindasit e mëdhenj dhe luftëtarët e lirisë. Fjala e Baba Fajos, Mustafa Xhanit që shpesh vinte në konakun Hanku u bë pjesë e qenies dhe mëvetësisë së tij. Ky mjedis burrash të mençur e atdhetarë ku midis tyre shkëlqenin Sheh Zerqani, Baba Fejz Bulqiza, Baba Faja Martaneshi, Haxhi Lleshi etj. u bë kudhra e formimit adhetar të djalit të vogël të kësaj shtëpie. Fjalët e tyre ia bënë zemrën mal dhe guximin vargmal. Ai që në moshën 13 vjeç u lidh me Luftën Nacionalçlirimtare duke dhënë kontributin e tij si pionier. Lutfiu kreu më së miri detyrën e korierit partizan me Baba Fajen dhe për zonën Dibër-Grykë e Madhe-Bulqizë.

Me zell të veçantë nisi studimet në Normalen e Elbasanit me ndihmën e Baba Fajes, Uniken dhe shkollën e mesme pedagogjike Peshkopi e Shkodër me ndihmën e ish-Ministrit të Arsimit të asaj kohe, Bedri Spahiut.

Nga viti 1952-1956 punoi si mësues në shkollën e Bulqizës, Kastriotit e Zerqan dhe si inspektor arsimi. Me shumë sakrificë dhe me rezultate shumë të mira, në vitin 1960 mbaroi Universitetin Shtetror të Tiranës në Fakultetin Histori-filologji dhe më vonë kursin pasuniversitar. Kur kujton atë kohë ndjen një brengë dhe një peng që nuk i hiqen kurrë. Përcjell me shumë dhimbje faktin që ndonëse u përzgjodh nga Universiteti i Tiranës dhe personalisht nga Prof. Zihni Sako, për të shërbyer si pedagog, nuk u la i lirë për arsye biografike.

Jo dhe jo, qe përgjigja e rrethin Dibër. Mbi të rëndoi pesha e Luftës së Klasave. Ai qe martuar me të bijën e Zenel Shehut, prandaj nuk e pat aspak të lehtë të çante në jetë. Drejtues të Degës së Brëndëshme të Dibrës shpesh herë e vunë në shenjestër. Njeri prej tyre i kërkoi që ta ndante bashkëshorten e tij shumë të ndershme, punëtore e fisnike, Havzie Shehun.

E kur thoni ju? Në momentin kur çiftit Hanku i buzëqeshi fati, u bë me një pasardhëse, pas 16 vitesh martese. Ai nuk e ndau, mandej kaluan një jetë të tërë me mirëkuptim e harmoni, derisa Havzia vdiq, ndjestë pastë!

Edhe pse me librezën e veteranit, edhe pse rridhte nga një familje që i dha shumë luftës për çlirimin e atdheut, sa e sa herë pati situata provokuese, përndjekëse dhe ndëshkuese. U përjashtua nga partia, iu heq e drejta e botimit të librave për disa vite, nuk u ngrit në poste drejtuese, u dërgua për të punuar edhe në fshatra të largët etj., por Lutfi Hanku nuk u thye. Vazhdoi i qetë, me ndërgjegje të lartë dhe përkushtim punën e tij prej një pedagogu shembullor. Ai e përjetoi si zhgënjimin më të madh të jetës së tij trasferimin nga shkolla Pedagogjike, ku pati lënë mundin dhe djersën më të madhe të tij.

Asnjëherë nuk tha jo! Asnjëherë nuk i qau puna! Atje, ku ishin vështirësitë më të mëdha u dërgua për të punuar, si e si, që t'i gjenin një cent dëshprimi e pakënaqësie, por Lutfi Hanku nuk u dha, nuk e humbi toruan, përkundrazi u bë më i vëmëndshëm, më i obliguar e i përkushtuar duke sfiduar gjithë skenarët ugurzes e duke rrezatuar kulturë, profesionalizëm, mjeshtëri mësimdhënie, përgjegjësi të lartë, ndershmëri e devotshmëri prej intelektuali e atdhetari të vërtetë.

Në veçanti Lutfi Hanku ka lënë gjurmë të pashlyera dhe ka bërë emër si studiues serioz dhe si shkrimtar. Ai prej vitit 1975 është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Ka drejtuar rrethet letrare të shkollave, bibliotekat dhe aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike. Është vlerësuar në konkurimet kombëtare për drama, ansamble artistike dhe estrada me medalje nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.

Ka botuar qindra artikuj, reportazhe, skica letrare, tregime, tre skenare për telefilma për heronjtë e popullit të Dibrës, afro 100 monografi të shkurtëra, bashkëautor në 4 vëllime historiko-letrar, kreu edhe detyrën e drejtorit të gazetës "Dibra" për cakohë. Në vitin 1974 botoi librin "Nëpër gjurmët e heroit", në vitin 1980 "Nazmi Rushiti", në vitin 2000 librin "Kaçaku", në 2002 "Drita e shpirtit", në 2006 romanin "Erdhi Caushi", në 2009 "Marsi i Vrarë", dhe në vitin 2012 romanin "Loti Rebel"

Në veçanti Lutfi Hanku ka lënë gjurmë të pashlyera dhe ka bërë emër si studiues serioz dhe si shkrimtar. Ai prej vitit 1975 është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Ka drejtuar rrethet letrare të shkollave, bibliotekat dhe aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike. Është vlerësuar në konkurimet kombëtare për drama, ansamble artistike dhe estrada me medalje nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.

Ka botuar qindra artikuj, reportazhe, skica letrare, tregime, tre skenare për telefilma për heronjtë e popullit të Dibrës, afro 100 monografi të shkurtëra, bashkëautor në 4 vëllime historiko-letrar, kreu edhe detyrën e drejtorit të gazetës "Dibra" për cakohë. Në vitin 1974 botoi librin "Nëpër gjurmët e heroit", në vitin 1980 "Nazmi Rushiti", në vitin 2000 librin "Kaçaku", në 2002 "Drita e shpirtit", në 2006 romanin "Erdhi Caushi", në 2009 "Marsi i Vrarë", dhe në vitin 2012 romanin "Loti Rebel"

Për kontributin dhe ndihmesën që ka dhënë është nderuar me dëshmi "Mirënjohja e Kombit", dekoruar me medaljen e Punës dhe "Naim Frashëri". Gjithashtu Fushë-Bulqiza e ka shpallur "Qytetar Nderi".



Lufi Hanku

Lufi Hanku është Anëtar Nderi i Shoqatës "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë", i cili vazhdon të kontribuojë për pensionistët e Shqipërisë dhe forcimin e modernizimin e kësaj shoqate.

Profesor, kështu e thërrasin të gjithë ata që e njohin e në veçanti një plejadë e tërë mësuesish që ka përgatitur. Ai më 4 prill mbushi 80 vjetorin e lindjes. Penda e tij nuk resht së punuari. Ajo pendë peshon më rëndë se mali i Korabit e të Kërçinit dhe shëndrit si rubini më i mirë.

Mbetshi deri në frymën e fundit me shëndet të plotë, medjemprehtë dhe pendëhollë, i nderuari Lutfi Hanku!

Urim

Me rastin e 81 vjetorit të lindjes së mësuesit dhe shkrimtarit Lutfi Hanku dhe 58 vjetorit të lindjes së poetit Ilmi Dervishi, redaksia e gazetës dhe stafi i Botimeve M&B u uron dy miqve dhe bashkëpunëtorëve të saj jetë të gjatë, lumturi dhe krijimtari!







Botime nga ***Lutfi Hanku***

BOTIMET M & B

Ju ftojnë të na vizitoni në Festivalin e librit dhe i artit, që do të zhvillohet në Muzeun Kombëtar në Tiranë nga datat 23 - 27 prill 2014.

Këtë panair, krahas librit "Historia e Dibrës", "Abdyl Frashëri" dhe "Etnogjeneza e Shqiptarëve", vjen edhe botimi më i ri nga akademik Kristo Frashëri, "Ahmet Zogu - vështrim historik"



Tel. (04) 22 33 283
069 20 68 603
068 65 08 441
067 30 73 265
E-mail: mbbotime@gmail.com